

**Votëbesimi**  
Për VMRO-në,  
Zaev i dështuar  
në ekonomi

Fq.3



**INVESTIMET  
E HUAJA**  
Vjet kanë  
ikur jashtë  
230 milionë euro

Fq.6



Edhe  
kujdes  
nga  
Evropa!

**Forum**

Fq.10



# Koha

www.koha.mk



**Pronarët  
e botës**

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3339 · e enjte 12 prill, 2018

11°C | 25°C

15 DEN

## EDITORIAL

**Ferma e  
kopeve tona**



Asnjëherë nuk duhet të ketë entuziazëm të tepruar për sa i përket efekteve që mund të kenë mediat në përmbysjen e realiteteve, sepse, fundja, ky edhe nuk është misioni i tyre. Ajo çka mund të bëjnë mediat, është mundësia për të ofruar një këndvështrim, një kanal, për të fokusuar qasjen atje ku puçet interesi i publikut dhe kërshëria mediatike. Në këto më shumë se dy dekada tranzicion demokratik, mediat kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm në ridimensionimin e realiteteve shoqërore...

Fq.2

## RAJON

**BE dhe  
Pallkani  
Perëndimor,  
detyrë për  
disa breza**

Fq.14

## GLOBI

**Nga 3078  
palestinezë të  
plagosur, 305  
janë fëmijë!**

Fq.15



**SKANDALOZE, INSPEKTORI I ISHA-S KUNDËR DYGJUHËSISË**

# INSPEKTORË SHOVINISTË MBIKËQYRIN SHKOLLAT!



Inspektori i arsimit, Zoran Risteski, përmes profilit të tij në "Facebook" shprehet "JO DYGJUHËSI NË MAQEDONI". Për më tepër se kaq, ai nuk tërhiqet prej atij postimi as pas reagimeve të shumta që vijnë nga shumë prindër, profesorë dhe arsimtarë shqiptarë. Nuhi Dardhishta nga LASH-i "Naim Frashri" dhe Bashkim Idrizi, profesor në UNT, kërkojnë nga MASH-i dhe ISHA largimin e inspektorëve të këtillë me pikëpamje shoviniste

Fq.4

## As "H" nga hetimet për Lagjen e Trimave

Shkup, 11 prill - Asistencës ndërkombëtare për rastin e Kumanovës as që i vjen era. Shkeljet procedurale dhe mos dorëzimi i aktgjyqimeve në gjuhën shqip të akuzuarve për Lagjen e Trimave, paraqesin shkaqet kryesore se pse Gjykata e Apelit nuk mundet ta shqyrtojë vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast të Gjykatës Penale të Shkupit. Pala mbrojtëse e të dënuarve në rastin e Kumanovës shprehet e in-

dinuar nga veprimi i GJPSH-së dhe zvarritje me mos përkthimin e aktgjyqimit, i cili u shqiptua më 2 nëntor të vitit të kaluar. Avokati Naser Raufi për gazetën KOHA shprehet se pala mbrojtëse e ka pranuar aktgjykimin dhe të njëjtin e ka ankimuar para Gjykatës së Apelit, megjithatë parakusht që kjo gjykatë ta procedoj aktgjykimin e shkallës së parë, siç theksoi ai, është që të akuzuarit ta kenë...

Fq.5



## EDITORIAL

## FERMA E KOPEVE TONA



Emin AZEMI

Asnjëherë nuk duhet të ketë entuziazëm të tepruar për sa i përket efekteve që mund të kenë mediat në përmbyshjen e realiteteve, sepse, fundja, ky edhe nuk është misioni i tyre. Ajo çka mund të bëjnë mediat, është mundësia për të ofruar një këndvështrim, një kanal, për të fokusuar qasjen atje ku puçet interesi i publikut dhe kërshëria mediatike. Në këto më shumë se dy dekada tranzicion demokratik, mediat kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm në ridimensionimin e realiteteve shoqërore (por jo në përmbyshjen e tyre), sipas një ritmi që kanë diktuar nevojat dhe aspiratat sociale e politike, mirëpo këtu ka qenë kufiri i pushtetit të mediave. Punët tjera kanë qenë barrë e faktorëve vendimmarrës dhe shoqërisë në përgjithësi dhe mediat do të bënin gabim të madh sikur të ishin zgjatime të institucioneve, ashtu siç u munduan ta dizajnojnë rolin e tyre pushtet e regjimet e ndryshme këtu e më larg nesh.

Kjo hyrje iu dedikohet gjithë atyre që kërkojnë nga mediat më tepër se sa që ju takon, kërkojnë që t'i kryejnë punët e institucioneve e individëve, madje të bëhen edhe avokate të kauzave të ndryshme sociale, politike, kulturore etj. Dhe kur jemi te institucionet, ende jetojmë në një kohë kur raportet dhe hulumtimet e mediave nuk merren seriozisht dhe, për rrjedhojë, efekti që duhet të kenë mediat trajtohet me shpërfillje nga vendimmarrësit.

Pushtetet asnjëherë nuk kanë patur aleat mediat, pos ato që i kanë kontrolluar dhe dirigjuar. Prandaj edhe lufta më e madhe e njerëzve të mediave, tash e në të kaluarën, ka qenë luftë për pavarësi profesionale, luftë që do ta bënte median zë kritik dhe tregues i vlerave etike për të cilat njerëzit angazhohen.

Me fjalë të tjera, të gjithë ata që kërkojnë nga media avokatinë, humbin të drejtën të mbrohen nga një mekanizëm që është më i fuqishëm se çfarëdo lloj instrumenti juridik, e ajo është pesha e fjalës së lirë, e mendimit të paanshëm, i cili vetëm përmes medias mund të artikulohet. Për rrjedhojë, një shoqëri që dremet në pasivitet dhe konformizëm intelektual dhe kërkon nga gazetarët të kryejnë punën e opinionbërjes, atëherë gazetarisë i ngarkohet edhe një barrë që s'i takon. Mjafton të thuhet që te ne gazetaria ka inkurajuar njerëzit të dalin nga anonimiteti, të sfidojnë paragjykimet e stereotipeve, përmes përfaqësuesve të ndryshëm të godasin dukuri e devijime shoqërore.

Krejt këto dilema që shtrohen rreth rolit të mediave, nuk do të ishin interesante sikur të mos ekzistonte një paragjykim permanent që e kanë njerëzit, sidomos kur emri i tyre apostrofohet publikisht. Me fjalë të tjera, mediat janë të mira vetëm atëherë kur nuk denoncojnë dukuri negative, por në momentin kur theksi vëhet mbi bartësit e atyre dukurive, atëherë kërcet belaja, atëherë cingërojnë telefonat dhe prej 'qengjave' të butë shndërrohen në 'ujq' të egër. Të gjithë ata që kërkojnë butësi qengji nga mediat, vetë janë ujq që nuk pyesin për barinj dhe qenë stani. Në momentin kur jepet alarmi për rrezikun që mund ta gjejë kopenë e dhenvë, del dikush nga "bajraktarët" e ujqve dhe denoncon rrezikun që po ardhka nga blegërima e "qengjit".

Në Maqedoni ka plotë "qengja" e "ujq" që kanë mësuar zanatin të bashkëtojnë në një kope, prandaj rezultojnë që të kemi gjithnjë e më shumë stile bagëtish në komunikimin tonë publik, kurse ato zëra që përpiqen të artikulojnë paanshmëri pikëpamjesh e idesh janë të destinuar të izolohen dhe mundësisht të eliminohen.

Para disa shekujve në Amerikë kishte jetuar fisi autokton indian Mohikanët, mirëpo kryeplaku i këtij fisi kishte kundërshtuar metodat "bashkëkohore" të reformave sociale e politike amerikane, mirëpo nuk arritën të kenë sukses të imponojnë kërkesën elementare që të jenë të barabartë me të tjerët, asgjë tjetër. Çdo kush që sot del kundër shablloneve që imponohen, e që janë të papranueshme, shpallet hiq më pak se Mohikan i fundit.

## UJQIT KANË HYRË NË TORISHTË

"Gjendja e sigurisë është kjo: NATO-ja ruan tërësinë tokësore të Kosovës pa kurrfarë ndryshimi fundamental në misionin dhe kapacitetin për ta bërë këtë. Nga perspektiva e NATO-s dhe çfarëdo analize objektive, Kosova nuk rrezikohet nga ndonjë agresion i armatosur nga jashtë apo brenda vendit.

Gjendja e sigurisë është edhe kjo: Rusia gjendet në urën e Mitrovicës, Turqia në sallonin VIP të Aeroportit të Prishtinës e Serbia në Kuvendin e Kosovës. Si është e mundur kjo? Si është e mundur që NATO-ja ta ruajë tërësinë tokësore të vendit, por tri vende në formë aktive të shkelin mbi atë sovranitetin të cilin e ruan NATO-ja? Përgjigjja është e thjeshtë: NATO-ja mund ta ruajë tërësinë tokësore të Kosovës, por nuk ka mision ta administrojë atë. Administrimin civil e bëjnë kosovarët, andaj edhe ujku, apo ujqit kanë hyrë në torishtë.

Rusia gjendet në urën e ndarë të Mitrovicës pa nevojë shpenzimi material apo njerëzor. Ndarjen e Mitrovicës e bënë së bashku komandantët shkurtpamës të UÇK-së dhe forcat e riorganizuar serbe në veri të vendit. Vizatimi i vijave të mundshme ndarëse mes shqiptarëve e serbëve ishte bërë më moti, dhe kjo ishte pjesë e doktrinës që doli nga zhbërja e Bashkimit Sovjetik, ai i të drejtës së rusëve (dhe serbëve) për të qenë në një shtet, apo të drejtës që të mos jenë të sunduar nga shumicat që nuk janë ruse. Veriu i Kosovës është për Moskën i njëjtë gjeopolitikisht si Abkhazia, Osetia e Donbasi i Ukrainës. Rusia e mban urën e Mitrovicës me ndihmën e Serbisë. Serbia e mban urën e Mitrovicës si pjesë të bisedimeve që zhvillohen me Kosovën. Kosova ka pranuar që për urën e Mitrovicës -dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me Kosovën, territorin dhe banorët e saj - të bisedojë me Serbinë. Bisedimet nuk kanë as cak e as afat...", shkruan publicisti nga Prishtina, Veton Surroi.

## QEVERIA E SHTRENJTË E HARADINAJT

"U bënë katër javë prej se Lëvizja VETËVENDOSJE! (LV) ka shprehur qëndrimin e saj se kjo qeveri ka rënë moralisht dhe ajo duhet të bie edhe me numra. Nenad Rikallo e Milan Radojčić, shtimi enorm i posteve qeveritare dhe rritja e pagave vetvetes, diskreditimi i arsimit tonë nga BE-ja dhe rritja e papunësisë, Contour Global dhe 'Demarkacioni', e deri te dëbimi tinëz, në shkelje të ligjit e të drejtave të njeriut i 6 shtetasve turq, përgjegjësinë për të cilin nuk po e merr asnjë institucion i Kosovës, janë vetëm disa prej arsyeve pse kjo qeveri e shtrenjtë duhet të largohet. Interpelancat për temat e ndryshme dhe Komisionet Hetimore Parlamentare që kemi inicuar janë dëshmi e opozitarizmit tonë dhe dëmeve të kësaj qeverie që duhet të shkojë. LV është për zgjedhje të parakohshme parlamentare sa më parë dhe për mocion për rrëzimin e qeverisë. Shumica dërrmuese e popullit dhe shumica e deputetëve të Kuvendit janë në opozitë me këtë qeveri. Mbetja e kësaj qeverie në pushtet është dhunim i demokracisë qytetare e parlamentare, i vullnetit të popullit e i interesit të përgjithshëm. Nuk mund të mbetet shteti e populli peng as të qejfit të kryeministrit dhe as të frikës së presidentit", shkruan lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti.

## MEDIACitate

Vendimi më i fundit i qeverisë shqiptare për heqjen e vizave për qytetarët e Mbretërisë së Arabisë Saudite gjatë sezonit turistik është pritur me interes duke u pasqyruar edhe në portalet informuese vendase. Lidhur me këtë vendim por edhe për potencialet turistike të Shqipërisë, Arab Weeks Days ka publikuar një intervistë me ambasadorin tonë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Sami Shiba i cili deklaroi se "Qytetarët nga Arabia Saudite mund të udhëtojnë dhe të hyjnë në Shqipëri pa viza nga data prilli 2018 deri më 31 tetor 2018. "Për udhëtarët sauditë që duan të vijnë në Shqipëri nuk ka ndonjë kërkesë specifike. Gjatë periudhës verore, nga 1 prilli 2018 deri më 31 tetor 2018, qytetarët sauditë mund të udhëtojnë në Shqipëri pa viza, pa pasur nevojë të marrin vizë në Ambasadën e Shqipërisë. Udhëtimi mund të bëhet me një pasaportë të vlefshme. Unë dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për të ftuar turistët sauditë që ta konsiderojnë Shqipërinë si një nga opsionet më të mira kur bëjnë planet e tyre të pushimeve", deklaroi ambasadori shqiptar.

(ATSH, 11 prill)

I pyetur nëse po afron një luftë midis Greqisë e Turqisë, ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias është përgjigjur se nuk e besoj dikë të tillë. "Jo, nuk e besoj këtë dhe shpresoj se edhe Turqia nuk beson se mund ta bëjë këtë luftë. Nuk mendoj se Recep Tayyip Erdogan mund të ëndërrojë ndryshimin e kufijve evropianë". "Nuk ka alternativë tjetër veç paqes dhe bashkëjetesës paqësore", ka theksuar kryediplomati grek. "I them gjithnjë Erdoganit kur e takoj se Allahu na vuri pranë njëri-tjetrit dhe ai pret e shikon nëse sillësh në mënyrë të drejtë, morale dhe racionale. Nuk mund të ndryshosh gjitonin", thotë Kotzias në një pjesë tjetër të intervistës... Presidenti turk është një udhëheqës në Turqi dhe jo një personalitet i rastësishëm. Greqia nuk është një fqinj i keq, por Erdogan ka tendencë arrogante", thekson Kotzias, që vlerëson se Ankaraja, si mënyrë të të bërit politikë pëlqen krijimin e tensioneve.

(Der Spiegel, 11 prill)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARËJANË KODIKËT E BERATIT?

Kodikët e Beratit janë libra të dorëshkuar në pergamenë me përmbajtje fetare. Në vendin tonë dorëshkrimet e tilla janë ruajtur sidomos në Berat. Nga më të rëndësishmit midis tyre janë: Kodiku i Purpurt dhe Kodiku i Artë. Kodiku i Purpurt është shkruar në gjuhën greke, përmban pjesë nga ungjijtë e Mateut e të Markut, shkruar në shek.VI me ngjyrë të kuqe, prej nga ka marrë edhe

emrin "i purpurt". Është zbuluar në vitin 1868 nga A. Aleksudhi. Kodiku i Artë është dorëshkrim i shek.X në gjuhën greke. Përmban pjesë nga ungjijtë të shkruar në pergamenë me shkronja të vogla të arta. Shkrimi i dy kodikëve dhe ruajtja e tyre, krahas dorëshkrimeve të tjera të shumta, tregojnë nivelin e lartë kulturor të vendit ku ato janë shkruar dhe ruajtur.

Dështim në rritjen ekonomike, rritjen e pagave, mos sjellja e asnjë investimi të huaj dhe mos hapje e asnjë fabrike, dështim në sektorin e shëndetësisë, të politikë sociale dhe atë të sigurisë, ishin ndër akuzat që deputetët e VMRO-së adresuan deri tek Qeveria e Zoran Zaevit

## DEBAT I ASHPËR MES PUSHTETIT DHE OPOZITËS GJATË VOTËBESIMIT



# PËR VMRO, ZAEV I DËSHTUAR NË EKONOMI

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 11 prill - Kryeministri Zoran Zaev dhe ministrat e Qeverisë së tij të mërkurën gjatë interpelancës për votëbesimin e Qeverisë ishin fokus i kritikave të ashpra nga ana e ana deputetëve të VMRO-së. Dështim me rritjen ekonomike, rritjen e pagave, mos sjellja e asnjë investimi të huaj dhe mos hapja e asnjë fabrike, dështim në sektorin e shëndetësisë, të politikë sociale dhe atë të sigurisë, ishin ndër akuzat që deputetët e VMRO-së adresuan deri tek Qeveria e Zoran Zaevit. Nga deputetët shqiptar, Syrja Rashidi nga Aleanca për Shqiptarët akuzoi kryeministrin Zaev se s'ka bërë asgjë në ndarjen e drejtësisë selektive për rastin e Almirit të vogël, duke i kujtuar njëkohësisht kryeministrin se sipas informatave zyrtare, në burgjet e Maqedonisë ka po aq shqiptarë sa ka edhe maqedonas. "E vetmja gjë që ka bërë kjo Qeveri është Ligji për gjuhët, edhe atë vetëm për të formuar shumicën parlamentare, gjithçka tjetër është dështim. Asnjë fabrikë nuk është hapur, as rrogat nuk janë rritur. Në Shkup,

çdo ditë vidhet në parkingje, janë shpeshuar vrasjet për shkak se nuk ka siguri. Në Shkup asnjëherë nuk ka qenë më keq. Kjo Qeveri di vetëm të shesë emrin e shtetit dhe asgjë tjetër. Në gjithë këtë, Qeveria aktuale nuk e di se a kemi gjithsej 4 apo 5 ministra që e dinë se çfarë përgjegjësie kanë dhe të menaxhojnë përgjegjësitë e tyre", tha deputeti Vlatko Gjorçev. I njëjti theksoi se ministrat e LSDM-së asnjë fjalë nuk thonë për funksionarët e BDI-së të cilët, siç tha Gjorçev, "vijne nga një Qeveri kriminale me VMRO-në".

"Pse nuk thoni asnjë për ndonjë funksionarë të BDI-së, apo keni frikë se do tu rrëzojë. Ju thatë se qeveria VMRO-BDI ishte krimi-

nale, a mendoni ende ashtu? Dhe nëse po, ku janë ndëshkimet. U godit një police në karrotrec! Drejtojun partnerit të koalicionit BDI se çka ka ndodhur realisht", tha Gjorçev. Në sektorin e shëndetësisë, deputeti nga Tetova, Goran Manojlovski, përmendi premtimet e porealizuara të Qeverisë për rritjen e pagave prej 15 për qind për punonjësit shëndetësor, regres në "termini im" dhe asnjë projekt të ri për qendrat spitalore. "Asnjë investim për spitale te reja, ndërsa e vetmja gjë që keni bërë është vazhdimi i projekteve, në Prilep, Shtip dhe qytetet tjera", tha Manojlovski. Në reagimin e saj ndaj deputetëve të VMRO-së, ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska,

tha se për pak muaj sa ka jetë kjo Qeveri, ka bërë shumë në drejtim të asaj se ka sanuar shumë institucione të zhytur në borxhe gjatë kohës sa ka qeverisur për më shumë se 10 vite VMRO. Sheqerinska tha se Qeveria e ka filluar punën në marshin e 5-të, duke thënë se nëse VMRO do kishte punuar me të njëjtën shpejtësi, do ta kishte thyer qafën. "A e dini sa para janë dhënë vetëm në dhjetor për të paguar borxhet tuaja, 1.6 miliard euro. Në më pak se 10 muaj është dashur të rregullojmë atë që ju keni prishur për 10 vjet. Në cilindo institucion të përmendni, kemi gjetur borxhe, parregullsi të mëdha. Ajo pakënaqësi që thoni ju, qytetarëve ju vjen nga ato nën-

shkrime që figurojnë në dokumentin e interpelancës", tha Sheqerinska. Megjithatë, Syrja Rashidi i ASH-së tha interpelanca është farsë për të fshehur marrëveshjen VMRO-LSDM. Ai pyeti kryeministrin Zoran Zaev se pse tek qytetarët shqiptarë nuk sundon demokracia, por siç tha ai, sundon një subjekt politik që sundon për 16 vjet. Ai i kujtoi Zaevit se po imiton VMRO kur bëri një ndërhyrje brutale në bllokun shqiptar gjatë zgjedhjeve lokale. Ndryshe, diskutimi në këtë temë duhej që të zgjaste deri në mesnatë, kur të bëhej dhe votimi. Me diskutimin për interpelancën e Qeverisë, opozita kthehet në punën e Parlamentit pas afër pesë muaj bojkot.

## NDËRMJETËSI U SHKRUAN DIMITOVIT DHE KOXIASIT

## NIMICI KËRKON PËRGJIGJE KONKRETE

Letra ministrave u është dërguar në vigjilje të takimit të tyre të ri në Ohër, mbrëmë dhe sot. Informacionin për letrën e publikuan gazeta "Katimerini", radio "Athina 984" dhe portali informativ "Njuz 247", duke iu referuar burimeve të tyre

Athinë, 11 prill - Ndërmjetësuesi Methju Nimic u ka dërguar letër shefave të diplomacive të Maqedonisë dhe Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias, në të cilën e përshkruan situatën aktuale në bisedimet për emrin, gjegjësisht pikat për të cilat ka pajtim dhe pikat për të cilat ka dallime, ashtu si i ka formuluar në kohën e bisedimeve në Vjenë. Letra ministrave u është dërguar në vigjilje të takimit të tyre të ri në Ohër, mbrëmë dhe sot. Informacionin për letrën e publikuan gazeta "Katimerini", radio "Athina 984" dhe portali informativ "Njuz 247",

duke iu referuar burimeve të tyre. MPJ-ja greke, as nuk e konfirmuan, por as nuk e mohuan lajmin në mediat greke se Nimici ka dërguar letër deri te Dimitrovi dhe Koxias, lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina. "Sipas burimeve të caktuara, letra e fundit e Nimicit i shfaq qëndrimet e kristalizuara të diplomatit amerikan për çështjen, siç ishin formuluar në takimin e tij të fundit disaorësh me ministrat e Punëve të Jashtme të Greqisë dhe IJRM-së në Vjenë (30-31 mars). Të njëjtat burime përmendin se Nimici ka arritur deri te pikat të cilat

duhet të jenë parametra të zgjidhjes", shkruan "Katimerini". Radio "Athina984", megjithatë, publikoi se bëhet fjalë për procedurë të caktuar dhe parashikuar paraprakisht të ndërmjetësuesit.

"Dy ministrat pritët të përgjigjen në pyetësorin, i cili ishte dorëzuar nga ndërmjetësuesi special dhe ta kenë plotësuar deri në takimin e tyre të ardhshëm të përbashkët", bëri të ditur radioja athinase. Portali "Njuz247", duke iu referuar burimeve të veta, shkruan se ky është teksti i tretë i ndërmjetësuesit dërguar dy ministrave dhe paraqet

"intervenim dhe kontribut para takimit të rëndësishëm në Ohër". "Sipas informacioneve të njëjta, kabineti diplomatik i Koxiasit kontaktoi me Nimicin dhe e shprehu pakënaqësinë e Athinës për disa pjesë të letrës, sepse ministri i Punëve të Jashtme dëshiron të arrihet sa më shumë që është e mundur në bisedimet në Ohër", shkruan portali. Në ndërkohë, shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, nga Beogradi dje deklaroi se është bërë një hap përpara në zgjidhjen e kontestit për emrin dhe se për mbylljen e tij nevojitet kompromis. "Realizëm dhe prag-



matizëm është çelësi i zgjidhjes. Nevojitet kompromis, por jo kompromis i kalbur. Të dyja palët duhet të kuptojnë se nuk mund të fitojnë gjithçka", deklaroi Koxias pas takimit me ministrin serb të Punëve të Jashtme, Ivica Dačić. Për bisedimet është shprehur edhe ministri alternativ i Punëve të Jashtme të Greqisë, Jorgos Kartagallos, i cili në një intervistë për radion greke "Sto kokino", ka vlerësuar se dritarja e mundësive për zgjidhje edhe më tutje është e hapur.



## 90 për qind e administratorëve të MO kanë pranuar sistemimin

Shkup, 11 prill - Nëntëdhjetë për qind nga gjithsej 958 persona të punësuar sipas Marrëveshjes së Ohrit, të përfshirë me fazën e parë, tashmë i kanë nënshkruar vendimet për risistemim në institucionet shtetërore.

Nga Qeveria presin që vendimet t'i nënshkruajnë edhe 10 për qind e mbetur. Nëse nuk e bëjnë atë së shpejti, ata do të vendosen në listën për transfer për në fazën e dytë për kur është paraparë risistemimin e të tjerëve nga gjithsej 1.600 të punësuar sipas kësaj baze. Zëdhënësi i Qeverisë Muhamed Hoxha në konferencën e djeshme për shtyp theksoi se nga Sekretariati për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, ata sistematizohen në institucione të tjera ku sipas analizës dhe planit të Sekretariatit, përfaqësimi i drejtë nuk është në nivelin e nevojshëm. Në pyetjen nëse me sistemimin e këtyre të punësuarve përfundon procesi i punësimit në bazë të Marrëveshjes së Ohrit dhe përfaqësimit të drejtë, Hoxha theksoi se pasi që do të përfundojë ky obligim, do të ketë shpallje për punësim nëse në institucione të caktuara përfaqësimi i drejtë nuk është përmbushur. Plani që është bërë paraprakisht tregon se këto të punësuar në pjesën më të madhe do të risistemohen në MPB, DAP, Doganë, Spitalin Klinik Tetovë, Drejtorinë për Libra Amë dhe Prokurorinë Publike. Pastaj pasojnë MPJ, Kadastra, MASH, FSSH dhe Ministria e Financave. Hoxha ka paralajmëruar gjithashtu se në periudhën e ardhshme do të përgatitet Analizë për përfaqësimin e drejtë, ndërsa ka theksuar se sigurisht se do ketë punësim të reja në pajtim me përfaqësimin sipas Marrëveshjes së Ohrit. (Z.V)

Inspektori i arsimit, Zoran Risteski, përmes profilit të tij në "Facebook" shprehet "JO DYGJUHËSI NË MAQEDONI". Për më tepër se kaq, ai nuk tërhiqet prej atij postimi as pas reagimeve të shumta që vijnë nga shumë prindër, profesorë dhe arsimtarë shqiptarë. Nuhi Dardhishta nga LASH-i "Naim Frashri" dhe Bashkim Idrizi, profesor në UNT, kërkojnë nga MASH-i dhe ISHA largimin e inspektorëve të këtyllë me pikëpamje shoviniste

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 11 prill - Shkolla nuk ka asnjë dyshim se janë institucionet ku trasohen rrugët nga do të lëviz një shoqëri e caktuar, ndërsa në shoqëri multietnike, multigjuhësore, multikulturore dhe multikufesionale - sikurse është Maqedonia, është mese e logjikshme që roli i shkollës të jetë është shumëfish më i madh. Nuk është e rastësishme që me propozim-ligjin për arsim fillor, i cili duhet të miratohet së shpejti, janë caktuar nene të veçanta me të cilat MASH-i synon të rregullojë me Ligj çështjen e tolerancës ndëretnike dhe ndërgjuhësore nëpër shkolla. Konkretisht, neni 38 i këtij propozim-ligji mban dedikimin "Programme për avancimin e multikulturalizmit, integritimit ndëretnik dhe tolerancës", kurse neni 39 i po këtij propozim-ligji "Programme për mbrojtjen nga dhuna, keqpërdorimi dhe braktisja, programe për ndalimin e diskriminimit dhe programe për preventivë kundër sjelljeve tjera devijante". Mirëpo, duket se këto premisa nuk i kanë kuptuar as vetë të punësuarit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe për më tepër - inspektorët e arsimit.

Jo më larg se muajin e kaluar, Zoran Risteski, këshilltar në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit (ISHA), publikisht bënte thirrje kundër dygjuhësisë në Maqedoni. Në profilin e tij në "Facebook", Risteski postoi me shkronja të mëdha "JO DYGJUHËSISË NË MAQEDONI" dhe për më tepër se kaq, nuk tërhiqet nga ai postim as pas reagimeve të shumta që inspektorët të arsimit shpërndajnë qëndrimet të cilat promovojnë jo tolerancë gjuhësore dhe shpërndajnë gjuhën e urrejtjes ndëretnike në Maqedoni. Risteski pranon që postimi në fjalë është bërë nga vetë ai, ndërsa në vend të përgjigjes,

## SKANDALOZE

# INSPEKTORË SHOVINISTË MBIKËQYRIN SHKOLLAT!

Zoran Risteski  
Mars 13 në 9:02MD - Skopje - €



pyet nëse ne jemi për dygjuhësi. Ai nuk sheh asnjë lidhje mes statutit të tij në "Facebook" dhe jo tolerancës gjuhësore, ndërsa nuk ka përgjigje nëse një sjellje e tillë është e denjë për një inspektor arsimor. Prindër dhe arsimtarë të shumtë, të cilët kanë reaguar në forma të ndryshme, ngrenë dilema mbi kredibilitetin e inspektorëve arsimor.

"Si mund të lejohen inspektorët të këtyllë të vizitojnë shkollat dhe për më tepër, të merren me vlerësim nëse shkollat punojnë sipas ligjit ose jo, kur vetë ata deklarohen se janë kundër zbatimit të një Ligji tjetër", deklaroi Nuhi Dardhishta, kryetari i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" duke u thirrur në Ligjin e përdorimit të gjuhës shqipe, për të cilin në Maqedoni po zhvillohet një debat i thellë politik.

"Pa hyrë në detajet e politikës, Risteski dhe inspektorët të tjerë si ai duhet ta dinë se nëpër shkolla nuk flitet vetëm në maqedonisht. Nëpër shkolla, në masë të madhe mësohet në dy dhe më tepër gjuhë, pra përveç se në maqedonisht edhe në shqip, edhe gjuhë të tjera. Prandaj është e pa tolerueshme që një inspektor i arsimit të del publikisht me qëndrime kundër dygjuhësisë, qoftë edhe përmes profileve private në rrjetet sociale", shprehet Dardhishta. Ai kërkon nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA) të ndërmerren masa disiplinore kundër Risteskit, i cili sipas kryetarit të LASH-it, nuk ka kredibilitetin moral dhe etikë profesionale të ushtojë profesionin e inspektorit të arsimit në shkolla ku

mësohet në dy apo tre gjuhë.

Rreth këtij skandali ka regjuri në profilin e tij në "Facebook" edhe profesori universitar Bashkim Idrizi. "Imagjinoni, njerëz me mendime të këtyllë bëjnë kontroll mbi institucionet arsimore në Maqedoni", shkruan ai. Duke ilustruar komentin e tij me statutin e Risteskit "JO DY GJUHËSISË NË MAQEDONI". Idrizi, profesor në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, kërkon nga MASH-i dhe ISHA që "të largojnë nga institucionet arsimore njerëz që në mënyrë indirekte shpërndajnë gjuhën e urrejtjes ndëretnike".

Në ISHA nuk janë edhe aq të painformuar rreth skandalit të Risteskit, megjithëse drejtues të këtij institucioni nuk kanë ndërmarrë asnjë masë kundër tij. Afrim Saliu, udhëheqës Sektorit i Inspektoratit për mbikëqyrje dhe vlerësim, thotë se ka dy javë që është në pushim dhe nuk ka informacion nëse është ndërmarrë diçka kundër Risteskit. "Nuk është punë as e imja as e Risteskit të tregojmë nëse duhet ose nuk duhet dygjuhësia në Maqedoni. Sigurisht se ndarja e qëndrimeve politike nëpër rrjetet sociale nuk është një veprim i mirë për inspektorët e arsimit", thotë Saliu, ndërsa pohon se në dijeninë e tij, deri te ISHA-ja nuk është bërë asnjë ankesë. Drejtori Tome Spirovski pohon gjithashtu se nuk është ngritur ndonjë procedurë për shqyrtimin e mundshëm të masave disiplinore ndaj inspektorit Risteski. Kjo sepse deri te komisioni i posaçëm i ISHA-së që merret me këto punë, sikurse shpjegon ai, nuk është bërë asnjë ankesë.



BASHKIM IDRIZI

Imagjinoni, njerëz me mendime të këtyllë bëjnë kontroll mbi institucionet arsimore në Maqedoni. MASH-i dhe ISHA duhet të largojnë nga institucionet arsimore njerëz që në mënyrë indirekte shpërndajnë gjuhën e urrejtjes ndëretnike



NUHI DARDHISHTA

Pa hyrë në detajet e politikës, Risteski dhe inspektorët të tjerë si ai duhet ta dinë se nëpër shkolla nuk flitet vetëm në maqedonisht. Nëpër shkolla, në masë të madhe mësohet në dy dhe më tepër gjuhë, pra përveç se në maqedonisht edhe në shqip, edhe gjuhë të tjera. Prandaj është e pa tolerueshme që një inspektor i arsimit të del publikisht me qëndrime kundër dygjuhësisë, qoftë edhe përmes profileve private në rrjetet sociale



ZORAN RISTESKI

Risteski pranon që postimi në fjalë është bërë nga vetë ai, ndërsa në vend të përgjigjes, pyet nëse ne jemi për dygjuhësi. Ai nuk sheh asnjë lidhje mes statutit të tij në "Facebook" dhe jo tolerancës gjuhësore, ndërsa nuk ka përgjigje nëse një sjellje e tillë është e denjë për një inspektor arsimor

TË AKUZUARIT E RASTIT TË KUMANOVËS VAZHDOJNË PARABURGIMIN

Refuzimi i mbi 200 provave dhe mos përfillja e palës mbrojtëse në rastin e Kumanovës nga GJPSH, janë shkaqet kryesore të cilët duhet hetohen me asistencën ndërkombëtare, e të cilën e premtoi edhe vetë kryeministri Zoran Zaev, mirëpo rrethanat aktuale nuk japin shpresë së ky hetim do të filloi së shpejti

## AS "H" NGA HETIMET PËR LAGJEN E TRIMAVE



Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 11 prill - Asistencës ndërkombëtare për rastin e Kumanovës as që i vjen era. Shkeljet procedurale dhe mos dorëzimi i aktgjykimeve në gjuhën shqip të akuzuarve për Lagjen e Trimave, parqesin shkaqet kryesore se pse Gjykata e Apelit nuk mundet ta shqyrtojë vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast të Gjykatës Penale të Shkupit. Pala mbrojtëse e të dënuarve në rastin e Kumanovës shprehet e indinjuar nga veprimi i GJPSH-së dhe zvarritje me mos përkthimin e aktgjykimit, i cili u shqiptua më 2 nëntor të vitit të kaluar.

Avokati Naser Raufi për gazetën KOHA shprehet se pala mbrojtëse e ka pranuar aktgjykimin dhe të njëjtin e ka ankimuar para Gjykatës së Apelit, megjithatë parakusht që kjo gjykatë ta procedoj aktgjykimin e shkallës së parë, siç theksoi ai, është që të akuzuarit ta kenë të pranuar vendimin e GJPSH-së.

"Për shkak se aktgjykimi ende nuk u është dorëzuar të akuzuarve për Lagjen e Trimave, të njëjtin edhe tutje qëndrojnë në paraburgim. Kjo është praktikë e re dhe deri më sot nuk ka ndodhur. Ne si palë mbrojtëse kemi kërkuar që në Prokurorinë për krim të organizuar të

formohen ekipe, të cilët me asistencë ndërkombëtare - do të punojnë në zbardhjen e plotë të rastit të Kumanovës. Ne jemi në pritje dhe deri më sot asgjë të re nuk ka. Po ashtu, edhe nga Prokuroria Speciale Publike kemi kërkuar të prononcohet për këtë çështje, megjithatë përkundër kërkesës tonë për takim, ata ende nuk na janë përgjigjur", thotë Raufi. Refuzimi i mbi 200 provave dhe mos përfillja e palës mbrojtëse në rastin e Kumanovës nga GJPSH-ja, janë shkaqet kryesore të cilët duhet hetohen me asistencën ndërkombëtare, e të cilën e premtoi edhe vetë kryeministri Zoran Zaev, mirëpo rrethanat aktuale nuk japin shpresë së ky hetim do të filloi së shpejti. Ngjashëm si kolegu i saj, edhe avokatja Artene Iseini-Ademi potencon se procedura për shqyrtimin e rastit të Kumanovës nga Gjykata e Apelit në Shkup, ka ngelur për arsye të mos përkthimit të aktgjykimit në gjuhën shqipe e cila më pas duhet t'ju dorëzohet të

akuzuarve.

"Ky aktgjykim vazhdon të mbetet peng në Gjykatën Penale të Shkupit. Jemi në pritje që vendimi i gjykatës t'ju dorëzohet të akuzuarve, pastaj të kalojë afati i ankesës dhe më pas - lënda të shqyrtohet në GJPSH. Kjo pritje e gjatë disa mujore është jashtëligjore, për shkak se të akuzuarit edhe më tutje vazhdon të qëndrojnë në paraburgim. Një pjesë e tyre kanë kërkuar të shkojnë në vuajtjen e parakohshme të dënimit me burg, me të vetmin qëllimin - mënjanimin e kushteve mizore që mbizotërojnë në sektorët për vuajtjen e masës së paraburgimit, por nuk u janë pranuar kërkesat. Kur jemi te asistencën ndërkombëtare për zbardhjen e rastit të Kumanovës, më duhet të them se asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim. Ne shpresojmë se Gjykata e Apelit do ta shfuqizojë vendimin e shkallës së parë dhe e gjithë lënda të rigjykohet nga e para. Në këtë fazë duhet të kyçet edhe hetuesit e ri. Shumë gjëra duhet të zbulohet, për shkak se tepër fakte nuk janë marrë parasysh", tha avokatja Iseini.

Pas përmbylljes së procesi gjyqësor për Sopotin, me marrjen përsipër të rastit Monstra, opinioni më i gjerë është në pritje që edhe rasti i Kumanovës të procedohet nga Prokuroria Speciale. Burime të gazetës KOHA nga kjo prokurori thonë se për lëndën në fjalë është duke u punuar, operativa e kësaj prokurori po e heton rastin, megjithatë ende nuk dihet se vallë - ngjarjet e Lagjes së Trimave të vitit 2015 do të procedohen ose jo nga prokuroria e Katica Janevës.

### HOXHA, SEFAJ, RUSTEMAJ DHE ELSHANI NË PRAG TË GREVËS SË URISË

Në burgun e Manastirit, për më tepër se 18 muaj vazhdojnë të qëndrojnë në paraburgim Enver Hoxha Kllajn, Genci Sefaj, Lendrit Rustemaj dhe Fadil Elshani. Kushtet mizore dhe primitive kanë ndikuar që ato mos t'i bëjnë ballë këtyre masave të paraburgimit. "Të njëjtit nga Gjykata Penale e Shkupit kanë kërkuar që ta vuajnë dënimin me burg para se aktgjykimi kundër tyre të bëhet i plotfuqishëm. Arsyeja e vetme janë kushtet mizore. Një masë e tillë kaq e gjatë është në kundërshtim me konventat ndërkombëtare po ashtu edhe me dispozitat e kornizës ligjore të Maqedonisë. Të akuzuarit në fjalë qëndrojnë në qeli dy metra me dy, nuk përfshihen mundësia që ata të shkojnë në grevë urie. Tash duhet të llogaritet se në këtë hapësirë ato e kanë edhe tualetin", thotë avokatja Iseini.

## Bileta mujore 50 për qind më lirë për gazetarët

Shkup, 11 prill - Gazetarët anëtarë të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë së shpejti pritet të kenë përfitime të reja. Me vendim të Qytetit të Shkupit, siç thuhet në Memorandumin e nënshkruar mes kryetarit të Shkupit dhe SHGM-së, gazetarët do të përfitojnë 50 për qind lirim të çmimit të biletave të autobusëve të transportit publik në Shkup. Vendimin në favor të gazetarëve, Këshilli i Qytetit të Shkupit e ka miratuar në seancën e fundit. "Qyteti i Shkupit në interes të rritjes së transpa-

rencës në punën e institucioneve dhe llogaridhënies përmes hapjes së plotë për informim të saktë dhe në kohë, gjegjësisht në interes të opinionit, ka nënshkruar Memorandum me SHGM-në, ku bashkërisht prite të kontribuohet për arritjen e një qëllimi shoqëror. Për këtë arsye, si një prej masave e cila do të mundësoj punën efikase, pa pengesë dhe dinamike të gazetarëve, anëtarë të SHGM-së, është ulja për 50 për qind e biletës mujore për rajonin e Shkupi", thuhet në Memorandum.

Njëkohësisht agjencia "Rule Turs" së fundmi ka nënshkruar marrëveshje me SHGM-në, ku gazetarët - anëtarë të shoqatës, gjatë udhëtimit me linjat e kësaj kompanie brenda dhe jashtë Maqedonisë, do të kenë mundësi zbritjeje prej 20 për qind të biletave udhëtimit. Këto dy marrëveshje të SHGM-së pasojnë pasi paraprakisht u firmos marrëveshje me kompaninë ajrore "Croatia Airlines", e cila anëtarëve të SHGM-së ju ofron 20 për qind zbritje të biletave të aeroplanit. (O.Xh)

## KRONIKË

### Hetohet zjarri në Ministrinë e Drejtësisë

Për momentin, MPB po zhvillon hetim për atë që ka ndodhur dhe si ka ardhur deri te shpërthimi i zjarrit në Ministrinë e Drejtësisë, në të cilin tërësisht janë djegur zyrat e katit të katërt, ndërsa konfirmohet sa është dëmi i bërë material, deklaroi sot zëdhënësi qeveritar, Mile Boshnjakovski. Ai theksoi se disa zyra tërësisht janë shkatërruar nga zjarri, por siç tha, së pari do të konfirmohet se deri në cilën shkallë është bërë dëmi i materialeve të caktuara. "Në katin e katërt ku është dëmtimi më i madh, gjendet një pjesë e dokumentacionit për ndihmë juridike ndërkombëtare, Reparti për ndihmë juridike ndërkombëtare, një pjesë e kontabilitetit dhe një pjesë e sektorit për financa të Ministrisë së Drejtësisë", tha në konferencën e sotme për shtyp, Boshnjakovski. Mirë është, shtoi ai, që nuk ka persona të lënduar dhe viktima. Reagimi i shpejtë i kompetentëve, tha, e ka penguar përhapjen e zjarrit në ndërtesat dhe objektet në afërsi. Zjarri në Ministrinë e Drejtësisë shpërtheu dje pasdite, ndërsa është denoncuar në orën 16:47 minuta. Në shuarjen e zjarrit kanë intervenuar 10 automjete me 25 zjarrfikës.

### Një banor i Vrapçishtit rrah nënën dhe motrën

Një banor 46-vjeçar nga f.Vrapçisht është privuar nga liria nën dyshimin se ka kryer dhunë familjare ndaj nënës dhe motrës së tij. Sipas SPB Tetovë, S.R. (72) nga fshati i Gostivarit, Vrapçisht, dje ka paraqitur dhunë familjare nga djali i saj R.R. (46) e cila ka ndodhur më datën 7 të këtij muaji. Sipas saj, ditën rreth orës 15:00 tek ta kishte ardhur vajza e të denoncuarës F.S. (41) për vizitë. Menjëherë kishte filluar verbalisht të grindej. Menjëherë më pas e ka sulmuar fizikisht, duke kërkuar që të largohet nga shtëpia. Atëherë është përfshirë edhe nëna S.R. pas çka R.R. është kthyer nga ajo dhe me grushte disa herë e ka goditur në kokë, duar dhe shpinë, duke i shkaktuar lëndime. Djali i dhunshëm, e ka braktisur shtëpinë, ndërsa dy të sulmuarat S.R. dhe F.S. janë strehuar tek fqinjët e tyre. Nga SPB Tetovë informojnë se R.R. dje është privuar nga liria dhe është mbajtur në Stacioni policor Gostivar për zbardhjen e plotë të rastit. Për dy ditë ky është rasti i dytë i paraqitjes së dhunës familjare, pardje për shkak të mosmarrëveshjeve familjare, një 32 vjeçar i ka rrahur bashkëshorten dhe babin e tij.

### Padi për katër persona, keqpërdorën pozitën zyrtare

Stacioni policor i Negotinës deri te Prokuroria adekuate Themelore Publike ka dorëzuar kallëzim penal kundër V.K. (58) nga Kavadar - udhëheqës i "Ango ves", i punësuar në bodrumin e verës "Povardarie", P.K. (37) nga Vërbnica e Madhe, Serbi - udhëheqës dhe drejtor i përgjithshëm i bodrumit "Povardarie", T.B. (60) nga Negotina, si dhe kundër personave juridikë - Shoqata për shërbime hotelierike, turistike dhe prodhimtari "Ango ves" SHPKNJ, eksport - import - Kavadar dhe bodrumi i verës "Povardarie" SHA - Negotinë, e për shkak të ekzistimit të bazës për dyshim për vepra të kryera penale "falsifikim i dokumentit zyrtar", dënim nga neni 361, "keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit", dënim nga neni 353 qëndrimi 3 nga Kodi penal dhe vepra penale "tregti e palejuar me etil alkool dhe duhan, gjegjësisht mallra nga duhani". (O.Xh)

Sipas të dhënave të BPRM-së, shuma e përgjithshme e neto investimeve të huaja direkte për vitin e kaluar është 229 milionë euro e që si vlerë - është e barabartë me të hollat që kanë ikur nga Maqedonia jashtë saj. Kjo me fjalë të tjera nënkupton se - aq të holla sa kanë ardhur në emër të investimeve të huaja, po aq të holla edhe janë derdhur jashtë shtetit nga ana e investorëve të huaj

KAPITALI FRIKËSOHET, IK SI LEPURI

# VJET KANË IKUR 230 MILIONË EURO

Koha **Fisnik PASHOLLI**

Shkup, 11 prill - Kompanitë e huaja që punojnë në Maqedoni vitin e kaluar - në emër të fitimeve apo dividendës, kanë nxjerrë jashtë shtetit afër 230 milionë euro.

Sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë, vetëm në muajin qershor kanë tërhequr "në shtëpi", afër 104 milionë euro si rrjedhojë e vendimeve të Kuvendit të shoqatave aksionare. Nga BPRM nuk shpjegojnë se nga cilat firma ka rrjedhur derdhja e kapitalit që krijohet në Maqedoni.

Gjithashtu, sipas të dhënave të BPRM-së, shuma e përgjithshme e neto investimeve të huaja direkte për vitin e kaluar është 229 milionë euro, që si vlerë - është e barabartë me të hollat që kanë ikur nga Maqedonia jashtë saj. Kjo me fjalë të tjera nënkupton se aq të holla sa kanë ardhur në emër të investimeve të huaja, po aq të holla edhe janë derdhur jashtë shtetit nga ana e investorëve të huaj.

Vlerësohet se paqartësia poli-

tike që ka dominuar skenën vendore politike vitin e kaluar, po e merr haraçin e saj. Afaristët thonë se kapitali është si lepuri, andaj kur ai e nuhat pasigurinë - edhe ik nga problemet dhe paqartësitë. Ekonomistët thonë se vendimet për ndarjen e dividendës janë e drejtë e aksionarëve që mund të vendosin të investojnë mjetet në Maqedoni, apo edhe të nxjerrin jashtë kapitalin. Megjithatë, sugjerohet që në të ardhmen - të mendohet në drejtim që me pako të caktuara ekonomike apo financiare, të stimulohen investitorët e huaj që së paku një pjesë të fitimit apo dividendës sërish ta investojnë në Maqedoni. Ekspertët ekonomik thonë se derdhja e kapitalit në parim është puna e vetë kompanive që në bazë të planeve të saja investuese, vendos se si do të sillet me mjetet e saja materiale. Në fakt, kapitali që derdhet jashtë janë të hollat e kompanive të huaja që punojnë në Maqedoni, që si kapital ose investohet sërish në kompanitë amë, ose ju ndahen aksionarëve si fitim vjetor apo dividendë.

"Ne si shtet nuk mund të ndikojmë në vendimet e tyre. Gjithashtu, duhet parasysh se kompanitë nuk mendojnë lokalisht, por



**Sipas të dhënave të BPRM-së, shuma e përgjithshme e neto investimeve të huaja direkte për vitin e kaluar është 229 milionë euro që është për disa herë më pak se shtetet fqinje. Në këtë periudhë, edhe problemet e brendshme politike, por edhe konkurrenca madhe e shteteve fqinje në tërheqjen e investitorëve të huaj, kanë ndikuar edhe në vendimet për investime si të investitorëve aktual, ashtu edhe të atyre që planifikojnë të investojnë në Maqedon**

veprojnë dhe mendojnë në suaza globale dhe në këtë drejtim rrjedhin edhe lëvizjet e tyre. Mund të ndodhë që menaxhmenti i kompanisë të vendosë që të hollat që si fitim realizohen në Maqedoni, të investohen në shtete të tjera ku realizohet fitim më i madh, apo ajo që

kompanisë i nevojitet financimi i një veprimtarie tjetër që në atë moment ka rëndësi strategjike për pronarët e kompanisë", thonë njohësit e rrjedhave financiare në Maqedoni.

Sipas tyre, kohët e fundit duhet marrë parasysh edhe faktin se kapitali i huaj i nënshtrohet edhe mobilitetit apo lëvizjes së madhe. Gjithashtu, vlerësohet se investimet e huaja direkte duhet të shqyrtohen në aspekt jo vetëm të derdhjes së tij jashtë shtetit, por edhe ardhjes së kapitalit të huaj në Maqedoni. Me fjalë të tjera, saldoja e prurjeve dhe derdhjeve të kapitalit të huaj tregon edhe interesimin e të huajve për të investuar në ekonominë vendore. Sipas të dhënave të BPRM-së, shuma e përgjithshme e neto investimeve të huaja direkte për vitin e kaluar është 229 milionë euro që është për disa herë më pak se shtetet fqinje. Në këtë periudhë, edhe problemet e brendshme politike, por edhe konkurrenca madhe e shteteve fqinje në tërheqjen e investitorëve të huaj, kanë ndikuar edhe në vendimet për investime si të investitorëve aktual, ashtu edhe të atyre që planifikojnë të investojnë në Maqedoni.

## Licenca për shërim me qeliza amë

Shkup, 11 prill - Mundësi për angazhim eventual të ekspertëve të huaj, me shfrytëzim të kapaciteteve ekzistuese shëndetësore dhe arritjen e kursimeve eventuale në FSSHM duhet të hapin propozim - vendim për fillimin e procedurës për shpërndarjen e licencave për marrjen dhe mbjelljen e qelizave nga trupi i njeriut për shërim, që dje ishin rishikuar në seancën qeveritare. "Në këtë mënyrë hapet mundësia, vetëm mundësia që të shihet se a mund të sjellim doktorë ekspertë nga jashtë, të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese në sistemin shëndetësor dhe eventualisht të ketë kursime në FSSHM, me atë që te ne do të bëheshin një pjesë e këtyre shërbimeve që për momentin nuk bëhen te ne, ndërsa Fondi paguan që qytetarët t'i bëjnë jashtë vendit", tha në konferencën e sotme për media zëdhënësi qeveritar Mile Boshnjakovski. Në seancën e djeshme qeveritare u konfirmua teksti i propozim-vendimit për fillimin e procedurës për shpërndarjen e licencave për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore për marrjen dhe mbjelljen e qelizave nga trupi i njeriut për shkak të shërimit të qelizave amë, për shërimin e zembrës, pankreasit, indeve të syve, mushkërisë së zezë, veshkave dhe mushkërive të bardha. Në synimet e iniciativës së Ministrisë së Shëndetësisë, në propozim të të cilit ishin vendimet, janë sigurimi i llojit adekuat dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore sipas nevojave të popullatës, qasja gjeografike e shërbimeve shëndetësore, kapacitetet më të mira shëndetësore dhe mbrojtja shëndetësore të vazhdueshme dhe cilësore.

## Kosova kap 340 pako të barnave ilegale nga Maqedonia

Prishtinë, 10 prill - Policia e Kosovës parandaloi futjen e 340 pakove me barna në mënyrë ilegale në territorin e Kosovës nga Republika e Maqedonisë, nga persona të panjohur. Policia arriti ta parandalojë këtë aktivitet ilegal, por jo edhe të kapë personat që tentuan ta

kryejnë këtë veprë penale. Ata i kanë ikur policisë përmes pyllit të dendur që gjendet në kufirin Kosovë-Maqedoni. Gazeta mëson se personat u nisën nga Maqedonia për të hyrë në Kosovë me 340 pako barna të ndryshme si vaksina, barna, ampula e kremra të ndryshme

tentuan të futen ilegalisht në Kosovë nga disa persona. Policia Kufitare e Kosovës kishte vërejtur disa persona të dyshuar afër Urës së Vrazhevirit, që gjendet saktësisht në fshatin Seçisht në Han të Elezit. "Njësitë policore i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevoj-

shme policore, duke përfshirë edhe procedimin e tyre tek autoriteti kompetent doganor. Rasti është duke u hetuar në aspektin policor, duke përfshirë edhe identifikimin e personit/ave të dyshuar", është përgjigjja e Zyrës për Informim nga Policia e Kosovës.

## PADITET ISH-DREJTORI I AGJENCISË PËR PUNËSIM

Shkup, 11 prill - Sektori për luftë të krimit të organizuar dhe serioz parashtrori padi penale kundër ish drejtorit të Agjencisë për punësim V.P. (39) nga Shkupi për shkak të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autorizim, me çka e ka dëmtuar Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për 844.121 denarë ose 13.725 euro. Siç informon MPB, V.P. si ushtrues i detyrës - drejtor i Agjencisë për punësim

të Republikës së Maqedonisë, gjatë vitit 2016 në kundërshtim me ligjin për furnizime publike, pa procedurë të zbatuar ligjore, një personi juridik nga Shkupi i ka dhënë detyrë pune për sanimin e objektit. Në atë mënyrë ka mundësuar që personi juridik në mënyrë të paligjshme të fitojë interes pronësor prej 416.304 denarëve dhe për atë shumë e ka dëmtuar buxhetin e Republikës

së Maqedonisë. Gjithashtu, i denoncuar në periudhën prej 28 tetorit të vitit 2015 deri më 30 janar të vitit 2016, në kundërshtim me Rregulloren për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, pronë e APRM-së edhe pa leje të Bordit Drejtues, më 28 tetor të vitit 2015 ka lidhur Marrëveshje për bashkëpunim teknik me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale gjatë implementimit të programeve

aktive dhe masave për punësim. Në bazë të kësaj marrëveshje, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale i ka lënë për shfrytëzim katër automjete pronësi e APRM-së. Për automjetet, që i ka lënë në përdorim, V.P. ka dhënë në shfrytëzim edhe kartela për karburante me limit të caktuar në dy pompa të benzinës. Që të mundësojë shfrytëzim të kartelave për karburant në pompat e benzinës, i de-

noncuar ka dhënë edhe kartela të dyfishuara identifikuese në emër të personave të punësuar si shoferë në Agjencinë për punësim, e pa njohurinë e tyre. Me shfrytëzimin e kartelave për karburant, në periudhën nga 28 tetori i vitit 2015 deri më 30 tetor të vitit 2016, është mbushur karburant me vlerë të tërësishme prej 427.817 denarë në dëm të buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Sipas Bankës Botërore, një nga sfidat për rajonin, si dhe për Maqedoninë është shpërngulja e kuadrove me arsim të lartë. Të dhënat me të cilat disponojnë tregojnë se shpërngulje më të madhe ka nga Kosova dhe BeH-ja ku 50 për qind e popullatës kanë emigruar, derisa të dhënat për Maqedoninë tregojnë se 25 për qind e popullatës është shpërngulur

## RAPORT I BANKËS BOTËRORE

## EKONOMI PA KUADRO



## BB JEP MBËSHTETJE PËR TATIMIN PROGRESIV

Banka Botërore e mbështet dhe mendon se është e pranueshme reforma e paralajmëruar dhe vendosja tatimit progresiv, por porositi se Qeveria duhet të bëjë analizë më të kujdesshme rreth vlerës së shumës në të cilën do të zbatohet shkalla më e lartë e tatimit. "Mund të mbështesin tatim progresiv që e analizon Ministria e Financave. Lëvizin në drejtim të duhur duke i pasur parasysh të dhënat me të cilat disponojmë sot, por duhet të bëhet analizë e kujdesshme rreth pragut në të cilin do të zbatohet shkalla më e lartë e tatimit", tha Marko Mantovaneli, drejtor i Zyrës së Bankës

Botërore në Maqedoni. Në një artikull të vendosjes së tatimit progresiv nga Banka Botërore w theksuan fakti që Maqedonia së bashku me Shqipërinë dhe Kosovën në Evropë ka të ardhura më të ulëta. Sipas tyre, tatimi i sheshtë i cili zbatohet tani në vend është një prej arsyeve për të ardhurat e ulëta. Në lidhje me reformat në sistemin pensione nga Banka Botërore theksuan se analiza është në vijim dhe se ende është larg nga vendimi. Mantovaneli theksoi se ka më shumë mundësi dhe se rritja e kufirit të moshës për pensionim është vetëm një prej tyre.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 11 prill - Banka Botërore shikon trend pozitiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe ka parashikime pozitive për rritjen ekonomike në Maqedoni në një të ardhme të afërt. Kjo u theksua në prezantimin e djeshëm të Raportit të rregullt ekonomik të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.

"Ndikimi ekonomik në krizën politike në Maqedoni ishte më gjatë nga e pritura. Rritja u ngadalësua në zero në vitin 2017 për shkak të uljes së madhe të investimeve. Por, ekonomia tashmë po fillon të rikuperohet në vitin 2018 të udhëhequr nga konsumimi dhe rikuperohet në investimet", deklaroi drejtori i zyrës së Bankës Botërore në Maqedoni, Marko Mantovaneli. Sipas Bankës Botërore, integrimi i Maqedonisë në NATO dhe në BE mund t'i përshpejtojë reformat strukturore dhe ta rrisë besimin e investuesve, ndërsa rritja e përshpejtuar do të ndihmojë në konsolidimin fiskal. Rekomandojnë përpjekje të vazhdueshme të konsolidimit fiskal, vendosjen e reformave tatimore, përmirësim të cilësisë dhe efikasitetit të shpenzimeve sociale, racionalizim të subvencioneve veçanërisht në buj-

qësi, sigurim të qëndrueshmërisë të sistemit pensional, përmirësim të menaxhimit me financa publike dhe investime publike. Mes rekomandimeve janë edhe mbajtja e momentit reformues për përfortimin e produktivitetit dhe perspektivës për rritje.

Sipas Bankës Botërore, një nga sfidat për rajonin, si dhe për Maqedoninë është shpërngulja e kuadrove me arsim të lartë. Të dhënat me të cilat disponojnë tregojnë se shpërngulje më të madhe ka nga Kosova dhe BeH-ja ku 50 për qind e popullatës kanë emigruar, derisa të dhënat për Maqedoninë tregojnë se 25 për qind e popullatës është shpërngulur. Përveç kuadrove me arsim të lartë, citohet se

kemi edhe me arsim të ulët, që sipas Bankës Botërore, udhëzon në shpërngulje sezonale. Sipas drejtorshës rajonale të Bankës Botërore për vendet e Ballkanit Perëndimor,

Linda Van Gelder, rritja në rajon është e prekshme nga goditjet vendore dhe të jashtme dhe se rritja e pragut që e parashikojnë për vitet e ardhshme është kushtë-

zuar nga kombinimi i vërtetë i politikave dhe rregulloreve për zvogëlimin e prekmërisë nga goditjet dhe për përkrahje të rritjes. Ajo porositi se vendet e Ballkanit perëndimor duhet të arrijnë rritje në nivel prej pesë për qind që të mundën për 20 vite qytetarët ta kenë mesataren e qytetarëve nga Evropa Perëndimore.

"Përderisa mbesin në nivelin e tanishëm, do t'u duhen gjashtë dekada", potencon Van Gelder. Në Raportin e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, rritja e BPV-së është zvogëluar prej 3.1 për qind në vitin 2016 në 2.4 për qind në vitin 2017 si rezultat i dimrit të ashpër dhe investimeve më të vogla.

## JANË TË NEVOJSHME KUSHTE PËR KTHIMIN E TË RINJVE

Gjatë viteve të kaluara nuk është i rastësishëm largimi i kuadrove të reja të shkolluara nga Republika e Maqedonisë. Potenciali ynë, ardhmëria jonë, investimi ynë në reformat cilësore në shoqëri po largohet diku jashtë, të vlerësohet në nivel të tretë ose të katërt, pa me këtë rast të vlerësohet munda, por të merren si fuqi punëtore në vendet e Evropës, theksoi nënkryetarja e Parlamentit, Frosina Remenski. Në debatin e sotëm publik me temë "A duhet dhe çfarë ligji për të rinjtë na nevojitet", ajo theksoi se aspak nuk

është krenare që Maqedonia është e para sipas papunësisë së të rinjve në Evropë, ndërsa e treta në botë. "Unë aspak nuk jam krenare që do të them se 80 për qind nga personat e rinj të diplomuar në fakultetin tim janë të papunësuar, unë nuk jam krenare kur do të them se 60 për qind nga ata studentë nuk punojnë në profesionin e tyre", potencoi Remenski. Nënkryetarja e Parlamentit i inkurajoi të rinjtë të jenë kritik ndaj punës së Qeverisë me qëllim që të përmirësohen politikat të cilat mund të jenë edhe më të mira.

## PAVLO KLIKMIN NË MAQEDONI

## BASHKËPUNIM MË TË MADH ME UKRAINËN

Shkup, 11 prill - Memorandum për bashkëpunim të ndërsjellë mes akademive diplomatike në ministritë e punëve të jashtme të Maqedonisë dhe Ukrainës dhe deklaratë e përbashkët, dje nënshkruan ministrat e Punëve të Jashtme të dy vendeve, Nikolla Dimitov dhe Pavlo Klimkin, i cili është për vizitë dyditore zyrtare në Maqedoni. Dimitrov pas takimit informoi se me kolegun e tij kanë arritur marrëveshje edhe për vizitë kthyesë në Kiev, në të cilën do të nënshkruhet

marrëveshje për udhëtim pa viza në dy vendet, respektivisht për pezullim të përhershme të vizave për qëndrim afatshkurtër. Në takim është biseduar edhe për bashkëpunimin ekonomik për të cilin që të dy janë dakorduar se ka mundësi për intensifikim.

"Kemi marrëveshje për tregti të lirë, megjithatë shifrat nuk korrespondojnë me potencialin. Punojmë në avancimin e marrëveshjes, ndërsa procesi tashmë ka filluar. Kemi vizion të përbashkët

për një Evropë stabile dhe prosperuese edhe në këtë kuptim duke e riafirmuar ndërldhjen ndaj parimeve dhe vlerave evropiane jemi përqendruar në aspiratat evropiane dhe euroatlantike të dy shteteve tona. Edhe pse kemi rrugë specifike dhe përballemi me sfida të ndryshme, Maqedonia dhe Ukraina janë të gatshëm të shkëmbejnë përvoja dhe bashkërisht të mbështeten në realizimin e qëllimeve të përbashkëta", theksoi Dimitrov. Ministri i Jashtëm i Maqedonisë



paralajmëroi takim joformal të dy ministrave në Ohër së bashku me shefin e diplomacisë greke Nikos Koxias. Klimkin potencoi se Maqedonia është partner i rëndësishëm për Ukrainën në Ballkan dhe dy vendet së bashku ecin përpara drejt Bashkimit Evropian dhe

NATO-s. Ai theksoi se shkëmbimi tregtar nuk duhet t'i përfshijë vetëm produktet dhe investimet, por se nevojite edhe shkëmbim mes njerëzve dhe shkencës. Shefi i diplomacisë së Ukrainës është takuar edhe me kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi.



THIRRJE PUBLIKE

**PËR NDARJE TË KONCESIONEVE PËR KRYERJE TË HULUMTIME PROSPEKTUESE GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE METALIKE 2/2018**

Shkup, prill 2018

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1 e Ligjit për koncesione dhe të partneritetit publik dhe privat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15), nenit 7-a të Ligjit për Lëndët e para të mineraleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16 dhe 189/16), Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike nr. 44-4483/1 të datës 26.09.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/17), Komisioni për zbatim të procedurës për ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike publikon

THIRRJE PUBLIKE

**PËR NDARJE TË KONCESIONEVE PËR KRYERJE TË HULUMTIME PROSPEKTUESE GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE METALIKE 2/2018**

1. Koncedent është Republika e Maqedonisë - Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

2. Lëndë e kësaj thirrje publike është ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike nga Vendimi për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike nr. 44-4483/1 të datës 26.09.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/17), edhe atë:

- Rajoni Veriperëndimor që përfshinë komunat në vijim: Tetovë, Jegunovcë, Saraj, Gjoçe Petrov, Karposh, Sopshte, Studenica, Çashka, Zhelinë, Brvenicë, Bogovinjë, Vrapçisht, Gostivar, Makedonski Brod, Zelenikovë dhe Mavrovë dhe Rostushë dhe
- Rajoni Perëndimor qendror që përfshinë komunat në vijim: Kërçovë, Dibër, Mavrovë, Rostushë, Gostivar, Makedonski Brod, Çashka, Dollnen, Prilep, Krivogastani, Krushevë, Demir Hisar, Pllasnicë, Qendra Zhupë, Debarcë, Mogillë, Strugë, Ohër dhe Vevçan dhe
- Rajoni Jugperëndimor që përfshinë komunat në vijim: Ohër, Debërcë, Strugë, Mogillë, Resnjë, Demir Hisar, Krushevë, Manastir, Prilep, Novaci dhe Vevçan

3. Koncesioni për hulumtime prospektuese gjeologjike ndahen për periudhë deri në dy vjet, pa mundësi për të vazhduar

4. Hulumtimet prospektuese gjeologjike mund të realizohen në hapësirat e dhëna në hartat topografike, përveç se në hapësirat për të cilat është kryhet procedurë sipas iniciativës për ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve të detajuara gjeologjike, në hapësirat vetëm se më të dhëna nën koncesion për kryerje të hulumtimeve të detajuara gjeologjike, hapësirat e hulumtuara dhe koncesione për eksploitim të lëndëve të para minerale;

5. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj juridike dhe konkorsiume të cilët do të marrin dokumentacionin tenderues përmes sistemit elektronik [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk) dhe do të plotësojnë kushtet në pajtim me përcaktimet në dokumentacionin tenderues.

4. Në dokumentacionin tenderues janë të përmbajtura të dhëna në lidhje me lokalitetet për të cilat jepen koncesionet për hulumtime prospektuese gjeologjike, si dhe vlera e ofertës së projektit koncesionues i shprehur si shumë e vlerësuar fillestare e koncesionit dhe kushte që duhet të plotësohen nga ana e koncesionerit.

5. Ofertuesit duhet domosdo përmes sistemit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk) të dorëzojnë dokumentacionin e skanuar në vijim për të dëshmuar kushtet personale, profesionale dhe financiare që duhet ti plotësojnë për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

1) Dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale  
- Për subjektet e vendit juridike: dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale nga Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike: dokument nga organi kompetent - vërtetim se gjendet në regjistrin zyrtar tregtar që udhëhiqet nga ana e organit kompetent të shtetit ose vërtetim nga organi kompetent për certifikim që i plotëson kushtet të përcaktuara me ligj;

2) Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit, raportet pozitive financiare, së paku për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurtë se ky, raportet financiare parashtrihen për periudhën prej kur është i regjistruar

- Për subjektet e vendit juridike: Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit të cilin e jep Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë, raportet pozitive financiare, së paku për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurtë se kjo, raportet financiare dorëzohen për periudhën prej regjistrimit;

- Për subjektet e huaj juridike: raporti pozitiv revizor nga institucioni revizor me renome të regjistruar për kryerje të revizionit. Raporti revizor të përmbajë të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të ofertuesit të huaj për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurtë se kjo, raportet financiare dorëzohen për periudhën prej kohës së regjistrimit;

3) Certifikatë për tatimet dhe kontributet e paguara  
- Për subjektet e vendit juridike: të dhënë nga Drejtoria për të hyra publike e Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike dokument të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

4) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në falimentim

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

5) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në likuidim

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

6) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim për veprë penale:  
- Për subjektet e vendit juridike të dhënë për vendin penal gjyqësor të dhënë nga Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

7) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim në procedurë kundërvajtje ndalesë për kryerje të detyrës ose veprës profesionale, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë:

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistrimi qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

8) Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi përgjegjës se personi juridik ose anëtari i organit të tij për menaxhim ose organi mbikëqyrës nuk janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për veprat penale në vijim: korrupsion, mashtrim dhe larje parash; (ANEKS GJ)

- Për ofertuesit e huaj është e nevojshme që deklarata e tillë të jetë e vërtetuar në noter, ose nga ndonjë organ tjetër derisa në shtetin prej nga vjen ekziston institucioni i tillë që kryen vlerësimin e llojeve të tilla të deklaratave.

9) Deklaratë, të vërtetuar në noter, se subjektit juridik duke përfshirë edhe subjektet e huaja juridike me filial të shënuar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë më herët nuk i është marrë koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploitim të lëndëve të para minerale, si subjekt juridik që është i lidhur me atë subjekt juridik; (ANEKS Z)

10) Për konzorcium është e nevojshme çdo anëtar i grupit të plotësojë të gjitha kushtet personale, profesionale dhe financiare të kësaj pike.

Vetëm ofertat e ofertuesve të cilët janë të vlerësuar si të aftë do të jenë lëndë e evoluimit.

6. Ofertuesit domosdo përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë duhet të dorëzojnë Garancinë tenderuese në origjinal.

7. Oferta e tërësisht duhet të jetë në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni shoqëruar i ofertës, e cila kërkohet në pajtim me dokumentacionin tenderues, duhet të jetë e skenuar nga origjinali. Ofertuesit të cilët do të zgjidhen si më të volitshëm duhet të dorëzojnë në origjinal dokumentacionin të cilin më herët e kanë të skenuar dhe të vendosur në ueb portalin [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të kumtesës dhe Vendimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm. Nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj, ky dokumentacion duhet të përkthehet nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga dita e hapjes së Thirrjes Publike, përveç se Raportit revizor.

7. Ofertuesit mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për lokalitetin për ndarje të koncesionit për hulumtime prospektuese gjeologjike.

9. Dokumentacioni tenderues merret në mënyrë elektronike nga ueb portal: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk). Të drejtë për marrje të dokumentacionit tenderues ka çdo subjekt i cili do të regjistrohet në ueb portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk). Të drejtë për pjesëmarrje në procedurën e mëtutjeshme të Thirrjes publike ka çdo subjekt i regjistruar në ueb portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), i cili ka marrë dokumentacion tenderues, ka aplikuar me ofertë të vet dhe ka dorëzuar dëshmi për pagesë të realizuar për dokumentacionin e marrë tenderues. Dokumentacioni tenderues mund të merret në portalin: [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk)

10. Ofertat duhen të jenë me afat të vlefshëm për një vit duke filluar nga data e hapjes publike.

Për të aplikuar në thirrjen publike, ofertuesi i interesuar është i obliguar që të paguajë mjete të paktyshme në shumë prej 6.000,00 (gjashtë mijë) denarë, të skenajë fletëpagesën dhe ta postojë përmes sistemit në [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk).

Pagesa duhet të bëhet në interes të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, me shenjë: për dokumentacion tenderues për ndarje të koncesioneve për hulumtime prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike sipas Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për kryerje të hulumtimeve prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike nr. 44-4483/1 të datës 26.09.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/17):

Llogaria trezore: 10000000063095

Llogaria e pagesës: 840\_\_\_\_\_06163

Shifra e të hyrave dhe programi: 724125-00

Deponent: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë

Numri tatimor: 4030000392597

Për ofertuesit e huaj:

Ministria e ekonomisë

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë

Bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

SWIFT BIC: NBRM MK 2X

IBAN: MK07 1007 0100 0028 009

11. Oferta dorëzohet përmes portalit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), më së voni deri në ditën dhe kohën e parashtrimit të ofertës.

12. Afati për dorëzimin e ofertave është më së voni deri më 15.05.2018. Do të shqyrtohen vetëm ofertat të dorëzuara përmes sistemit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), më së voni deri më 15.05.2018 deri në ora 10.00.

13. Oferta duhet të përmbajë gjërat në vijim:

- Ofertë,

- Garanci tenderuese dhe

- Dokumente me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit, të theksuara në pikën 6 të kësaj thirrje publike.

14. Gjatë zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm do të shqyrtohen vetëm ofertat që e përmbajnë dokumentacion e plotë në pajtim me Dokumentacionin tenderues.

15. Kriteri sipas të cilit do të bëhet zgjedhja e ofertës më të volitshme është kriteri më i lartë i ofruar i koncesionit, por jo më i ulët se çmimi fillestar për lokalitetin dhe lëndën e parë minerale të kësaj Thirrje publike.

Kushti për vlerësimin e ofertave është Garancia e rregulluar tenderuese.

16. Ankandi publik përmes sistemit për ankand elektronik [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), do të mbahet më 17.05.2018 prej ora 09:00.

17. Obligimet e koncesionerit do të përcaktohen në Marrëveshjen për koncesion për hulumtime prospektuese gjeologjike. Koncesioneri është i obliguar që hulumtimet prospektuese gjeologjike të kryejë në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të Republikës së Maqedonisë.

18. Qeveria e Republikës së Maqedonisë: mund të kryejë ndryshim ose plotësim të dokumentacionit tenderues, më së voni 15 ditë para kalimit të afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, të mos ndajë koncesionet ose plotësisht të ndërpresë procedurën.

19. Mënyra e evaluimit të ofertave:

Dorëzimi i ofertave bëhet përmes portalit [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk), gjegjësisht vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.

Evaluimi bëhet për të gjitha ofertat të dorëzuara deri më 15.05.2018 deri në ora 10:00.

Evaluimi i ofertave do të realizohet në dy mënyra, edhe atë:

Në hapin e parë kontrollon kompletimi dhe validiteti i Dokumentacionit të domosdoshëm.

Nëse vërtetohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, oferta financiare nuk shqyrtohet dhe ofertuesit nuk do të lejohet pjesëmarrje në ankandin elektronik.

Në hapin e dytë, pas vërtetimit të kompletimit dhe validitetit të dokumentacionit nga ana e Komisionit, shqyrtohet oferta financiare dhe lejohet qasje në sistemin për pjesëmarrje në ankandin elektronik. Secili ofertues në sistemin mund të shohë rangimin e tij aktual në relacion me ofertat financiare dhe mund të ofrojë në pajtim me rregullat e definuara të publikuara në sistemin [www.e-koncesii.mk](http://www.e-koncesii.mk).

Komisioni do të përpilojë Raport të evaluimit të ofertave, në të cilin do të përshkruhet procedura gjatë evaluimit, ankandi elektronik (ankandi), vërejtjet eventuale dhe arsyetimet e Komisionit.

20. Organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në procedurën për ndarje të koncesioneve për hulumtime prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike është Komisioni shtetëror i ankesave për furnizime publike (bul. "Ilinden" nr. 63 A, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë). Ankesa mund të shtrohet në afat prej tetë ditëve nga dita e:

- publikimit të Thirrjes publike për ndarje të koncesioneve për hulumtime prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike në lidhje me të dhënat, veprimet ose lëshimet për ndërmarrjen e veprimeve nga Thirrja publike;

- evaluimi i ofertave, në lidhje me veprimet ose lëshim e ndërmarrjes së veprimeve në lidhje me dokumentacionin tenderues, gjegjësisht procedurën për evoluimin e ofertave dhe ankandin;

- pranim të vendimit me të cilin vendoset për të drejtë individuale nga procedura për ndarje të koncesionit për hulumtime prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike në lidhje me vërtetimin e aftësisë së paraqitjeve për pjesëmarrje ose evaluim të ofertave dhe vendimit dhe

- informatë për parregullsi gjatë procedurës së ndarjes së koncesioneve për hulumtime prospektuese gjeologjike të lëndëve të para minerale metalike, më së voni në afat prej një viti nga dita e mbarimit të procedurës së realizuar.

21. Për të gjitha çështjet në lidhje me këtë thirrje publike kandidatët e interesuar mund të drejtohen tek personat e autorizuar për kontakt:

**Florent Çiçe tel: +389 2 3093 481**

**e-mail: florent.c@economy.gov.mk**

**Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime prospektuese gjeologjike për lëndët e para minerale metalike**

**mineralne metalike**



QTF DO TË SJELLË 100 REPRIZA KËTË VIT

# MJAKU KËRKON THEMELIMIN E NJË TEATRI PËR FËMIJË

Bajrush Mjaku, drejtor i Qendrës Teatrorë për Fëmijë dhe i Teatrit Çair që funksionon në kuadër të qendrës thotë se është momenti i fundit kur duhet të themelohet Teatri i Fëmijëve në gjuhën shqipe, ose të institucionalizohet QTF. Sipas tij, më tepër sesa kërkesë që i drejtohet Qeverisë është një angazhim që duhet të përmbushet në mënyrë që fëmijët shqiptarë të kenë mundësi të konsumojnë nga afër teatrin



Koha

Evis HALILI

Shkup, 11 prill - Mbështetje nga komuna dhe përkrahje nga ministria nuk mund të jenë më shumë sesa paterica për funksionimin e një Qendre dhe teatri për fëmijë. Bajrush Mjaku, drejtor i Qendrës Teatrorë për Fëmijë dhe i Teatrit Çair që funksionon në kuadër të qendrës thotë se është momenti i fundit kur duhet të themelohet Teatri i Fëmijëve në gjuhën shqipe, ose të institucionalizohet QTF. Sipas tij, më tepër sesa kërkesë që do t'i drejtohet Qeverisë është një angazhim që duhet të përmbushet në mënyrë që fëmijët shqiptarë të kenë mundësi të konsumojnë nga afër teatër. Deklaratat e Mjakut janë bërë një ditë pas vënies në skenë të premierës së parë për këtë vit "Mullinjte e erës", shkruar nga Jeton Neziraj dhe regji të Blerta Nezirajt. Ndërsa këto ditë do të fillojnë përgatitjet për të vënë në skenë një tjetër shfaqje për fëmijë, në muajin shtator do të përgatitet projekti i fundit "Nën Krevat".

"Këtë vit do të realizohen tre shfaqje, të cilat konceptualisht jam munduar që t'i ndaj,

për parashkollorë, ciklet e para dhe të dyta shkollorë dhe për herë të parë në hapësirat e QTF do të ketë repertor të rregullt, ku parashikohen të jepen 100 repriza. Këtë vit do ta shfrytëzojmë maksimalisht këtë hapësirë, infrastrukturën dhe të kemi repertor të rregullt. Si menaxhues i QTF dhe Teatrit të fëmijëve Çair them se hapi më i rëndësishëm që do të duhej të bëhej dhe më qenësor është që të krijohet Teatri i Fëmijëve në gjuhën shqipe. Atëherë do të mund të mendojmë dhe të marrim obligime që fëmijëve t'ua japim kënaqësinë që ta konsumojnë nga afër teatrin. Më tepër sesa kërkesë dhe mungesë, kjo është një nevojë shumë e madhe, që të institucionalizohet një teatër për fëmijët në gjuhën shqipe", thotë Mjaku. Pas themelimit të Teatrit të Fëmijëve në kudër të QTF Komuna e Çairit ka shlyer detyrimet financiare të këtij institucioni, në një vlerë prej 10 mijë eurosh, Ministria e Kulturës i ka akorduar një buxhet prej 1,8 milionë denarë, për realizimin e tre premierave, ndërsa Qyteti i Shkupit ka ndarë nga buxheti vetëm 170 mijë denarë për dy projektet e QTF.

"Bëmë një marrëveshje xhentëllmene me komunën e Çairit që ajo të mbulonte shpenzimet për mirëmbajtjen e objektit, ndërsa ne të financonim projektet që ajo do të nominonte. Premiera e parë u dha dhe ashtu siç tha edhe drejtori të presim reprizat e tjera gjatë këtij viti. Ministria e Kulturës këtë vit ka treguar se është e hapur për një bashkëpunim më të thellë me institucionet, do të kisha thënë me një simpati të veçantë për institucionet e këtij lloji, teatrit për fëmijë, të cilës e kemi për borxh që t'i ndihmojmë deri në fund", është shprehur sekretari shtetëror në Ministrinë e Kulturës, Valmir Aziri. Themelimi i Teatrit të Fëmijëve Çair, si pjesë e QTF kanë nisur që në vitin 2015 dhe janë neglizhuar për disa vjet më radhë, një prej shkaqeve ka qenë edhe formulimi i pasaktë i vendimit të themelimit nga ana e këshillit, komunal. Madje edhe pas përfundimit të procedurave disa muaj më parë në godinën e QTF nuk ka asnjë lloj tabele që të shënojë emërtësën e re, ose të ndryshuar, biletarinë, orarin për shfaqjen e pjesëve teatrale, reper-torin e të tjera.

## Maqedonia, lirim i shtetit të robëruar

Shkup, 11 prill - Maqedonia së bashku me Estoninë dhe Uzbekistanin, është treguar si pikë e ndritshme në raportin e ri "Kombet në tranzicion" të organizatës joqeveritare amerikane "Freedom Haus". "Mundësia më e madhe për zhvillim demokratik në Evropë sot gjendet në Maqedoni. Edhe pse një vend i vogël, mundësia është e madhe: sukses në Maqedoni domethënë fund i një dekade të shtetit të robëruar dhe zgjidhje e qetë e çështjeve bilaterale të cilat e pengojnë zhvillimin politik dhe ekonomik në rajon", theksohet në raport. Sipas "Freedom Haus", ndërrimi i pushtetit në Maqedoni në qershor të vitit të kaluar mundësoi të ndalën vitet e robërimit të shtetit dhe të fillojë zgjidhja e çështjeve me fqinjët. "Ndryshimi i klimës politike e cila u vërtetua në mënyrë dramatike në zgjedhjet lokale të tetorit, hap mundësinë që Qeveria të zbatojë agjendën e premtuar reformatore. Ky vit ndoshta do të jetë test për zotimet e LSDM-së dhe të BDI-së për reforma. VMRO-DPMNE, e cila në fund të vitit të kaluar vendosi ta bojkotojë Kuvendin, gjithashtu mund të ketë kontribut vendimtar në procesin reformativ. Normalizimi i punës së Kuvendit me pjesëmarrje të plotë të pushtetit edhe të opozitës, do të jetë çështje kyçe në vitin 2018", thuhet në raport. Përveç asaj, duke i dhënë fund një shteti të robëruar nga ana e pushtetit të mëparshëm të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, çelësi i parë i suksesit për koalicionin e udhëhequr nga LSDM-ja, bënë të ditur, "Freedom Haus", është zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë që më tej do të hap rrugën drejtë anëtarësimit në BE dhe NATO dhe do t'i japë stimul të madh ndërkombëtar vendit. "Nëse zgjidhet çështja e emrit, atëherë fillon puna e vështirë. Do të jetë e vështirë për koalicionin e ri për të çmontuar rrjetet klienteliste të VMRO-DPMNE-së të ndërtaura gjatë viteve, ndërsa ajo do të jetë edhe më e vështirë për shkak të luftës kundër keqpërdorimit të radhëve të tyre.

PËR TRE MUAJ NË SHKUP

## QENTË ENDACAK KANË KAFSHUAR 123 QYTETARË

Shkup, 11 prill - Shkupi vlon nga qentë endacak. Dukuri e përditshme është sulmi dhe kafshimi i qytetarëve nga qentë endacak. Prej fillimit të vitit e deri të martën, vetëm në kryeqytet janë regjistruar mbi 120 raste të kafshimit nga qentë. Këto shifra alarmante për gazetën KOHA i ka zbuluar zëdhënësi i Sektorit për punë të brendshme në Shkup, Liza Bendevska. "Prej 1 janarit të vitit 2018 deri më 10 prill të vitit 2018, në Ministrinë e punëve të brendshme janë paraqitur gjithsej 123 raste të sulmeve nga qentë endacak nëpër territorin e Shkupit. Raste më të shpeshta janë vërejtur në Aerodrom dhe Qendër", tha Bendevska. Bazuar në shifrat alar-



mante, Qyteti i Shkupit po bën përpjekje për të gjetur zgjidhje afatgjate për problemin me qentë endacak në vend, deklaroi zëdhënësi i Qytetit të Shkupit, Valon Salihu. "Qyteti i Shkupit e ka përgjegjësinë e rregullimit të pro-

blemit me qentë endacak dhe aktivisht po mundohet të gjejë një zgjidhje afatgjate. Ky problem është trashëguar pasiqë deri tani asnjëherë nuk është menduar të gjehet një zgjidhje sistematike. Fatqësisht kjo mos kujdeske ka

kontribuar që tani të përballemi me problemet me kafshimet e qenve endacak. Sa i përket dëmshpërblimit të të dëmtuarve, mënyrën e dëmshpërblimit ose lartësinë e vlerës për dëmshpërblim e cakton gjyqi e jo Qyteti i Shkupit", informoi Salihu. Kush do t'ju paguajë nëse ju kafshon një qen endacak? Qyteti i Shkupit dhe "Higjiena komunale" u paguajnë dëmshpërblim qytetarëve që janë kafshuar nga qentë endacakë dhe të cilët pastaj kanë paditur në gjykatë dhe kanë marrë kompensim të dëmit. Kundër Qytetit të Shkupit gjatë dy viteve të kaluara në bazë të kompensimit të dëmit për shkak të kafshimit nga qeni, janë parashtruar 69 padi. Paditë

janë bazuar në nenin 10 nga Ligji për Qytetin e Shkupit dhe nenit 28 nga Ligji për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve. Vlera e kompensimeve të dëmeve, e konfirmuar në procedurë gjyqësore, lëviz mes 60.000 dhe 180.000 denarë, varësisht nga mosha, shkal-la e lëndimeve, pasojat nga lëndimet e shkaktuara te i dëmtuari nga qentë endacakë. Nëse rasti vjen deri në gjykatë, praktika tregon se qytetari për dhimbjet fizike mund të marrë dëmshpërblim 35.000 denarë, për frikën 30.000 denarë, për dhimbjet shpirtërore 20.000 denarë dhe për shëmtim prej 5.000 denarë, apo kjo shumë gjithsej kap vlerën prej 90.000 denarë. (A.Xh)

# Edhe kujdes nga Evropa!



Nga  
Nazim RASHIDI

Të mbështjellë shpesh nga ngjarjet e përditshmërisë që me të drejtë shpesh edhe përcaktojnë të ardhmen po qoftë edhe afatshkurtër, mbesim jashtë dinamikave që zhvillohen në Evropë ku me gojë plotë synojmë të tërë. Në fakt dihet që të bëhesh pjesë në klubin evropian duhet të përmësh një sërë standarde, të cilat thënë qartë, do t'i ndjenim sepse ato standarde s'janë për në letër, por realisht që të përmirësojnë jetët e njerëzve. Thënë edhe më qartë, do të shihnim rrugë më të mira, pa gropat të cilat i kalojmë si sllallom, apo do të kishte shkolla më të mira, ku nxënësit nuk do të ishin nga 40 në klasë, apo ku nuk do kishte kushte si në kohën e "Lulit të vocër". Do të kishte spitale më të mira, ku nuk do të vdisnin 35 foshnja në një vend ku mplakja e popullsisë është sfida më e madhe e shoqërisë. Do të thoshte se njerëzit nuk do ta kishin ëndërr ikjen nga vendi, por do të ëndërronin të bëheshin të parët e vendit që duan ta harrojnë. Dhe mund të vazhdoj me shembuj të tjerë, sidomos me drejtësinë, aq plagë e dhimbshme për gjithë shoqërinë, e cila nuk arriti dhe nuk arriti që ta shndërrojë këtë shoqëri në të qetë, e cila do jetonte pa dyshimin konstant e pa frikë se gjykatat nuk ta hanë hakun nëse s'ke mik, nëse nuk njeh dikë, nëse je shqiptar, nëse je politikan në pushtet, nëse...

Por, ajo që kësaj here dua të theksoj është për atë se çfarë ndodh në Evropë dhe si mësojmë prej saj, nëse mundemi.

Dhe... "Që të fitonte, kryeministri kishte krijuar një listë: Neutralizo pavarësinë e gjyqësisë. Kontrolllo median. Demonizo migrantët. Krijto elita të reja lojale nëpërmjet një kapitalizmi me privilegje për njerëz të njohur. Energjizo narrativën nacionale të viktimit dhe heroizmit nëpërmjet manipulimit të memorjës historike. Deklaro se "vullneti i popullit" mbikalon ligjet dhe kushtetutën".

Ju duken këto hapa të njohura?

Jo, jo nuk përshkruhet qeverisja e Gruevskit. Është pjesë e artikullit "Si demokracia u bë armik" botuar në New York Times të autorit Roger Cohen dhe përshkruan zgjedhjet në Hungari.

Një vend i Bashkimit Evropian, madje dhe i rëndësishëm. Vetëm para pak ditësh atje zgjedhjet i fitoi për herë të tretë Viktor Orban. Me retorikën e përshkruar ai fitoi shumicë absolute dhe po shndërrohet në "tmer-

rin" e Evropës, pas Brexit sepse që tani ka thënë se fitorja e madhe i ka dhënë mandat për të ndryshuar një sërë ligjesh dhe kushtetutën që do të ketë në shënjestër shoqërinë civile. Kryeministri që ishte nën kritika të vazhdueshme për zvogëlimin e lirive dhe të drejtave, tani mund të bëhet edhe më i keq. Zhvillim i pa besueshëm për shumë vëzhgues. Pyetja e madhe që bëhet është se si ka mundësi që një vend që vinte nga diktatura, ajo komuniste të lejojë rikthimin e prires autoritare.

Si u arrit një gjë e tillë?

Një shpjegim që mund të jepet është se për pushtet bëj ç'të mundesh. Cohen thotë se Orban shkoi aq larg sa bëri armik edhe Perëndimin dhe citon Orban: "Rreziku na vjen nga Perëndimi. Ky rrezik na vjen nga politikanët nga Brukseli, Berlina dhe Parisi", këtë kishte deklaruar kryeministri hungarez në shkurt të këtij viti. Po, pa asnjë fije dyshimi se po armiqësohet me aleatët, dhe pa frikë se çfarë pasojash mund të ketë. Këto zhvillime janë disi të frikshme, nëse nuk ka kujdes konstant për demokracinë.

Sa do që e pa njohur të duket dhe e largët Hungaria, megjithatë bëhet fjalë për një vend me ekonomi më stabile, me një qëndrueshmëri më të madhe, por me sa duket nuk përjashtohet lindja e autoritarëve të cilët si

në të gjitha rastet bëjnë çdo gjë që të mbajnë pushtetin. Maqedonia vetë kaloi një dhjetëvjeçar të vështirë që pikërisht përdorte metodat e listës së përmendur më sipër për të mbajtur pushtetin. Leksioni është i qartë, kujdes nga liderë dhe politika që duan me çdo kusht të sundojnë. Dhe alarmi duhet të jetë vazhdimisht i ngritur, se manipulimet mund të jenë edhe më të mëdha nga ata që duan pushtet me çdo kusht kur papunësia është edhe më e madhe, kur kushtet e jetesës janë më të këqija, sepse premtimet që jepen janë më naive. Njerëzit mund ta "hanë" më lehtë karremin e autoritarizmit në këmbim të kërkesave bazike për një jetë më të mirë.

Në kohën që jetojmë duket se është e vështirë të krijohen diktatura si ato komunistet, por hibridi që disi dhe ne jetuam është se megjithatë vetëm një parti ka kontroll mbi gjithçka, surfodhet në valët e demokracisë por ajo nuk është e plotë. "Nuk ka polici totalitar. Asnjë nuk zhduket natën pa gjurmë. Kapitali i huaj është i mirëseardhur. Por Hungaria (apo çfarë do vendi tjetër që ka këtë model) nuk është vend i pa lirë, por as i lirë plotësisht", kështu e përshkruan Cohen Hungarinë. S'ka nevojë të theksoj ngjashmërinë edhe një herë. Por ideja është se nga Evropa mund të vinë prire të ndryshme. Kujdesi duhet

**Në kohën që jetojmë duket se është e vështirë të krijohen diktatura si ato komunistet, por hibridi që disi dhe ne jetuam është se megjithatë vetëm një parti ka kontroll mbi gjithçka, surfodhet në valët e demokracisë por ajo nuk është e plotë**



të jetë konstant, sepse demokracia nuk është thjesht një leksion i mësuar mirë ose përmendësh, por është një detyrim për kujdes të vazhdueshëm. Dhe gjithçka na përplas tek edukimi. Niveli shqetësues i arsimit sjell terren fantastik për mbjelljen e farës autoritare. Terren edhe ashtu i favorshëm për fenomene të tilla duke marrë parasysh të kaluarën.

Nga ana tjetër nëse, marrim parasysh shembullin e Hungarisë, elita e atjeshme vendin e konsideronin se gjatë periudhës komuniste ai ishte rrëmbyer drejt perëndimit. Me rënien e komunizmit ai iu kthye vlerave ku përkiste. Por siç duket vetëm pak duhet që mendësitë e njerëzve të lëkundën.

Imagjinoni tani shoqëritë tona, pa një të kaluar të thellë në kulturën evropiane, ende me mbamendje nga logjika e ushtrimit të pushtetit në periudhën komuniste se çfarë mund të ndodhë (siç edhe ndodhi) nëse vinë pushtete që mund të lëkundin priret e shoqërisë tonë. Në raste të tilla mund të thuhej se kur digjesh nga qumështi i fryn kosit. Por, ne që s'kemi as qumësht e kos edhe më pak, alarmi dhe kujdesi duhet të jetë marra-mendës. Diçka që elitat tona politike, por dhe shoqëria as që e mendon.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 11 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Miku im! Para se ta ftilloja shkrimin e radhës iu betova motrës sime nga Dardanelet se në "shkarravinën" e radhës do t'u shmangem paralelizmave, shprehjeve denigruese, fjalëve të huaja si dhe "temsileve", pavarësisht se ajo nuk u "beson llafeve" të mia, as në "sabah" e as në "aksham". Në parim ajo ka të drejtë, sepse unë herë pas here di ta "gënjej", ashtu njësoj siç këtë di ta bëjë "mashtuesi çerek intelektual". Ajo e di fare mirë se unë jam prej mishi, gjaku dhe prej kockash dhe se jam e "vërteta e saj dhe imja", thjesht jam një vëlla "i vogël me fytyrë prej karagjozi" dhe kurrëgjë tjetër. Të gjitha këto desha t'i nxjerr këtu, ngase shkrimi paraprak më solli një "mal me telashe" dhe një "lumë me qortime", pikërisht nga motra e madhe. Çështje e vërteta, unë prisja që ajo të më uronte a të më thoshte së paku një "afetim", apo atë dëshirën e mirë: Ma gëzofsh mundin! Lëre që nuk e bëri këtë, por edhe më tha: "Dëgjo vëllaço! Nëse ti do vazhdosh të bësh ironinë a sarkazmin, nëse orë e çast do të ndërrosh mendje dhe bajrak, dije se shkrimet, opinionet, por thuaj edhe vështrimet, gjithmonë do të dalin ters, me qeder e me hata..., ti që hiqesh paksa mendjemadh e pak i hollë e i mprehtë nga fiqiri, më duhet të të them se shkarravinën paraprake e kishe si xhami i krisur, këmbë e krye njësoj si punët e tua, njësoj si puna e atij bujkut që dikur e kishte mbjellë arën e tij me manaferra duke haruar se ato bimë kacavarëse plot gjemba një ditë do të shtrihen në arën e fqinjit, njësoj si puna e atij sk-

## "KUR UNË NDËRROJ FIQIR DHE BAJRAK!"

raparllit nga vakti i mbretit Ahmet Zogolli, i cili kishte vajtur në Vlorë me njetin që ta çlirojë kasabanë e beut Ismail, e më pas, rastësisht e pahir, kishte pushtuar shehrin e gjirokastritëve tamahqarë dhe, së fundi, do t'u përngjash pasardhësve të gjysh haxhibabës!". Meqenëse u gjenda "ngushtë" a në një situatë të "palakmueshme", edhe përtej "inacit" tim, i kërkova shpjegime shtesë në veçanti për meselenë, ku kryeprotagonist qenkësh gjysh haxhibaba nga një lagje e qytetit të vjetër të Tetovës. Ma ktheu me një "shikim të akullt": "O qerrata, ti që edhe pas gjashtë dekadash, hiqesh si çapëni i fisit dhe që njëkohësisht konsiderohesh si më i dashuri, më i shtrënjti a edhe si loçka e nënëlokesonë, ty që të kanë dalë mendtë mbi kokë, vazhdoje dhe bëje vetë historinë e punëve tua, të skraparllit, atë të gjysh haxhibabës si dhe meseletë e tjera që janë pjellë e imagjinatës sate!". Eh, seç më zuri "belaja!"

Kur mendova se përfundoi me "insistimet e saj karshi mos-ndërrim-mendjes" sime, ia ktheva: Zerra, a nuk ma zaptove shkrimin! Në mungesë të "pohimit të saj të vonuar", ajo ma ktheu: "Shkrimet tënd, shtoja edhe paragrafin të cilin sot e gjithë ditën e Perëndisë e kam ndërmend..., dikur moti, pluralistët shqiptarë të një partie, pas 16 vjet papunësie, të sistemuan në një punë

pranë një institucioni shtetëror, si alamet këshilltari! Asokohe, babai ynë e kishte pyetur gruan e tij gjegjësisht nënën tonë mendjefemër: Pa më thuaj, moj grua, ç'punë do bëjë ky çuni i nënës prej jorgani!" Meqenëse ajo nënëloke nuk kishte haber për nocionin këshilltar, po që edhe nuk ndërronte mendjen, ishte përgjigjur: "Fillimi-sht ky nuk është çun prej jorgani. Ky djali ynë, do t'u japë mend njerëzve! Ehe, moj grua, ai nuk ka mend për vete e lëre më t'u japë të tjerëve!" Duke qenë i ndërgjegjshëm se motra e humanizoi këtë mesele, thashë: hë, ti vëllaço i "mbarë, a prapë do ta "gënjesht" motrën e madhe. Gjysh haxhibaba është një shembull i mirë, human dhe emancipues se si nuk duhet të ndërrosh fiqir, lëkurë dhe bajrak. Axhaminjtë e një familjeje aristokrate kishin ardhur në një përfundim denigrues. Kishin vendosur që "gjysh haxhibabës", detyrimisht t'i merren të gjitha "kompetencat" e të qenit kryepar i familjes. Dhe, kur "gjysh haxhibaba" parashtroi pyetjen "se me ç'sebeb e bëni këtë", ata ia kthyen përgjigjen: "Ne kemi një mijë e një arsye që të mos të besojmë më, sepse ti nuk i bën punët ashtu si duhet..., sepse ti ke filluar të rrjedhësh nga fiqiri, sepse ti këto punët tona i bën lëmsh, sepse ti gjysh haxhibaba ynë je shndërruar në

Pikërisht po këta pasardhës të haxhibabës, pas shumë vitesh, kishin nxjerrë përfundimin se gjyshi kishte pasur të drejtë që ishte shqetësuar për mungesën e kryeparit të familjes, i cili nuk ndërrohet fiqir e bajrak, për një kryeplak i cili do t'i pleqërojë punët dhe hallet e axhaminjve



një portë prej aksham pazari, në një llafazan dhe thashethemexhi, sepse ty s'të mban më pragu i shtëpisë, sepse ti nuk mban dot të fshehtat tona, sepse ti nuk je i gatshëm të ndërrosh mendje, sepse ti nuk ke rroba dhe llafe allafrënga", e të tjerë "pordhë" arsye të parashtruara nga këta "namqorë dhe edepsëza axhaminj!" Këtë e kishte kundërshtuar me të drejtë gjyshi mendjendritur, duke thënë: "Unë nuk jam si telekomanda e televizorit, që kur e shtyp atë dhe hop të del karshi goca gjy-

smëlakuriqe dhe po nuk deshe ta shikosh atë, atëherë prapë e shtyp atë, për të ndërrosh kanalin, dhe hop të del para politikani (që nuk i ka punët në terez) me presh në dorë. Nëse vazhdoni të ndërrosh mendje, dini se një ditë do të ndërrosh identitetin, do të ndërrosh, parti e bajrak, ndoshta edhe do ta paragjykoni edhe nënën që ju ka sjellë në këtë dynja!" I gjithë ky veprim i tyre ishte i dobët, i ulët dhe skajshmërisht i shëmtuar aq sa nuk mund t'ia japësh "mananë kësaj vakie", një vaki që i përngjan punës së gjitarëve që bëjnë nevojën nga poshtë, gjithandëj ku lëvizin lirshëm. Ky muhabet kalamaish kryeplakut të shtëpisë sikur ia solli shpirtin ndër dhembë. Qe detyruar ta lakojë atë shprehjen e vjetër proverbiale: "Derisa isha i ri, nuk guxoja të flisja para pleqve, kurse tani, si u plaka, nuk marr guxim të llafos para të rinjve!"

Pikërisht po këta pasardhës të haxhibabës, pas shumë vitesh, kishin nxjerrë përfundimin se gjyshi kishte pasur të drejtë që ishte shqetësuar për mungesën e kryeparit të familjes, i cili nuk ndërrohet fiqir e bajrak, për një kryeplak i cili do t'i pleqërojë punët dhe hallet e axhaminjve.

**P.S.** Miku! Unë bëra shkrimin. Nuk ndërrova mendjen..., qoftë ajo sado e trashë!



Nga  
Fadil LUSHI



Janë tre shtete që, më të ndryshëm nuk mund të ishin. Hungaria e vogël, e krishterë, ka më pak se dhjetë milionë banorë. Turqia, myslimane, ka një popullsi prej afro 83 milionë banorësh. Federata ruse, me shumicë të krishterë, ka 150 milion banorë. Në pamje të parë, të tre këta shtete dukej se nuk kishin asgjë të përbashkët. Po atëherë, pse po provokojnë kaosin, në rendin ndërkombëtar?

## Nostalgjitë perandorake që destabilizojnë Evropën

Sh tet anëtar i Bashkimit Evropian, e thirrur ditë më parë në zgjedhje, Hungaria i dha për herë të tretë një mandat shumice Kryeministrit Viktor Orban, njeriu që shpiku konceptin e "demokracisë joliberalë", një regjim në të cilin udhëheqësit zgjidhen, por mjetet e informimit janë të kontrolluara, dhe ku liritë vazhdojnë të reduktohen. Hungaria ka hyrë në rrugën e përplasjes me të gjitha vlerat e Bashkimit Evropian, ku në fakt nuk ka ekskluzivitet sepse, që nga Polonia, edhe shtetet të tjera me prejardhje nga ish blloku sovjetik ndajnë me të refuzimin, e cilitdo lloj mbinacionalizmi evropian.

Turqia, vend anëtar i NATO-s qysh prej fillimit të viteve pesëdhjetë, vazhdon të afrohet me Rusinë, prej ku blen armë, ndërkohë që



rrizikon gjithnjë e më shumë të përplasjet ushtarakisht në Siri, me SHBA apo Francën, për çështjen e kurdëve, të vënë në shënjestër prej Ankarasë, por të cilëve SHBA u besojnë, për të mposhtur Shtetin Islamik. Sa për Rusinë, e dimë mirë se si janë gjërat. Mbetet për të kuptuar se çfarë i bën këta tre vende, shkak të kaq shumë

problemeve. Përgjigja është se, që të tre vuajnë dhimbjen e shkaktuar prej një gjymtimi. Në fundin e Luftës së Parë Botërore, Hungaria humbi më shumë se dy të tretat e territoreve të veta. Në po të njëjtën epokë, Turqia humbi atë që kish qenë një prej perandorive më të mëdha të historisë, perandoria otomane. Ndërsa

Rusia, humbi tridhjetë vjet më parë Evropën qendrore që kishte "pushtuar" Stalini, dhe perandorinë që carët kishin ndërtuar gjatë shekujve. Sot, Hungaria ëndërron të rikthehet tek madhështia e të kaluarës, duke kultivuar nacionalizmin e popullive hungareze që jetojnë në territoret e humbura. Pasi u përpoq të rigjejë kufijtë perandorakë përmes një projektimi ekonomik dhe politik, Turqia dëshiron të pengojë kurdët e Sirisë që të fitojnë pavarësinë, me frikën se kjo mund të ushqejë irredentizmin e kurdëve turq. Rusia, në fund, do të donte të vendoste një protektorat mbi vendet që një herë e një kohë ishin pjesë e perandorisë së carëve. Në thelb, Hungaria, Turqia dhe Rusia kanë të përbashkët faktin që nuk kanë pranuar ende, se nuk janë më ato që ishin dikur.

(France Inter)



Nga  
Bernard GUETTA

**Mos e hidhni më lëkurën e bananes, ja përfitimet e saj shëndetësore**



Banaja është një frut me shumë vlera ushqyese. Një pjesë e vlerave të saj ushqyese dhe proteinike ndodhen në lëkurën e bananes. Lëkura e bananes sjellë përfitime të shumta shëndetësore si:

- Ul rrezikun e diabetit në 12%
- Ju siguron rreth 17% të vitaminës C në baza ditore dhe për pasojë ju forcon sistemin imunitar.

- Ju siguron rreth 12% të kaliumit në baza ditore, element i cili është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e qelizave, indeve dhe organeve.

- Ju siguron rreth 20% të vitaminës B-6 dhe ju ndihmon të rrisni nivelin e energjisë.

Lëkura më e mirë është ajo e bananeve jeshile sepse e mbajnë lart nivelin e dopaminës dhe serotoninës si dhe ndihmon në humbjen e peshës sepse ka përmbajtje të lartë probiotike.

Merrni lëkurën e bananes dhe lajeni. Priteni në copa të vogla dhe vendoseni të ziejë për disa minuta. Pijeni lëngun e lëkurës së bananes çdo ditë, në mëngjes ose darkë.

# PËRSE AUTIKËT NUK I SHIKOJNË TË TJERËT NË SY

Autikët kanë pasur rezultate të ngjashme si të njerëzit jo autikë, ndërsa janë lejuar të shikojnë lirisht në fytyrë, por kur u udhëzuan të përqendroheshin në sy, skanimet e trurit treguan se truri i autikëve u aktivizua në një shkallë më të madhe

Autikët në përgjithësi e shmangin shikimin sy më sy. Shpesh njerëzit e tjerë mendojnë se janë të turpshëm ose indiferentë apo se kjo është një shenjë ngathtësie. Por tani studiuesit kanë përdorur skanimet e trurit të pacientëve autikë dhe kanë vënë re se kontakti me sy është stresues dhe i pakëndshëm për ta. Studiuesit në Spitalin e Përgjithshëm Masaçusets në SHBA zbuluan se kontakti me sy e mbingarkon trurin e një autiku.

Dr. Nouchine Hadjikhani, autor i studimit, tha se "rezultatet treguan se në kundërshtim me atë që është menduar, mungesa e dukshme e interesit ndërpersonal në mesin e njerëzve me autizëm nuk vjen për shkak të mungesës së shqetësimit". Është e natyrshme që njerëzit që nga lindja të kenë kontakt sy më sy. Kjo aktivizon sistemin subkortikal të trurit, ndërsa tek autikët, ky rajon është tepër i ndjeshëm ndaj efekteve të shikimit të drejtpërdrejtë dhe shprehjes emocionale. Dr. Hadjikhani dhe kolegët e tij panë dallimet të njerëzit me autizëm dhe të pjesëmarrësit e tjerë kur ata shiheshin përballë apo lirisht ose kur ishin të detyruar të shihnin sytë.

Autikët kanë pasur rezultate të ngjashme si të njerëzit jo autikë, ndërsa janë lejuar të shikojnë lirisht në fytyrë, por kur u udhëzuan

të përqendroheshin në sy, skanimet e trurit treguan se truri i autikëve u aktivizua në një shkallë më të madhe. Kjo u vërtetua lehtësisht ndërsa shiheshin fytyrat e tyre me pamje të tmerruara, edhe pse e njëjta pamje u vu re kur shikonin fytyra të lumtura, të zemëruara dhe neutrale. Studiuesit thonë se kërkimet e tyre, të cilat janë botuar në revistën shkencore "Raportet shkencore", mbështesin idenë se ekziston një mungesë ekuilibri midis rrjetit 'nxitës' të trurit, i cili reagon ndaj stimulimit dhe rrjetit frenues, i cili e qetëson atë.

**MOS E DETYRONI TË KETË KONTAKT SY MË SY.** Dr. Hadjikhani pohon: "Studimet tregojnë se

detyrimi i fëmijëve me autizëm për të parë sytë e dikujt në terapinë e sjelljes mund të krijojë shumë ankth për ta". "Një reagim i ngadalshëm për të pasur një kontakt sy më sy, mund t'i ndihmojë ata ta kapërcëjnë këtë sjellje të tepruar dhe të jenë në gjendje ta trajtojnë kontaktin në sy në një afat më të gjatë, duke shmangur këto efekte që kjo shmangie syri ka në zhvillimin e trurit të tyre".

**A SHKAKTOHET AUTIZMI NGA NJË VIROZË NË SHTATZËNI?** Të kesh temperaturë gjatë shtatzënisë mund ta rrisë rrezikun që fëmija të ketë autizëm. Këto janë kërkimet e publikuara së fundmi.

## Pse nuk duhet t'i thani kurrë rrobat brenda në shtëpi



Në ditë kur bie shi gjëja e parë që bëjmë është të fusim rrobat e nderura brenda në shtëpi dhe t'i lëmë të thahen aty. Mirëpo, sipas ekspertëve kjo metodë është e gabuar dhe e dëmshme. Pikë së pari tharja e rrobave brenda në shtëpi rrit lagështirën e dhomës dhe inkurajohet shtimi i mykut. Pastaj kjo ndikon edhe te personat që kanë probleme me frymëmarrjen, astmën, sistem të dobët

imunitar apo probleme të lëkurës.

Në fakt, ky akt është më shumë i rrezikshëm për bebet, fëmijët dhe të moshuarit. Ekspertët thonë se është tejet e rekomanduar që rrobat t'i thani jashtë. Por, nëse kjo është e pamundur dhe vendosni t'i thani brenda, atëherë gjithsesi duhet t'i lini dritaret hapur herë pas here në mënyrë që të freskohet dhoma.

## Thashethemet na mbajnë gjallë

Ndihet keq se bëni thashetheme? Mos u shqetësoni, është normale, pasi kjo gjë na diferencon nga kafshët. Ekspertët tregojnë se thashethemet na bëjnë njerëzor dhe na ndihmojnë që të jetojmë më gjatë. Thashethemet dallojnë specien tonë nga speciet tjera të gjalla, ndërsa ato na ndihmojnë që të marrim sa më shumë informacion dhe se kujt duhet t'i besojmë.

Profesori i psikologjisë në Universitetin e Oksfordit, Robin Dun-

bar, mendon se thashethemet janë gjëja më e rëndësishme për njeriun, madje është edhe arsyeja kryesore që na mban gjallë. "Thashethemet janë thjesht biseda me njerëz, të cilët i mbajnë të informuar me atë që ndodh. Thashethemet na bëjnë njerëzor. Ato nuk janë parë në këndvështrimin negativ deri në shekullin 18. Kanë një impakt të madh te njeriu, sidomos kur bëhet fjalë për lumturinë dhe mbarëvajtjen", është shprehur profesori Dunbar.

Ndërkohë, edhe profesori i historisë në Universitetin e Jerusalemit, Yuval Noah Harari ka thënë se, ata që bëjnë thashetheme, tregojnë se kujt duhet t'i besojmë dhe kujt jo. Sipas tij, pjesa më e madhe e komunikimit njerëzor mbulohet nga thashethemet.

"Sot pjesa më e madhe e komunikimit njerëzor mbulohet nga thashethemet, pavarësisht nëse është e-mail apo telefonatë. Kjo vjen shumë natyrshëm, sa që duket sikur aftësinë për të folur e



shfrytëzojmë vetëm për këtë gjë", është shprehur ai, raporton "Metro". Por nga ana tjetër, duhet të

kini kujdes me thashethemet që bëni gjatë ditës, duke mos lënduar kolegët apo miqtë tuaj.

Google dhe "sivëllezërit" kanë në dorë botën. Kanë një fuqi prej 2 mijë miliardë dollarë, qindra-miliona klientë, dinë gjithçka për ne dhe mund të ndikojnë në zgjedhjet që bëjmë. Pesë gjigantët amerikanë të Internetit - Amazon, Facebook, Microsoft, Apple dhe Google, janë padronët e vërtetë të botës. Dhe disa kanë nisur të shqetësohen

# PRONARËT E BOTËS



Dinë gjithçka për ty. Çfarë të pëlqen, atë që shkruan dhe mendon, madje edhe ndjesitë e tua. Cfarë blen, ku shkon çdo ditë dhe në çfarë ore. Kur u bindesh zakoneve të tua dhe të gjithë herët që zgjedh kapriçon për t'i shkelur. Janë kudo. Në shtëpi, në xhup, në makinë. Apple, Amazon, Facebook, Google dhe Microsoft janë sovranët e vërtetë transnacionalë. Fuqi të mëdha globale të epokës së Internetit (të gjitha amerikane) që, tamam si ato të vërtetat, janë gjithmonë në luftë mes tyre. Objekti i konkurrencës jemi ne. Apo 2.8 miliardë personat që, ashtu si ne, çdo ditë lundrojnë në internet dhe kanë një kartë krediti. Secili konkurrent dëshiron të bëhet padron i botës, të ketë sa më shumë ndjekës digjitalë dhe të eliminojë konkurrencën. Janë sovranë sa diskretë e të heshtur, aq edhe të fuqishëm. Për të fituar besnikërinë e klientëve, ofrohen që të bëhen furnizues globalë të gjithçkaje, produkte, shërbime dhe zgjidhje që përmirësojnë dhe thjeshtësojnë jetën tonë. Me një të klikuar të mausit. Në këmbim, duan të dinë gjithçka rreth nesh.

Në vitet e parë të jetës, i janë përkushtuar misionit të tyre fillstar: Google u përqendrua tek motori i kërkimit. Apple tek produktet inovativë, të shtrenjtë dhe të projektuar me shije të hollë. Amazon krijoi dyqanin më të madh të librave online. Microsoft e vendosi sistemin e vet të operimit në çdo tryezë pune. Face-

book u rrit si albumi i kujtimeve i kujtdo që lidhet në internet. Ide digjitale ose jo, të cilat kanë sjellë miliarda dollarë fitime. Shpesh herë me praktika fiskale të diskutueshme, që tani po përfundojnë në shënjestër të autoriteteve. Është ky rasti i Apple, ndaj të cilës BE ka ngritur një kauzë që vendos në bankën e të akuzuarit edhe qeverinë irlandeze, falë të cilës Apple ka paguar një normë më pak se 2% për një total prej 137 miliardë dollarësh fitime, për të cilët tani Brukseli do të kërkojë faturën. Të fuqizuara prej këtyre kapitaleve të jashtëzakonshëm, "pesë të mrekullueshmit" u shndërruan në "ngrënës të gjithçkaje". Totalitarizëm i ri, siç thotë themeluesi i Wikileaks, Julian Assange? Një deklaratë e fortë, por është e vërtetë që janë duke ribërë modelin ekonomik botëror. Mund të nxjerrin në pension, shumë shpejt, institucione që deri dje konsideroheshin të përjetshëm. Ja disa shembuj.

**APPLE** me funksionet "Pay" (Pagesë) dhe të njohjes biometrike që sapo janë integruar në iPhone 6, po shndërrohet në qarkun bankar më

## FACEBOOKU MUND TË GJOBITET ME 1 MILIARD DOLLAR

Skandali i Facebookut, që ka prekur rreth 2.2 miliardë përdoruesve mund të sjellë edhe një gjobë rekorde për këtë kompani gjigante, dhe mund të krijojë dobësi të reja ligjore për mos parandalimin e rrezikut nga të dhënat e përdoruesve, thotë tre ish-zyrtarë federalë, raporton Washington Post. Tre zyrtarët, të cilët ishin në Komisionin Federal të Tregtisë gjatë hetimeve të privatësisë që çuan në miratimin e një dekreti me Facebookun më 2011, kanë thënë se skandali i fundit i kompanisë mund të jetë shkelje e dispozitave të dekretit që mund të



kërkojë zbatimin e një programi të privatësisë. Dekreti i shkruar kërkon që Facebooku të identifikojë dhe të adresojë kërcënimet e reja ndaj privatësisë së përdoruesve, thotë David Vladeck, i cili ishte kreu i Byrosë së FTC-së për mbrojtjen e konsumatorit kur dekreti ishte hartuar dhe nënshkruar nga Facebooku. Ai parashikon se Facebooku mund të gjobitet me 1 miliardë dollar apo edhe më shumë për shkak të skandalit për shpërndarjen ilegale të të dhënave të përdoruesve me konsulentin politikë "Cambridge Analytica".

të madh të botës. Mund të paguhet gjithçka me celular dhe mund t'u themi një herë e mirë lamtumirë kartëmonedhave dhe portofolave. Për çdo transaksion, sipas New York Times, do të marrë një përqindje (15 qindarka për çdo 100 dollarë).

**GOOGLE** dëshiron të komandojë qiejt me robotët fluturues pa pilot (ashtu si edhe Amazon) për të dërguar çdo gjë, kudo që të jetë. Po ndërton një rrjet të vetin të satelitë-

ve, për të bërë të mundur dërgimin e Internetit në çdo qoshe të globit. Gjithçka në dëm të kompanive telefonike. Jo vetëm kaq: dëshiron të bëhet botuesi i vetëm i të gjithë informacioneve duke ofruar lajme (me kosto zero) në të gjithë vendet e botës, duke mbledhur ata që prodhohen prej gazetave dhe profesionistëve të lajmeve, që për t'i prodhuar paguajnë pagat e mijëra gazetarëve. Po kështu, ka shfrytëzuar superfuqinë e vet në sektorin e kërkimit për të diskriminuar konkurrencën në rezultate. Një sjellje që e ka sjellë nën lanten zmadhuese të Antitrustit të BE-së: aktualisht investigohet për abuzim të pozicionit dominues dhe rrezikon sanksione të rëndë.

**AMAZON** ofron pothuajse gjithçka, që nga frutat tek sallatat, deri tek veprat e artit dhe lejon të bëhen blerje edhe me një tweet. Lufton fort me bërryla për të qenë i vet-

mi supermarket i botës; tregton muzikë dhe filma, tabletë dhe smartphone, në një konkurrencë totale dhe të hapur me Apple.

**FACEBOOK** ka gjetur një rrugë të shtruar për të konvertuar shijet dhe preferencat tona, në mall për t'ua shitur reklamuesve, është futur në celularë dhe synon që të shkundë marrëdhëniet mes njerëzve, duke i bërë edhe më virtuale, falë një mase që nuk vishet por që simulon realitetin.

**MICROSOFTI** ka kuptuar se koha e kompjuterëve është në perëndim, është futur në sektorin e celularëve dhe tabletëve duke blerë Nokian, ndërkohë që me linjën Surface është duke transformuar kompjuterët në një evolucion të ri të specieve, hibridë gjysmë tabletë dhe gjysmë laptopë. Risqet që miliona njerëz të përfundojnë në duart e këtyre të pestëve janë të dukshëm.

## JA PSE NE HEDHIM ÇDO GJË NË RRJETET SOCIALE

Nëse ka diçka që i ka bërë njerëzit totalisht të varur dhe të fiksuar pas vetes, janë rrjetet sociale. Njerëzit hedhin në rrjete e tyre sociale çdo gjë. Kudo që janë, çfarëdo që janë duke bërë ata e gjejnë një gjë për të hedhur online. Por ka disa arsye pse diçka e tillë ndodh. 1. Dëshira për të krijuar lidhje të reja. Rastësia mund t'iu lidh me njerëz që kanë të njëjtat



interesa me ju dhe shpërndarja e fotografive apo mendimeve mund të jetë një mënyrë për t'u lidhur. 2. Na pëlqen të mendojmë se jemi njerëzit që shfaqemi në rrjete sociale. 3. Na japin siguri. Sa më i madh të jetë numri i pëlqimeve aq më të sigurt ndihemi. 4. Na pëlqen ideja e të pasurit aq shumë kujtime që ruhen si një album virtual.

Nëse një shoqërie i kërkohe të adaptojë një sistem të ri vlerash, afatet nuk maten me vite, por me dhjetëvjeçarë, beson shkrimtarja Anila Wilms. Dhe kjo vlen edhe për Ballkanin Perëndimor

Komisioni i BE-së ia doli të na habisë të gjithëve me lajmin se Ballkani Perëndimor, e fundit njollë e bardhë në hartën e Europës, do të pranohet në BE. Jo në një të ardhme të largët, por duke filluar që nga viti 2025. Personalisht s'kam qenë kurrë e sigurt nëse do ta arrija këtë ditë të mbarë apo jo. E megjithatë sot s'po u gëzuakam dot.

Dokumenti që ka botuar Komisioni me këtë rast është mjaft interesant nga disa pikëpamje. Bie në sy menjëherë se si e konsideron Brukseli Ballkanin Perëndimor: si një pacient të sëmurë rëndë që dergjet para portës së BE-së – ndaj dhe i takon kësaj të fundit që ta mjekojë. Sipas këtij dokumenti, hyrja e Ballkanit Perëndimor në Union nuk është asgjë më pak se një "investim gjeostrategjik në sigurinë" e qytetarëve të BE-së. Flitet për bashkëpunim policor dhe gjyqësor, për sigurinë kufitare dhe riatdhesimin e emigrantëve të paligjshëm, për strategji kundër terrorit dhe radikalizimit në BE, kundër kontrabandës së armëve e drogës apo pastrimit të parave. Arsyeve të sigurisë u shtohen edhe ato ekonomike: Ky rajon është një treg premtues për mallrat dhe shërbimet e BE-së; në kthim, rajonit do t'i rritet mirëqenia dhe do t'i përmirësohet qeverisja, shkruan shkrimtarja Anila Wilms.

# BE DHE PALLKANI PERËNDIMOR, DETYRË PËR DISA BREZA



Pason një listë pambarisht e gjatë me detyrat që u dalin kandidatëve të rinj me këtë rast: të drejtat e njeriut, dialogu konstruktiv në politikë, pavarësia e mediave, të drejtat e pakicave, lufta kundër kriminit të organizuar dhe korrupsionit të autoriteteve. Dhe si pikë qendrore, mbizotëruese: zgjidhja e konflikteve fqinjësore.

## DY SISTEME VLERASH TEPËR TË NDRYSHËM

Lexuesi e ndjen se pikërisht ky është kyçi, simptoma bazë nga e cila vuan Ballkani Perëndimor. Të gjitha sëmundjet e tjera lidhen me mënyrën se si trajtohen konfliktet atje. Konfliktet në Ballkan nuk zgjidhen. Konfliktet fitohen. Ose humben. Dhe mjerë ai që humb.

Tradicionalisht popujt e Ballkanit janë popuj luftarakë. Zhvillimi i

tyre nuk njihet asnjë nga fenomenet e mëdha historike që formuan Europën Qendrore në Kohën e Re: Reformacioni, Iluminizmi, Revolucioni Industrial. Është e vërtetë se Europa është shumë më e përpunuar për sa i përket konsensusit, kompromisit, bashkëpunimit. Dhe patjetër që zhvillimi i dëshiruar i shoqërive në kohën e sotshme s'mund të shkojë veçse në këtë drejtim.

## CILAT JANË PERSPEKTIVAT?

Duke pasur parasysh zhgënjimin e popujve të BE-së me Brukselin në vitet e fundit, duhen bindur ata me "fakte dhe informacione" mbi avantazhet e pranimit në Union të Ballkanit Perëndimor. Është pa dyshim një ndërmarrje që do t'u kushtojë shtrenjtë, prandaj afrimi duhet "të ndodhë gradualisht, në krahasim me zgjerimet e

mëparshme, të befafishme".

E megjithatë, sakrificat më të mëdha duhet t'i bëjnë vetë ballkanikët. Jeta e tyre duhet t'i afrohet jetës së përditshme të BE-së, "deri në lëndët që mësojnë fëmijët në shkollë". Kandidatët e rinj duhet të adaptojnë pra një sistem të ri vlerash. Kjo kërkon një "vullnet të fuqishëm politik" dhe "dyfishimin e përpjekjeve" për të shfrytëzuar këtë "rast unik" në histori. Prej popujve të Ballkanit pritet jo më pak sesa që të ndërrojnë krekëput karakterin e tyre. Ka shumë mundësi që kjo lloj kërkese të shkaktojë dhimbje dhe kundërshtim tek ata. Së pari, sepse askush nuk heq dorë lehtësisht nga identiteti i vet. Së dyti, sepse jeta në Ballkan është në pjesën më të madhe e ëmbël. Miqësitë vlerësohen shumë, po ashtu dhe lidhjet familjare. Brenda këty-

re rrjeteve ka shumë shkëmbim, vëmendje dhe ndihmë të singërtë, respekt dhe besnikëri; njerëzit janë të kënduar dhe me dell poetik, kanë ideale të larta dhe zemër të madhe, qeshin me gjithë shpirt dhe bëjnë njëri-tjetrin të lumtur. Por edhe "bëmat heroike" të paraardhësve janë pjesë e identitetit kolektiv, për të cilin brezat kanë qenë gjithmonë krenarë. Në të njëjtën kohë ka gjithnjë e më shumë njerëz, sidomos të rinjtë, që po kuptojnë se diçka nuk shkon me shpirtrat e tyre. Kultura e urrejtjes nacionaliste apo regjionaliste është një kurth për psikikën. Kur nxemja bie, lë pas rrënoja, plagë e zbrazëti. Ajo e famshme "nostalgi për Europën" s'është në thelb veçse një dëshirë për paqe, dëshirë për shërim. Prandaj unë them se ka shpresë për Ballkanin Perëndimor.

## NJË NDËRTESE E RE

E kam këtë besim, sepse këtë lloj "shërimi" e kam përjetuar vetë në Gjermani. Shembulli gjerman gjithashtu tregon se popujt mund të mësojnë mënyra të reja të trajtimit të konflikteve dhe agresionit. Por, nëse është e vërtetë se pranimi i Ballkanit Perëndimor është në interesin e BE-së, nëse përballë situatës së komplikuar globale bashkimi i popujve europianë është i domosdoshëm, atëherë BE ka nevojë për një koncept krejtësisht të ri; për një ndërtesë më të madhe, me themel më të fortë, me shumë kate e dhoma për familjen e zgjeruar. Nëse do të realizohet një ditë vizioni i ndritur i Evropës si një familje solide e kombeve, ku çdo anëtar kontribuon sipas talenteve të tij, ahëre duhet largpamësi, sensibilitet, aftësi dhe mbi të gjitha durim. 2025 mund të jetë një hap i parë. Por në thelb kjo është një detyrë për disa breza, përfundon shkrimtarja Anila Wilms.

## Greqi, për 2.5 vite përdhunohen 325 fëmijë!

Abuzimi seksual i fëmijëve në Greqi ka arritur përmasa shqetësuese. Të dhënat e policisë greke flasin se në 2,5 vitet e fundit janë përdhunuar 325 fëmijë nën moshën 15 vjeçare, ku shumica e sulmeve është kryer nga anëtarët e familjes. Tre rastet e zbuluara së fundmi të abuzimit seksual të fëmijëve kanë tronditur thellë opinionin grek, shkruan e përditshmja greke "Nea Selida". "Të gjithë e kanë të qartë se rastet e fundit janë maja e ajsbergut", theksohet në tekst. Antonis Magganas, nga Universiteti Panteion në Athinë, tha se fenomeni i pedofilisë është gjatë i pranishëm në Greqi, por vetëm në vitet e fundit ka filluar të përflitet publikisht. "Hulumtimi i institutit për shëndetin e fëmijëve flet se çdo i teti fëmijë është i abuzuar seksualisht. Sulmet seksuale mbi fëmijët e vegjël kanë arritur në përmasa alarmuese", tha Magganas.

Ai shtoi se vetëm së fundmi ka filluar ky problem të debatohet publikisht, meqë në të kaluarën për arsye shoqërore është heshtur. "Ndonëse me vonesë, Greqia ka filluar të rreshtohet ndër shtetet të cilat reagojnë ndaj abuzimit të fëmijëve. Ajo çfarë ka ndryshuar, është denoncimi i problemit, ka filluar thyerja e tabusë 'çfarë do të thonë njerëzit', theksoi më tej Magganas. Kohë më parë, opinionin grek u trondit nga një ngjarje e rëndë në Katerini, ku u zbulua përdhunimi gjashtë vjet me radhë i një 14 vjeçarëje. Policia arrestoi katër persona, në mesin e të cilëve babai i të miturës. Gjithashtu, në Volos, një 70 vjeçar është dënuar me 18 vite burg për përdhunimin e nipit 11 vjeçar, ndërsa në ishullin Kos, është arrestuar një 65 vjeçar për abuzimin seksual të pjesëtarëve të rinj të familjes, të moshës mes shtatë dhe 11 vjeçe.

## Në Kosovë ka filluar testi PISA

Për testin PISA, Ministria e Arsimit pat formuar një komision, i cili me planin dinamik organizoi mbajtjen e dy testeve pilot në të gjitha shkollat e Kosovës



Testi ndërkombëtar PISA ka filluar të enjten në Kosovë, i cili do të mbahet deri më 5 maj, ku në këtë testim do të marrin pjesë 5 mijë e 370 nxënës nga 211 shkolla nga e gjithë Kosova.

Testi fillon në komunën e Prizrenit për të vazhduar në të gjitha komunat e tjera. Sipas rregullave të organizimit të testit ndërkombëtar PISA, nuk lejohet të bëhen publike emrat e shkolla-

ve dhe nxënësve që i nënshtrohen këtij testi. Ministri i Arsimit, Shyqyri Bytyqi, tha se për këtë vit është bërë një përgatitje shumë e mirë, ku secili nxënës e di peshën dhe rëndësinë e testit PISA. Me këtë rast, ai i bëri thirrje edhe Sindikatës së Arsimit që të mos fillojë grevën, për të mos e dëmtuar këtë proces.

Ndërkohë, nga ana tjetër, Sindikata është shprehur e vendosur se nëse Ligji nuk shkon në Kuvend para datës 13, atëherë grevat do të

fillojnë në një afat të pacaktuar. Sindikalistët thonë se për dëmtimin e testit PISA dhe maturën, duhet ta mbajë përgjegjësi Qeveria. Për testin PISA, Ministria e Arsimit pat formuar një komision, i cili me planin dinamik organizoi mbajtjen e dy testeve pilot në të gjitha shkollat e Kosovës.

Përgatitjet u bënë me qëllim ngritjen e vetëdijes së nxënësve dhe mësimdhënësve për rëndësinë e testit PISA. Ky test s'vjetë organizohet në mënyrë digjitale.



## NGA 3078 PALESTINEZË TË PLAGOSUR, 305 JANË FËMIJË!

Nga 3078 palestinezë të plagosur gjatë ndërhyrjes së ushtarëve izraelitë në "Marshin e Kthimit të Madh" në kufirin e Gazës, 105 janë në gjendje të rëndë, njoftoi zëdhënësi i Ministrisë palestineze të Shëndetësisë në Gaza, Eshref el-Kudra.

"Numri i personave të plagosur nga Izraeli u rrit në 3078, prej të cilëve 105 janë në gjendje të rëndë dhe vazhdojnë të trajtohen në repartet e kujdesit intensiv. 305 nga të plagosurit janë fëmijë, 78 gra dhe 12 nga personeli shëndetësor", tha Kudra në një konferencë për media. Kudra theksoi se sipas të dhënave të ministrisë, 129 persona janë qëlluar në kokë ose qafë, duke shtuar se "forcat izraelite qëllojnë me paramendim civilët e paarmatosur që marrin pjesë në marshim". Ai po ashtu tha se 176 nga të plagosurit janë qëlluar në pjesët e sipërme të trupit, 51 në gjoks dhe abdomen, kurse 1027 në pjesët e poshtme të trupit. Zëdhënësi i ministrisë tha se gjatë demonstratave janë shënjestruar drejtpërdrejt edhe katër ambulanca dhe automjete të mbrojtjes civile.

"Numri i personave të plagosur nga Izraeli u rrit në 3.078, prej të cilëve 105 janë në gjendje të rëndë dhe vazhdojnë të trajtohen në repartet e kujdesit intensiv", tha zëdhënësi i Ministrisë palestineze të Shëndetësisë në Gaza, Kudra

Nga ana tjetër, drejtori i përgjithshëm i Barnave dhe Farmaceutikës pranë ministrisë, Munir Beresh, duke folur në konferencë tërhoqi vëmendjen drejt mungesës së barnave dhe materialeve mjekësore në rajon. Ai tha se çdo ditë është duke u rritur numri i dëshmorëve dhe të plagosurve, gjë që shkakton pakësimin e barnave dhe materialeve mjekë-

sore. "Mosplotësimi i rregullt i nevojës për barna në spitale ka shkakuar mungesë të paprecedent të rezervave të barnave", tha Beresh, duke i bërë thirrje organizatave humanitare ndërkombëtare për mbështetje të sektorit shëndetësor në Gaza në mënyrë që të vazhdohet trajtimi i të plagosurve dhe të sëmurëve.

Ndryshe, sipas Ministrisë palestineze të Shëndetësisë, të paktën 32 palestinezë kanë rënë dëshmorë nga sulmet e ushtrisë izraelite që nga 30 marsi, kur palestinezët filluan të tubohen përgjatë kufirit lindor të Rripit të Gazës me Izraelin. Tubimet janë pjesë e një demonstrate gjashtë javore që do të kulmojë më 15 maj. Kjo ditë do të shënojë 70 vjetorin e krijimit të Izraelit, ngjarje që palestinezët i referohen si "Nakba" ose "Katastrofa". Demonstruesit kërkojnë që refugjatëve palestinezë t'u jepet "e drejta e kthimit" në qytetet dhe fshatrat e tyre në Palestinën historike, nga e cila u dëbuan në vitin 1948 për t'i hapur rrugën krijimit të shtetit të ri të Izraelit.

## Perëndimi mund të godasë Sirinë për 72 orë, thirrje për kujdes në Mesdhe

Sulmi me armë kimike në Siri ka hapur një spirale të re lufte në Lindjen e Mesme, teksa Perëndimi për të parën herë duket se nuk do të qëndrojë "duarkryq" përballë vrasjeve të panumërta të civilëve nga regjimi i Asadit dhe Ruisisë. Donald Trump, Emanuel Macron dhe Theresa May duket se janë në një mendje dhe do të urdhërojnë nisjen e një ofensive ushtarake në Siri gjatë dy ditëve në vijim, ndërsa thirrja për kujdes të shtuar kryesisht në Mesdhe,

po përhapet në mediat ndërkombëtare. Edhe Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA) ka lëshuar një alarm për rrugët ajrore në Mesdheun Lindor sipas raporteve të mediave ndërkombëtare, alarmi u lëshua "për shkak të fillimit të mundshëm të sulmeve ajrore ose detare me raketa ndaj Sirisë brenda 72 orëve të ardhshme". EASA gjithashtu thekson se "mundësia e ndërprerjes së radio navigimit" gjithashtu duhet të merret parasysh.



## Aksidentet në BE kanë shkakuar vdekjen e 25.300 personave

Aksidentet e trafikut të cilat kanë ndodhur në shtetet e Bashkimit Evropian (BE), gjatë vitit 2017, kanë shkakuar vdekjen e 25.300 personave. "Gjatë vitit 2017, në rrugët e BE-së, kanë humbur jetën 25.300 persona, ndërkohë që shumë persona kanë marrë lëndime të cilat do t'i ndryshojnë jetën. Besoj se BE-ja mund të bëjë më shumë për të mbrojtur evropianët", tha Violeta Bulc, komisionere e BE-së për Transport. Bulc shtoi më tej se Komisioni Evropian është duke punuar në drejtim të ndër-

marrjes së hapave konkret për rritjen e sigurisë nëpër rrugë, me qëllim kryesor, të shpëtimit të më shumë jetëve. Të dhënat e publikuara flasin se numri i të vdekurve gjatë vitit 2017, është për dy për qind më i ulët nga viti paraprak. Komisioni Evropian thotë se rreth 135.000 persona në vit, marrin lëndime të rënda trupore. Statistika dëshmon për një ulje të vdekshmërisë në rrugët e Suedisë, Britanisë së Madhe, Holandës dhe Danimarkës, dhe vdekshmëri të lartë në Rumani dhe Bulgari.

## Muajin e kaluar kanë vdekur mbi 780 civilë



Rrjeti Sirian për të Drejtat e Njeriut (SNHR), bëri të ditur se në 54 masakra, 40 prej të cilave të realizuara nga regjimi Asadit muajin e kaluar, kanë humbur jetën 783 civilë, gjysma e të cilëve gra dhe fëmijë. SNHR ka publikuar raportin e muajit mars të vitit 2018, në lidhje me sulmet të cilat i klasifikon si masakra. Në raport theksohet se muajin e kaluar kanë humbur jetën 783 civilë, në 54 masakra të kryera nga regjimi i Asadit, Rusia, organizata terroriste YPG/PKK dhe palët e

tjera, prej të cilëve 198 fëmijë dhe 138 gra. Sipas raportit, forcat e regjimit muajin e kaluar në Siri kanë kryer gjithsej 40 masakra, prej të cilave 39 në Gutën Lindore. Në raportin e SNHR gjithashtu theksohet se në këtë periudhë Rusia ka kryer 4, YPG/PKK 2 dhe grupet tjera që përleshën 8 masakra. Më tutje në raport thuhet se në masakrat e regjimit kanë humbur jetën gjithsej 620 civilë, prej të cilëve 142 fëmijë dhe 105 gra, ndërsa forcat ruse të cilat i japin mbështetje ajrore

regjimit, kanë vrarë 78 civilë prej të cilëve 41 fëmijë, 14 gra. Në masakrat e terroristeve të YPG/PKK kanë humbur jetën 17 civilë prej të cilëve 5 gra, ndërsa palët tjera të cilat përleshën në Siri kanë vrarë 68 civilë prej të cilëve 15 fëmijë dhe 14 gra. Në raport është kërkuar që t'i bëhet presion shteteve që e mbështesin organizatën terroriste YPG/PKK, ndërsa është kërkuar që t'i jepet fund shkeljeve që i bëjnë organizata si dhe mbështetja me armë që i sigurohet organizatës.

TREVAT VERILINDORE SHQIPTARE DHE REZISTENCA ANTIKOMUNISTE 1945-1948 (2)

# KUR SHQIPTARËT VRITESHIN GJITHANDEJ



Nga Qerim LITA

(vijon nga numri i kaluar)

Ashtu siç edhe pritej, posa u vendosën brigadat partizane shqiptare, njësitë ushtarake komuniste jugosllave ndërmorën një aksion të tmerrshëm kundër popullsisë shqiptare, që nga Struga e deri në Kumanovë, me ç'rastë vranë dhe masakruan qindra shqiptarë të pafajshëm, mira të tjerë arrestuan duke i vendosur nëpër kampet e përqendrimit, nëpër kazermat ushtarake e lokalitete tjera, siç ishin: Monopoli i Duhanit në Tetovë, kazermat ushtarake në Kërçovë e Gostivar, pastaj shkollat në Saraqinë e Grupçin, kampet e përqendrimit në Vaksincë e Preshevë etj.. Veprimet e tilla kryheshin me urdhër të udhëheqjes së lartë politike e ushtarake maqedonase.

Krimet dhe masakrat partizane ndaj popullsisë civile shqiptare e shtynë nënkryetarin e Frontit Popullor të Republikës Federale të Maqedonisë, Hasan Shukriun të reagoj, i cili në mbledhjen që u mbajt më 7 dhjetor 1944, vuri në dukje për disa ngjarje të pakëndshme dhe arbitrare nga ana e forcave partizane, ndaj popullsisë shqiptare, ku ndër të tjerash tha: "në fshatin Sopot të Kumanovës janë vranë 66 fshatarë, edhe pse ky fshat nga e kaluara u ka ndihmuar partizanëve, në fshatin Malishevë janë vranë 42 persona, në fshatin Izvor 40 vetë, fshatin Vaksincë 16 veta. Në Tetovë janë burgosur 5000 vetë prej të cilëve 17 vetë kanë vdekur nga uria..."

Duhet të vëmë në dukje faktin se shqiptarëve jo vetëm se u shpallën si pakicë, por madje atyre ju morën edhe disa të drejta të pakta qytetare e kombëtare, që ju ishin garantuar me vendimet e KAÇKM-së, siç ishin: përdorimi i lirë i flamurit kombëtar, pjesëmarrja proporcionale në këshillat popullor, përdorimi i gjuhës shqipe dhe përfshirja e barabartë e shqiptarëve në administratën e komunave ku ata jetonin etj. Mosdhënien e këtyre të drejtave, autoritetet komuniste të Shkupit, e arsyetonin gjoja nga "pakënaqësia e popullsisë maqedonase në viset perëndimore të Maqedonisë", e cila siç vihej në pah: "që dyfish e robëruar gjatë okupacionit shqiptar", andaj ajo: "me një rezervë të madhe i pranon këto ndryshime dhe ndihet si e distancuar". Ky rezervim i popullsisë maqedonase, sipas anëtarit të KAÇKM-së, Jordan Ballazheski, ishte për shkak se: "nëpër objektet shtetërore krahas



**Dhuna dhe terrori i udhëheqjes komuniste maqedonase vazhdoi edhe në fillim të vitit 1945. Më 14 janar të atij viti, Gjyqi ushtarak i qarkut ushtarak të Shkupit, dënoi më vdekje pushkatim 19 veprimtarë të shquar shqiptar nga Fushëgropa e Kumanovës: Ramadan Qazim Azizi nga fshati Mateç, Asan Zeqir Azizi nga fshati Mateç, Sadik Ramiz Jakupi nga fshati Mateç, Bexhet Musli Dalipi nga fshati Mateç, Jusuf Ismail Neziri nga fshati Mateç, Abdulla Ebip Abdullahu, apo siç njihej në opinion Mulla Dulla i Hotlës, Osman Selim Hiseni nga fshati Mateç, Shaip Rexhep Memeti nga fshati Vaksincë...**

flamurit shtetëror qëndrojnë edhe flamujt shqiptarë; shqiptarët në mënyrë të barabartë marrin pjesë gjatë zgjedhjeve të këshillave nacionalçlirimtare, qofshin të qyteteve apo të fshatrave; ata e parashtrajnë çështjen që në plenum dhe nëpër këshillat ekzekutive të kenë më shumë përfaqësues të tyre; e shtrajnë çështjen edhe të vetë administratës, e cila duhet të udhëhiqet paralel me administratën tonë (maqedonase- Q. L.), prandaj kërkojnë edhe numër të njëjtë të nëpunësve në administratë; nëpër institucionet shtetërore në detyrë kanë ngelë të gjithë nëpunësit shqiptar të regjimit të kaluar të cilët kanë ardh nga Shqipëria e vjetër.etj". Në vazhdim Bllazheski, kërkonte ndërprerjen e menjëhershme të politikës sipas tij "shqiptaro madhe", e cila mund të arrihej nëse nga ana e Presidiumit të KAÇKM-së, do të ndërmerreshin masat si vijojnë: "të shkarkohen nëpunësit shqiptar të cilët kanë ardh nga Tirana; që turqve t'u jepen më shumë poste dhe të drejta, të cilët tash për tash nuk mund të vijnë në shprehje nga shqiptaro-mëdhenjtë; dhe, njëkohësisht të drejtat dhe obligimet të jepen, jo sipas numrit të popullsisë, por sipas pjesëmarrjes në luftën nacionalçlirimtare."

Dhuna dhe terrori i udhëheqjes komuniste maqedonase vazhdoi edhe në fillim të vitit 1945. Më 14 janar të atij viti, Gjyqi ushtarak i qarkut ushtarak të Shkupit, dënoi më vdekje pushkatim 19 veprimtarë të shquar shqiptar nga Fushëgropa e Kumanovës: Ramadan Qazim Azizi nga fshati Mateç, Asan Zeqir Azizi nga fshati Mateç, Sadik Ramiz Jakupi nga fshati Mateç, Bexhet Musli Dalipi nga fshati Mateç, Jusuf Ismail Neziri nga fshati Mateç, Abdulla Ebip Abdullahu, apo siç njihej në opinion Mulla Dulla i Hotlës, Osman Selim Hiseni nga fshati Mateç, Shaip Rexhep Memeti nga fshati Vaksincë, Jusuf Xhemal Imeri nga fshati Vaksincë, Ahmet Beqir Abdullahu nga fshati Llopat, Hajri Islam

Sadiku nga fshati Vishticë, Musa Hasan Eshtrifi nga fshati Mateç, Jusuf Zyber Nuredini nga fshati Mateç, Jashar Feta Jashari nga fshati Mateç, Bajram Idriz Beqiri nga fshati Mateç, Halit Abdulla Shabani nga fshati Mateç, Raim Beqir Fazliu nga fshati Mateç, Halit Shukri Hebibi nga fshati Likovë dhe Osman Hiseni nga fshati Mateç.

Një ditë pas këtij vendimi, përkatësisht, më 15-16 janar 1945, në Shkup u mbajt Konferenca e rinisë komuniste ballkanike, në të cilën, Liri Belishova, anëtare e Byrosë Politike e K.Q. të PKS-së, fjalimin e saj do ta ketë në frymën e vëllazërim-bashkimit, pa asnjë fjalë kritike ndaj sjelljeve të ushtrisë jugosllave ndaj popullit shqiptar, duke u shprehur me fjalët: "Vëllazërimin tonë me rininë jugosllave e kemi forcuar në luftën për Dibrën dhe në luftërat e territoreve të tjera të Jugosllavisë. Ne kemi bërë kumarti në burgjet, për kundër provokimeve të shumta, për të na detyruar të luftojmë kundër njëri-tjetrit, ta ngrejmë ushtrinë tonë nacionalçlirimtare kundër ushtrisë nacionalçlirimtare të Marshalit Tito. Edhe përkundër të gjitha atyre përpjekjeve ne nuk qëndruam kundër njëri-tjetrit, simpatia-dashuria e rinisë shqiptare ndaj rinisë jugosllave sot është shumë e madhe". Ngjashëm si Belishova, shprehet edhe kryetari i Lidhjes së Rinisë komuniste jugosllave, Sllavko Komar, i cili ndër të tjerave tha: "Së bashku me heronjtë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, së bashku me djemtë e popullit të vogël por heroik ne fuqishëm sulmuam si kundër okupatorit gjerman po ashtu edhe kundër ballistëve – shqiptaro-mëdhenj. Me luftimet e përbashkëta si në Dibër po ashtu edhe në Kërçovë ne e përziem gjakun tonë dhe eshtrat tonë dhe futëm themelet e betonuara. Përgjithmonë i shkelëm të gjitha mashtrimet e intrigat e urrejtjes që i bënin armiqtë tanë". Në vazhdim Komar shprehu habinë e tij për një "mbëshetje aq të madhe të komunistëve

shqiptarë" sidomos "lëvizjes rinore" duke pohuar: "mendoj se ndodhi një rast i cili është tepër i rrallë që dy popuj të cilët as për nga tradita, as për nga kultura e gjuha nuk kanë të përbashkët, që gjatë luftës tre vjet e gjysmë të krijojnë një unitet aq të fortë. Rinia shqiptare në LNÇ-ë në Shqipëri sot së bashku me rininë jugosllave i ndjekin fashistët gjerman në krahinat perëndimore të vendit tonë. Ne e shohim që ndihmën që ua ofruam po e kthejnë në mënyrë konsekuente..."

Për dallim nga komunistët shqiptarë, intelijenca e atëhershme shqiptare, në ato rrethana, e shihte si më se të domosdoshme themelimin e një organizate ilegale shqiptare, qëllimi final i së cilët do të ishte: "Çlirimi dhe bashkimi i tokave të robëruara shqiptare me Shqipërinë". Grupi nismëtar i përbërë prej Azem Maranës, Hasan Bilallit, Mahmut Dumanit, Hysni Qemal Ejupit, Qemal Qazimi, Nebi Veli Jonuzi dhe Nuredin Ibrahimit, pas katër takimeve të mbajtura në shtëpitë të Hysni Qemal Ejupit dhe të Nebi Veli Jonuzit, në muajin janar të vitit 1945 formojnë "Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare", e cila ndryshe njihet me shkurtesën NDSH-ë. Programi politik i NDSH-së, përbëhej prej katër pikave:

1. Bashkimi i mbarë shqiptarëve brenda kufijve etnikë.

2. Demokraci të gjerë me të drejtën e çdo shtetasi në shprehjen e lirë të dëshirës së tij, gojarisht apo me shkrim, nëpër konferenca apo tubime.

3. Luftë kundër tradhtarëve të vendit të cilët Kosovën e kanë ndarë nga Shqipëria, e cila çfarëdolloj regjimi që të ketë, nëse është jashtë kufijve të Shqipërisë ajo është e robëruar.

4. Formën shtetërore e përcakton kombi pas çlirimit, pas çlirimit të Kosovës dhe bashkimit me Shqipërinë.

Ky dokument, sipas asaj që deklaroi Azem Marana para organeve hetuese të UDB-së, është sjellë në mbledhjen e tretë të grupit nismëtar për themelimin e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, e cila ishte mbajtur kah fundi i muajit janar 1945 në shtëpinë e Hysniqemal Ejupit, në të cilën kanë marrë pjesë: Azem Marana, Mamut Dumanit, Hasan Bilalli, Hysniqemal Ejupi, Nebi Jonuzi dhe Nuredin Ibrahimit. Gjatë debatit të zhvilluar, të pranishmit e kanë vënë në pah faktin se ndaj kombit shqiptar është bërë një padrejtësi e madhe, sepse atij i është mohuar e drejta e vetëvendosjes, që sipas oratorëve, kjo e drejtë u është garantuar të gjitha kombeve me Marrëveshjen e Atlantës dhe të Konferencës së Teheranit. Nisur nga kjo, por edhe nga sjelljet jonjerëzore të njëjësive



partizane jugosllave, të cilat tash më disa muaj nuk zgjidhnin mjete dhe metoda për ta terrorizuar popullsinë civile shqiptare, të pranishmit njëzëri pa përjashtim e "pranuan programin e organizatës, të cilën e paraqiti Mamut Dumani dhe u zotuan se do të punojnë për realizimin e tij".

Që ky program të realizohej sa më me sukses themeluesit e NDSH-së, ndër të tjerave kishin paraparë këto detyra: a) lidhjen sa ma të shpejtë me organizatat simotra në Kosovë dhe Shqipëri; b) propagandimi dhe zgjerimi i organizatës në trevat shqiptare të Maqedonisë; c) lidhja e organizatës me forcat e armatosura shqiptare që vepronin në këto hapësira; ç) inkuadrimi i intelektualëve dhe nacionalistëve shqiptarë në organizatë; d) inkuadrimi i anëtarëve të NDSH-së në administratën shtetërore në të gjitha nivelet sidomos në arsim, armatë dhe polici; dh) zhvillimi i një fushate në popullatën shqiptare, e cila do t'i përkushtohet arsimimit shqiptar etj. Detyrat që ia parashtruan vetvetes, kryeideologët e NDSH-së, nuk ishin të lehta, mirëpo falë angazhimit dhe vendosmërisë së tyre, shpejt do të arrihen edhe rezultatet e para. Shumë mësues, hoxhallarë, intelektual dhe nacionalistë shqiptarë u përfshinë në organizatë si: Qemal Skënderi, Spiro Harrilla Theodosi, Jonuz Balla, Abdylqerim Saiti, Jetish Vishi, Mehmet Bushi, mulla Hajdar Kurtishi, hafiz Etem Tahiri, mulla Mustafa, Nexhati Purde, Nexhmedin Besimi, Qeram Zllatku, mulla Garipi, mulla Abdulla Abdullahu, Sami Shabedini, Shaban Korrita, Elmaz Sallareva, Muharrem Bakalli—Cjilani, Xhavit Abdulla Selimi, Hamdi Sulejmani, Mefail Zajazi, Osman Cami, Medat Tërshana, Xhemal Ferra, Tefik Tanisheci, Zylbear Ajvazi, Rasim Dauti e shumë e shumë të tjerë. Është me rëndësi të thuhet se paralelisht me themelimin e NDSH-së, me nismën e Shaip Aziz, Ali Abdyrrahmani, Fetija Sulejmanpashiq, Refik Sherif etj, në Shkup u themelua organizata turke e njohur me emrin JUXHEL. Qëllimin e themelimit të kësaj organizata, më së miri e sqaron kryetari i JUXHEL-it, Shaip Aziz, i cili më 15 gusht 1947 para organeve hetuese deklaroi: "Në vitin 1945 kur shqiptarët zhvilluan një fushatë të madhe që thuhet se të gjithë fëmijët mysliman të shkojnë në shkollat shqipe. Si kundëreagim të kësaj, unë (Shaip Isak - Q. L.), Refik Sherif, mësuesi Sherafedin, Alija Abdyrrahman, Fetija Sulejmanpashiq, gjatë një bisede vendosëm që shqiptarëve t'ua frenojmë atë veprimtari, me atë që në çarshi do të flasin secili ai i cili veten e ndien turk, le të ngelet i tillë dhe fëmijët t'i dërgoj nëpër shkolla turke. Këtë vendosëm ta zbatojmë në mënyrë individuale, përkatësisht secili përmes miqve të vet. Si rrjedhojë e kësaj fushate u krijua një urrejtje e madhe midis nesh të cilët ndiheshim si turq dhe shqiptarëve..."

(vijon në numrin e ardhshëm)

Kur dikush thotë fjalë në kokën e tij, inteligjenca artificiale e aparaturës mund të lidhë sinjale të veçanta me fjalë të veçanta, duke ia përcjellë ato një kompjuteri

Kërkuesit kanë krijuar një mekanizëm që mund të lexojë mendjen e njeriut, kur ai përdor një zë të brendshëm, e kjo mund të lejojë kontrollimin e aparaturave pa folur fare. Mjeti i quajtur "AlterEgo" mund të përkrahë fjalët, që mbajtësit e tij verbalizojnë së brendshmi, duke përdorur elektroda të lidhura me lëkurën.

"Ideja jonë ishte nëse mund të kishim një platformë kompjuterike që është më e brendshme, që bën njësh njeriun dhe makinën, e që shërben si një shtrirje e brend-

## Vjen ALTER EGO, aparatura që "lexon" mendjen e njeriut



shme e aftësisë sonë për të mësuar", thotë Arnav Kapur, që ka udhëhequr projektin në labora-

torët e Institutit Teknologjik të Massachusettsit. Aparatura vendoset si një lloj kufjeje. Katër elek-

troda nën plastikën e bardhë kontaktojnë me lëkurën dhe kapin sinjalet neuromuskulare, që shkaktohen kur një person flet së brendshmi. Kur dikush thotë fjalë në kokën e tij, inteligjenca artificiale e aparaturës mund të lidhë sinjale të veçanta me fjalë të veçanta, duke ia përcjellë ato një kompjuteri. Kompjuteri më pas mund të reagojë përmes aparaturës, duke përdorur një altoparlant që flet në vesh pa pasur nevojë për kufje, duke bërë që bartësi të mund të dëgjojë pjesën e mbetur të fjalës, në të njëjtën kohë. Ideja është të krijohet një kompjuter i heshtur, me të cilin vetëm bartësi i "AlterEgos" mund të flasë dhe të dëgjojë.

## Pse flamingot qëndrojnë mbi një këmbë?



Flamingot janë të njohur për qëndrimin e tyre mbi një këmbë. Më në fund shkencëtarët e ka kuptuar se si ja bëjnë ato të qëndrojnë mbi një këmbë. Sipas një studimi të publikuar në The Royal Society's Biology Letters, flamingot përqendrohen vetëm në një pikë qendrore të forcës për të fituar balancimin e duhur për qëndrimin në një këmbë. Ato përdorin më pak rezistencë muskulore dhe i ndihmojnë zogjtë të lëkunden më pak. Në këtë mënyrë ato mund të qëndrojnë drejtë. Ndërsa me dy këmbë kjo gjë bëhet më e vështirë dhe kërkon më shumë forcë dhe rezistencë nga flamingot. Megjithatë flamingot nuk do të flinin dot kurrë mbi një këmbë.

## Rreth pesë për qind e popullsisë së botës përdorë drogë

Rreth 5 për qind e popullsisë në botë ka abuzuar me drogë të paktën një herë në vitet e fundit dhe gati 30 milionë njerëz mund të jenë të varur nga narkotikët në atë pikë që kanë

nevojë për trajtim, Kështu theksohet në një raport të Kombeve të Bashkuara të publikuar ditë më parë. Në raportin vjetor të Zyres së OKB-së për Drogën dhe Krimin gjithashtu thuhet se në

Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth 25 për qind të vdekjeve në vit janë të lidhura me drogën dhe normat e vdekjes atje vazhdojnë, pasi ato arritën në 52 mijë në vitin 2017.

## Edhe uji në shishe ka afat



Shkencëtarët zbulojnë edhe për se duhet ta pini apo ta hidhni pas disa ditësh të hapjes së shishes. Edhe pse uji mineral dhe uji

i zakonshëm kanë shenjë "është mirë të konsumohet deri...", mu si edhe shumica e artikujve të tjerë ushqimorë, afati i përdorimit të

ujit në shishe është i pafund, thonë ekspertët. Në shishe uji zakonisht shkruan që afati i konsumimit është një apo dy vjet. Mirëpo derisa shishja të jetë e mbyllur uji do të jetë i sigurt për ta pirë. Natyrisht, nën kushtet që shishja të jetë e mbushur në mënyrë higjienike, konstaton instituti gjerman SGS Fresenius, i cili merret me analizat laboratorike. Mirëpo, kur shishja të hapet, ujin duhet pirë brenda disa ditësh, sepse në shishe të hapur mund të hyjnë mikroorganizmat dhe të shumohen shpejt, posaçërisht nëse nuk ruhet në frigorifer, thotë instituti.

## U var 140 vite më parë, fiton pafajësinë



Myles Joyce përfundoi në litar së bashku me dy persona të tjerë si bashkautorë të një masakre ku mbetën të vvarë pesë anëtarë të së njëjtës familje. Gjatë procesit gjyqësor ai mohoi vazhdimisht akuzat dhe pretendonte pafajësinë. Por, një gjykatë irlandeze, në atë kohë nën kontrollin e Britanisë së Madhe, nuk mendoi kështu dhe në dhjetor të vitit 1882, Myles u ekzekutua.

Kur kanë kaluar 140 vite, Myles ka marrë pafajësinë. Presidenti irlandez, Michael D. Higgins publikoi dekretin që e shpall atë të pafajshëm duke u bërë rasti i parë që daton para se të formohej vetë shteti irlandez. "Ky është një turp historik në marrëdhëniet mes Britanisë e Irlandës dhe falja, sadopak, synon ta korrigjojë këtë", thuhet në argumentimin e Presidentit irlandez. Rasti i Myles Joyce u ngrit nga pasardhësit e tij, që kërkuan një hetim më të detajuar të çështjes. Në vitin 2015, komisioni qeveritar i ngritur për këtë dhe të tjera raste si ky, doli me një raport ku thuhet se Myles është dënuar padrejtësisht.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

## SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 24/2018

për punësimin e 3 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Kuvendin e Republikës së Maqedonisë” për vendet e punës në vijim:

<p>1. UPR0101B03000 Ndihmës udhëheqës i Sektorit të sekretarit gjeneral të Kuvendit</p>	<p>1 realizues(ë) Rroga neto: 31.330,00 denarë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative</li> <li>- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe</li> <li>- menaxhim financiar</li> </ul>
<p><b>Kushtet e përgjithshme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,</li> <li>- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,</li> <li>- Të jetë i moshës madhore,</li> <li>- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,</li> <li>- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.</li> </ul>	<p><b>VËREJTJE:</b> Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>2. UPR0101B04000 Udhëheqës i sekretarit gjeneral të Kuvendit</p> <p>1 realizues(ë)</p>	<p><b>Orari i punës :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ditët e punës e hënë - e premte</li> <li>- Orët javore të punës 40</li> <li>- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30</li> </ul> <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>	<p><b>Kompetenca të posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë</li> <li>- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)</li> </ul>
<p><b>Kushtet e posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike ose shkencat ekonomike</li> <li>- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat</li> </ul>	<p><b>Kushtet e përgjithshme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,</li> <li>- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,</li> <li>- Të jetë i moshës madhore,</li> <li>- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,</li> <li>- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.</li> </ul>	<p><b>VËREJTJE:</b> Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>3. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për realizimin e kontakteve të deputetëve me qytetarët në njësitë zgjedhore 4,5,6, Njësia për realizimin e kontakteve të deputetëve me qytetarët në njësitë zgjedhore, Sektori për sekretarin gjeneral</p> <p>1 realizues(ë)</p>	<p><b>Orari i punës :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ditët e punës e hënë - e premte</li> <li>- Orët javore të punës 40</li> <li>- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30</li> </ul> <p>Rroga neto: 20.987,00 denarë</p>
<p><b>Kompetencat e përgjithshme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij</li> <li>- mësim dhe zhvillim</li> <li>- komunikim</li> <li>- arritje të rezultateve</li> <li>- punë me të tjerë/punë ekipore</li> <li>- ndërgjegjësimit strategjik</li> <li>- orientim kah palët/palët e interesuara</li> <li>- udhëheqje; dhe</li> <li>- menaxhim financiar</li> </ul>	<p><b>Kushtet e posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike ose shkencat ekonomike</li> <li>- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat</li> </ul>	<p><b>Kushtet e përgjithshme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,</li> <li>- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,</li> <li>- Të jetë i moshës madhore,</li> <li>- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,</li> <li>- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.</li> </ul>	<p><b>VËREJTJE:</b> Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.</p> <p>Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.</p>
<p><b>Kompetenca të posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë</li> <li>- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative</li> <li>- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)</li> </ul>	<p><b>Kompetencat e përgjithshme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij</li> <li>- mësim dhe zhvillim</li> <li>- komunikim</li> <li>- arritje të rezultateve</li> <li>- punë me të tjerë/punë ekipore</li> <li>- ndërgjegjësimit strategjik</li> <li>- orientim kah palët/palët e interesuara</li> <li>- udhëheqje; dhe</li> <li>- menaxhim financiar</li> </ul>	<p><b>Kushtet e posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike dhe shkencat për ltersi</li> <li>- me ose pa përvojë pune</li> </ul>	<p>Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.</p>
<p><b>Orari i punës :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ditët e punës e hënë - e premte</li> <li>- Orët javore të punës 40</li> <li>- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30</li> </ul>	<p><b>Kompetenca të posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë</li> </ul>	<p><b>Kushtet e posaçme:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat politike dhe shkencat për ltersi</li> <li>- me ose pa përvojë pune</li> </ul>	<p>Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar. Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës. Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.</p>

Në bazë të nenit 156, 157 paragrafi 1, alineja 1, 158, 159 dhe 160 të Ligjit për sigurim shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave nr. 18-10970/2 nga 01.08.2016 dhe nr. 18-2856/2 të datës 26.03.2018, ushtruesi i detyrës së drejtorit të IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
për punësimin e punëtorëve shëndetësore për kohë të pacaktuar

DOKTOR MEDICINE.....2 (dy) realizues

**KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DOKTOR TË MEDICINËS**

- Të jetë shtetas i RM
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**KUSHTET E POSAÇME PËR DOKTOR TË MEDICINËS**

- Të ketë të mbaruar arsim të lartë (VII/1) apo 240 kredi sipas SETK-Fakulteti Mjekësisë,
- Provim të dhënë profesional,
- Licencë për punë,
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj botërore (angleze, gjermane ose frënge).
- Me dhe pa përvojë pune.

**DOKUMENTACION I NEVOJSHËM PËR DOKTOR TË MEDICINËS**

- Fletëparaqitje (domosdo numër telefoni për kontakt),
- Biografi të shkurtër,
- Certifikatë të shtetësisë,
- Kopje të letërnjoftimit ose të certifikatës së lindjes,
- Certifikatë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë nga gjykata kompetente se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Diplomë ose certifikatë për Fakultet të medicinës (prej ku mund të shihet mesatarja e suksesit), në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Nostrifikim të diplomës për kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Dokument për ekuivalencë të notave të dhënë nga Ministria e arsimit dhe shkencës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Deklaratë për njohje të gjuhës së huaj.

Selektimi i kandidatëve të **punëtorit shëndetësor me arsim sipëror** bëhet në bazë të kriterëve në vijim:

- mesatare të suksesit që kandidati e ka arritur në institucionin për arsim sipëror që bartë 40 pikë dhe
- provim kualifikues i përbërë prej dy pjesëve që bartë gjithsej 60 pikë, edhe atë:
  - pjesa profesionale (test) që bartë 40 pikë dhe
  - njohje të një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane ose frënge) që bartë 20 pikë.

Orari i punës është me ndërime, 40 orë në javë, pagesa do të paguhet sipas Marrëveshjes kolektive për veprimtari shëndetësore të Republikës së Maqedonisë, në shumë prej 23.431,00 denarë.

Afati për paraqitje në shpallje është shtatë (7) ditë pune nga dita e publikimit, ku si ditë e parë e publikimit konsiderohet dita e publikimit të fundit në shpallje publike.

Kandidati i cili përmbushë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter i dorëzon në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli ose si dërgesë me postë në adresën IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli, me shenjë “për shpallje”.

IPSH Spitali i përgjithshëm Gjevgjeli

**Republika e Maqedonisë**

**Projekti për përmirësimin e shërbimeve komunale - MSIP**

**Grante investuese IPA**

**MSIP-IPA-NCB-018-18**

- Kjo Thirrje për Oferta e pason Njoftimin e përgjithshëm për prokurimë për këtë Projekt të publikuar në botimin e UN Development Business, me nr. 767, të datës 31 janar 2010 (edicioni i shtypur) dhe e publikuar në mënyrë elektronike më 06 Janar 2010.
- Republika e Maqedonisë fitoi grant nga Komisioni Evropian në kuadër të IPA fondit për investime rurale të Komisionit Evropian për rindërtim dhe zhvillim për Projektin për përmirësim të shërbimeve komunale (MSIP) dhe ka për qëllim që një pjesë të mjeteve nga kjo kredi ta shfrytëzojë për pagesa sipas kontratës për: Ndërtimin e rrugës lokale për fshatin Padalisht dhe ndërtimin e rrugës lokale për fshatin Tërmovë.
- Komuna e Gostivarit fton ofertuesit e përshtatshëm dhe të kualifikuar që të japin oferta të vulltura për punët ndërtimore që përfshijnë Ndërtimin e rrugës lokale për f. Padalisht dhe ndërtimin e rrugës lokale për f. Tërmovë.
- Procesi i ofertimit do të kryhet përmes procedurave për licitim publik nacional siç është specifikuar në Udhëzimin e Bankës Botërore: Prokurim me mjete të marra nga Huaja IBRD dhe Kreditë IDA, nga janari i vitit 2011 dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit nga vendet e përshtatshme siç është definuar në dokumentacionin tenderik.
- Ofertuesit e përshtatshëm që janë të interesuar, mund të marrin informacione shtesë në adresën e cekur më poshtë prej në ora 08:30 deri në ora 16:30.  
Adresa: Rr. Vëllezërit Gjinoski nr. 61  
Qyteti: Gostivar  
Numri i postës: 1230  
Shteti: Republika e Maqedonisë  
Telefon: +389 (0) 42 214 406  
Fax: +389 (0) 42 214 406  
Adresa elektronike: [info@gostivari.gov.mk](mailto:info@gostivari.gov.mk)
- Dokumentacionin e kompletuar tenderik në gjuhën maqedonase, ofertuesit e interesuarit mund ta blejnë pas parashtrimit të aplikacionit me shkrim në adresën e dhënë më poshtë dhe pas pagesës së taksës së pakthyeshme prej **2.000,00 MKD**. Metoda e pagesës do të jetë përmes formularit PP50, në llogarinë në vijim:  
a) Për pagesë në denarë:  
Banka: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë  
Numri i llogarisë: 100000000063095  
Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 716014021563012  
Kontoja e të ardhurave: 725939 00

Dokumentacioni tenderues do të dorëzohet përmes postës elektronike ose mund të merret drejtpërdrejtë nga Komuna e Gostivarit.

- Ofertat patjetër të dorëzohen në adresën e më poshtme deri në **ora12:00 dt. 15.05.2018**. Dorëzimi elektronik i ofertave nuk është i lejuar. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen fizikisht në prani të përfaqësuesve të ofertuesve të cilët do të zgjedhin të marrin pjesë personalisht në adresën e dhënë më poshtë në **ora12:00, dt. 15.05.2018**.
- Të gjitha ofertat patjetër të shoqërohen me Garanci bankare prej **250.000,00 MKD**.
- Adresa: Vëllezërit Gjonoski 61  
Qyteti: Gostivar  
Numri postar: 1230  
Arkivi  
Shteti: Republika e Maqedonisë

KRIZA E FLAMURTARIT

# MUNGON KONTRIBUTI MUAREM, ZUKA ZBULIMI I VLONJATËVE

Futbollisti nga Shkupi u afrua si alternativë për stolin, por u kthye në zbulimin e vlonjatëve në gjysmën e dytë të sezoni, derisa më i dobët bilanci i shkupjanit tjetër Muarem Muarem, i cili ka luajtur vetëm tre ndeshje në kampionat, edhe i ndikuar nga dëmtimet, por në asnjë moment nuk e ka justifikuar statusin si një prej lojtarët më të paguar të kampionatit



Ecuria prej tetë javësh pa fitore, periudhë gjatë të cilës janë arritur vetëm dy barazime, është pjesa e dukshme. Zhgënjimet e njëpansnjëshme të Flamurtarit në kampionat kanë ardhur mbi të gjitha nga kontributi i munguar i blerjeve të dimrit. Të mirëpaguar, të afruar me bujë, por që nuk i kanë dhënë skuadrës kuqezit impulsin e

nevojshëm për të ecur përpara. Përkundrazi një pjesë e tyre e kanë parë shumë rrallë fushën, edhe gjatë javëve të fundit kur ekipi ish-

te i përgjysmuar nga mungesat. I vetmi që shpëton nga merkato e dimrit është Fisnik Zuka. Futbollisti nga Shkupi u afrua si alternativë

për stolin, por u kthye në zbulimin e vlonjatëve në gjysmën e dytë të sezonit. Zhgënjyes Igor Nedelkoviç, me serbin që fitoi menjëherë një vend në formacion, megjithatë me kalimin e javëve humbi shkëlqimin dhe besimin e trajnerit Duro. Sulmuesi numëron 9 ndeshje, por nuk luan në formacion prej sfidës së 1 marsit të humbur minimalisht në shtëpi me Luftëtarin, ndërsa në 4 sfidat e fundit është aktivizuar tre herë nga stoli. Shumë më i dobët bilanci i shkupjanit tjetër Muarem Muarem dhe Mamadou Tounkara, që u trumbetuan si afrimet e mëdha të Flamurtarit. Nga muaji janar, Muarem ka luajtur vetëm tre ndeshje në kampionat, edhe i ndikuar nga dëmtimet, por në asnjë moment nuk e ka justifikuar statusin si një prej lojtarët më të paguar të kampionatit. Diskutim i ngjashëm edhe ai i Tounkara, që pas bujës së huazimit nga Lacios e Igli Tares nuk ka arritur të lejë gjurmë. Lojtarë që duhej të rrisnin cilësinë dhe nivelin e lojës, për ta kthyer skuadrën në rivalen kryesore të Skënderbeut, ndërsa tanimë kuqezinjtë e shohin veten jashtë zonës evropiane. Paraqitjet negative të vlonjatëve kanë ardhur mbi të gjitha nga dështimi në merkaton e janarit.



## Finalja e Kupës mund të luhet më 23 maj

Shkup, 11 prill - Edhe pse nuk është ende zyrtare, gjasat janë të mëdha që ndeshja finale e Kupës së Maqedonisë, e 26-ta me radhë të luhet më 23 maj (e mërkurë), bën të ditur "makedonski sport", transmeton gazeta KOHA. Dje u zhvilluan ndeshjet kthyes të gjysmëfinale, derisa më 9 maj është paraparë të zhvillohet ndeshja e anuluar e javës së 26 ndërmjet Shkupit dhe Pelisterit, kështu që Federata Futbollistike e Maqedonisë në vend se më 9 maj, finalen e madhe do ta zhvendos më 23 maj. Nëse ndodh kjo, atëherë kjo ndeshje do të jetë e fundit për sezonin 2017/2018 pasi kampionati në Ligën e parë futbollistike përfundon më 20 maj (e diel). (B.K.)



## Hysaj me trajnerin Sarri largohen nga Napoli?

Trajneri i Napolit, Mauricio Sarri, ka prishur kontratën e vilës ku banon aktualisht, që do të thotë se shanset e largimit të tij janë të mëdha, edhe pse drejtuesit e klubit po insistojnë për rinovimin me të Shtypi italian ka zbuluar se se Sarri nuk e ka zgatur kontratën e vilës së tij në Varkaturo, madje ka kërkuar prishjen e kontratës 15 ditë më parë. Ikja e trajnerit Sarri nga Napoli, me shumë gjasë do të thotë edhe ikje e mbrojtësit kuqezit, Elseid Hysaj. Futbollisti shkodran është një ndër të preferuarit e trajnerit Sarri dhe është e lehtë të mendohet se mund ta marrë me vete te skuadra e re. Për Sarrin më pranë duket Çellsit, por edhe Monaco në Francë i ka kërkuar me ngulm shërbimet e këtij trajneri. Aventura e tij te Napoli duket e përfunduar, po ashtu edhe e Hysajt, mbrojtësit të kërkuar nga shumë skuadra të mëdha.

## Skënderbeu të premtën mëson vendimin e KAS-it

Më 13 prill Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë do të marrë një vendim në lidhje me ankesën e Skënderbeut pas heqjes së titullit kampion për sezonin 2015-2016 nga Komisioni i Etikës në FSHF. Klubi korçar e cilësoi si të pabazuar vendimin e organit juridik të FSHF-së, duke ankimuar çështjen në KAS-in e Lozanës. Zyra juridike e klubit është e bindur se vendimi i Etikës do të rrëzohet dhe titulli i sezonit 2015-2016 do t'i mbetet klubit të Skënderbeut. Në rast se KAS lë në fuqi vendimin, atëherë me shumë mundësi titulli do t'i kalojë Partizanit, që në atë kampionat e mbylli në vendin e dytë.



## Interi pret përgjigje nga Granada për Manajn



E ardhmja e Rei Manajt do të vendoset në dy muajt e ardhshëm. Sulmuesi shqiptar ka vetëm disa javë kohë për të treguar vlerat e tij në radhët e skuadrës së Granadës dhe për të siguruar qëndrimin te ky klub, duke pasur parasysh se te Interi nuk ka hapësira në një të ardhme të afërt. Në fakt, "Gazzeta Dello Sport" shkruan se zikaltërit shpresojnë te shitja e Manajt te spanjollët, për të siguruar të ardhura të cilat bashkuar me ato të siguruar nga transferimi i të rinjve të tjerë, do i sillnin këtij klubi një shumë të vogël për të investuar në merkato për afrimin e një futbollisti cilësor. Mes huazimeve dhe lojtarëve që dalin nga ekipi i të rinjve pasi kanë mbushur moshën, Interi regjistron 40 loj-

tarë të cilët vlerësohen në shitje, mes të cilëve është edhe Manaj. Për të, Interi ka një akord paraprak me Granadën, për të drejtën e blerjes së kartonit të sulmuesit në fund të sezonit. Por shifra prej 1 milion eurosh që kërkojnë zikaltërit për Manajt duket relativisht e lartë për momentin dhe Granada nuk ka kthyer ende përgjigje, edhe pse sulmuesi ka filluar të aktivizohet më rregullisht në ndeshjet e fundit. Në strategjinë e klubit do të ndikojë shumë fakti nëse Granada do të sigurojë apo jo ngjitjen në La Liga në sezonin e ardhshëm, pasi ashtu do të sigurojë të ardhura për të investuar në merkato e për të siguruar firmat e disa lojtarëve që ka aktualisht si të huazuar.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/23, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 167/15 dhe 15/16), nenit 142, 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18), Pëlqimit të Ministrisë së financave të RM nr. 18-3960/2 të datës 04.04.2018, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup nr. 01-104 të datës 25.06.2015

### IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup publikon

**SHPALLJE PUBLIKE nr. 02/2018**

për punësim për kohë të caktuar

(zëvendësim për punëtorin që është në pushim të lindjes)

- EDUKATOR..... 1 (një) realizues**
    - me 240 kredi sipas ECTS ose të ketë të mbaruar arsimin përkatës shkallën VII/1 profesor i diplomuar për mësim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor me ose arsim të lartë përkatës për edukator,
    - Licencë valide për edukator,
    - Me ose pa përvojë pune.
    - Orari ditor i punës: 8 (tetë) orë, (prej ora 06-00 deri ora 14-00, prej ora 07-00 deri ora 15-00).
    - Orari javor i punës: 40 orë, i shpërndarë 30 orë për punë të drejtpërdrejtë me fëmijë dhe orari tjetër për aktivitete të tjera. (prej ditës së hënës deri ditën e premte)
- Neto pagesa: 19.581,00 denarë (me arsim sipëror), 18.544,00 denarë (me arsim të lartë)
- LOGOPED..... 1 (një) realizues**
    - 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik – logopedi ose shkencat mjekësore – logopedi.
    - Licencë valide për bashkëpunëtor profesional
    - Me ose pa përvojë pune.
    - Orari ditor i punës: 8 (tetë) orë prej ora 08-00 deri ora 16-00.
    - Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënës deri ditën e premte)
- Neto pagesa: 20.056,00 denarë.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diplomë/Certifikatë për arsimin e mbaruar përkatës;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Vërtetim mjekësor se personi është i shëndoshë psiko-fizikisht;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi të mos i jetë shqiptuar dënimi me aktgjykim të plotfuqishëm me të cilën është gjykuar me vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes apo keqpërdorim i personit të mitur, për vepër penale të akteve kundër lirisë së gjinisë, pa marr parasysh sanksionit të shqiptuar në të cilën në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese;
- Licencë valide për edukator (vetëm për personat të cilët konkurrojnë për vendin e punës edukator);
- Licencë valide për bashkëpunëtor profesional (vetëm për personat të cilët konkurrojnë për vendin e punës logoped)

Fletëparaqitjet, së bashku me dokumentet e nevojshme parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter në objektin amë të IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup, në rr. "Zhenevska" nr. 4 (Taftalixhe 2), me shenjë "për shpallje nr. 02/2018"

Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 (pesë) ditë pune duke përfshirë nga dita e publikimit të shpalljes.

Vendimi për zgjedhje do të sillet në afat prej 15 ditë pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

IPKÇF "MAJSKI CVET" Karposh – Shkup  
Drejtor

Snezhana Podgorec Radiq

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, neni 22 paragrafi 1 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM-së nr.167/2015-tekst i konsoliduar) dhe neni 142 paragrafi 1 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta zyrtare e RM-së nr.23/2013), Drejtori i IPKÇF "Nasha Idnina" Prilep shpall

### KONKURS për punësim për kohë të pacaktuar

- Pedagog i diplomuar i edukatës fizike**
- një (1) realizues për kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- PSP – pedagog i diplomuar i edukatës fizike - me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 ose arsim të mbaruar përkatës të lartë – psikologjia e sportit, etj
- pa përvojë pune në profesionin e vet
- licencë valide për bashkëpunëtor profesional
- Orari i punës është 40 orë në javë, të cilët janë të ndara në 30 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijët, dhe koha e mbetur me aktivitete tjera, prej të hënës deri të premten; orari i punës përcaktohet shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 6:30 deri 12:30.
- Pagesa neto bazë 20.000,00 denarë
- Eduktor për fëmijë prej moshës 2-6 vjet – katër (4) persona në kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- Arsim të mesëm/të lartë profesor i diplomuar në arsimin parashkollor, edukatori i diplomuar për fëmijët parashkollor dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor - me 240 kredi të arritura ose arsim të lartë të kryer shkalla VII/1 apo arsimi i të lartë përkatës për edukatorë
- pa përvojë pune
- licencë valide për edukator
- Orari i punës është 40 orë në javë, të cilët janë të ndara në 30 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijët, dhe koha e mbetur me aktivitete tjera, prej të hënës deri të premten; orari i punës përcaktohet shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 6:30 deri 12:30.
- Neto pagesa bazë 19.574,00 denarë për arsim sipëror apo 18.383,00 për arsim të lartë.
- Përkëdhelës – katër (4) realizues për kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- PMP - arsim të mesëm katër vjeçar
- pa përvojë pune
- licencë valide për përkëdhelës
- Orari i punës është 40 orë në javë, të cilët janë të ndara në 35 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijët, dhe koha e mbetur me aktivitete tjera, prej të hënës deri të premten; orari i punës përcaktohet shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 9:30 deri 16:30.
- Neto pagesa bazë 14.772,00 denarë.
- ENËLARËSES - një (1) realizues për kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- arsim të kryer fillor
- pa përvojë pune
- Orari i punës është 40 orë në javë, prej të hënës deri të premten prej ora 06:00 deri 14:00.
- Neto pagesa bazë 12.000,00 denarë.
- Mirëmbajtës të higjienës dy (2) person për kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- arsim të kryer fillor
- pa përvojë pune
- Orari i punës është 40 orë në javë, prej të hënës deri të premten prej ora 6:00 deri në ora 14:00.
- Rojtar – kopshtar një (1) realizues për kohë të pacaktuar**
- Kushtet e nevojshme të posaçme**
- arsim të kryer fillor
- pa përvojë pune
- Orari i punës është 40 orë në javë, prej të hënës deri të premten prej ora 14,20:00 deri 21:00

Përveç kushteve të parapara kandidatët duhet ti plotësojnë dhe kushtet e përgjithshme ligjore.

**Me lutje kandidatët duhet ti dorëzojnë:**

- Diplomë (Certifikatë), dëftesë për arsim të mbaruar përkatës (origjinal ose të notuarizuar);
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm me çka është i dënuar për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore.
- Konkursi zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit.
- Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej dyzetepesë (45) ditë, pas skadimit të afatit për dorëzim.
- Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Nasha idnina"-Prilep, rr."Bidimazh" p.n- Prilep.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të arritura pas afatit nuk do të merren parasysh.

IPKÇF "Nasha idnina"-Prilep

Në bazë të nenit 19 nga Rregulloja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës nga shkollat e mesme Komisioni për grumbullim të ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënës nga SHMEQSH "Arseni Jovkov" Shkup në vijim publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE

**Për grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursionit përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë në vitin shkollor 2017/2018**

**Ofertues:** Secili subjekt juridik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes.  
**Lënda:** Organizim të ekskursionit përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë në pajtim me Programet për realizim të ekskursioneve për vitin shkollor 2017/2018.  
**Ekskursione për realizim:**

- Ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë të cilët zhvillojnë mësim në gjuhën maqedonase në relacion Shkup-Budapest-Vjenë-Shkup, 6 (gjashtë) ditë me 3 (tre) bujtje në Budapest, në bazë të gjysmë pansionit (mëngjes dhe darkë), me realizim në muajin prill ose në muajin maj 2018;
- Ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë të cilët zhvillojnë mësim në gjuhën shqipe në relacion Shkup-Tiranë-Durrës-Berit-Fier-Vlorë -Shkup, 4 (katër) ditë me 3 (tre) bujtje në Durrës, bazë të gjysmë pansionit (mëngjes dhe darkë), me realizim në muajin prill ose në muajin maj 2018;

Ofertuesi duhet të parashtrijë ofertë veç e veç për secilin ekskursion të theksuar.

Në pajtim me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës nga shkollat e mesme, të sjellë nga ana e Ministrisë së Arsimet dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, subjektet juridike të cilat janë të interesuara për pjesëmarrje sipas kësaj shpallje publike duhet ti plotësojnë kriteret minimale në vijim për vërtetimin e aftësisë dhe ti plotësojnë kërkesat teknike dhe financiare të cilat janë ngritur në dokumentacionin e shkollës bashkë me Programet për ekskursione shkollore.

**Kriteret minimale dhe dëshmitë për përcaktimin e aftësive të subjekteve juridike:**  
**Kriteri nr. 1:** Subjekti juridik të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike.

**Dëshmia në lidhje me kriterin nr. 1:** Licenca valide A për kryerje të veprimtarisë turistike në emër të ofertuesit dhe dokument për aktivitet të regjistruar. Dokumentet kopje, duhet të jenë të vërtetuar me vulë të besueshme të origjinalit.

**Kriteri nr. 2:** Subjekti juridik të ketë të realizuar me sukses së paku 3 (tre) ekskursione për nxënës dhe aktivitete të tjera të lira në 3 vitet e fundit.

**Dëshmia në lidhje me kriterin nr.2:** Vërtetime të dhëna nga shkolla për realizim me sukses së paku 3 (tre) ekskursione për nxënës dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit. Dokumentet kopje, duhet të jenë të vërtetuar me vulë të besueshme të origjinalit.

**Kriter nr.3:** Personi juridik të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike për makinat me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

**Dëshmia në lidhje me kriterin nr.3:**  
- Deklaratë nën përgjegjësi të tërësishe penale dhe materiale se personi juridik i cili do të paraqitet si ofertues mund të sigurojë shërbim për transport në pajtim me kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve (origjinal) dhe  
- Deklaratë nën përgjegjësi të tërësishe penale dhe materiale se në rast se zgjidhet ofertues më i volitshëm do të sigurojë dëshmi për rregullsi teknike të makinës të pajtim me ligjet ekzistuese valide në Republikën e Maqedonisë dhe procesverbal për kontrollim të jashtëzakonshëm të realizuar teknik të autobusit, jo më të vjetër se një muaj, si dhe për vozitësit e autobusëve do të sigurojë certifikata mjekësore jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal).

**Garanci bankare për realizim cilësor të ekskursionit:** është 5 % nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes. Garancion bankar ofertuesi i zgjedhur e dorëzon në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes.

**Kriteri për zgjedhje:** Çmimi më i ulët  
Për ofertues më të volitshëm do të zgjidhet ai ofertues i cili do të ofrojë çmim më të ulët, ndërsa pastaj do ti plotësojë kriteret minimale për aftësi dhe do të ketë ofertë të pranueshme teknike dhe financiare.  
Ekskursionet do të realizohen vetëm nëse ka numër të mjaftueshëm të nxënësve.

**Afati për dorëzimin e ofertave:** 5 (pesë) ditë pune duke mos konsideruar ditën e shpalljes, gjegjësisht më së voni deri më 19.04.2018 deri në ora 15.30.

Programet për realizim të ekskursionit shkollor obligueshëm duhet të merret në arkivin e shkollës çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 14:00. Marrja e programit dhe dokumentacioni i mbetur për realizim të ekskursioneve është kusht për pjesëmarrje në procedurën për grumbullim të ofertave. Ofertuesi me vehte gjatë marrjes së dokumentacionit duhet të sjell autorizim.


Ofertuesi duhet të shprehë çmimin veç e veç (akomodim, transport dhe ushqim) dhe çmimi i përgjithshëm për nxënës me TVSH të përfshirë. Ofertuesi çmimin e vet të ofertës duhet të formojë vetëm në pajtim me kërkesat nga Programi për realizim të ekskursionit.

**Mënyra dhe vendi për dorëzimin e ofertave:** Ofertat me dokumentet e nevojshme dorëzohen në zarf të mbyllur, në arkivin e Shkollës së mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov" – Shkup ose përmes postës – te rekomanduar apo me postë të shpejtë, në adresën Shkolla e mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov" – Shkup, rr. Kosturska pn, 1000 Shkup, me shenjë të vetme deri tek "Komisioni për realizim të procedurës për grumbullim të ofertave për realizimin e ekskursionit shkollor".


Secila ofertë e arritur pas afatit përfundimtar do të llogaritet si e vonuar dhe nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.  
Ofertuesit oferta e të cilave nuk do të plotësojë kriteret minimale si dhe kërkesat e shpallura teknike dhe financiare, do të jetë e refuzuar dhe e njëjta nuk do të shqyrtohet.

Hapja dhe evaluimi i ofertave nuk do të jetë publike, gjegjësisht do të jetë pa pjesëmarrje të ofertuesve dhe do të bëhet në lokalet e Shkollës së mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov" – Shkup

Komisioni për realizim të procedurës për grumbullim të ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënës nga SHMEQSH "Arseni Jovkov" Shkup



Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor  
dhe Planifikimit Hapësinor




Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit nga nëntoka edhe atë për nevoja teknologjike për larjen e rërës, zhavorrit dhe gurit edhe atë në PK 65 KK Kurija, Komuna e Negotinës.

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14 dhe 146/15), deri të Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit nga nëntoka për nevojat teknologjike për larjen e rërës, zhavorrit dhe gurit me PA 1 nr. 11/5-52/2018

Parashtrues i kërkesës  
VS-GD SHPK  
Rr. Disanska pn  
Komuna e Kavadarit  
Koordinatat sipas sistemit nacional koordinativ të pusit  
X=4 601888, Y=7586216 sasia e zënies së ujit është 30 l/s  
Informata në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail [k.zekiri@moepp.gov.mk](mailto:k.zekiri@moepp.gov.mk)  
Opinionin i përfshirë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi Goce Dellçev nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.



Republika e Maqedonisë  
Komuna e Sopishtes

Tel:++389 2 27 85 100  
Faks: ++389 2 27 85 109  
Rr. 2, Nr 2, f. Sopište, 1054  
Shkup, Republika e Maqedonisë  
[www.opstinasopiste.gov.mk](http://www.opstinasopiste.gov.mk)

nr. 28-26/16 e datës 10.04.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik në lidhje me Planin urbanistik për fshatin Sonje e Epërme, Komuna e Sopištes, Shkup – periudha planore 2016-2026, me nr. teknik 0801-06-12/16 të përpiluar nga Ivanov Inzhenering – Manastir.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Planin urbanistik për fshatin Sonje e Epërme, Komuna e Sopištes, Shkup – periudha planore 2016-2026, me nr. teknik 0801-06-12/16 të përpiluar nga Ivanov Inzhenering – Manastir.

Përfshirja planore dokument për Planin urbanistik për fshatin Sonje e Epërme, Komuna e Sopištes, Shkup – periudha planore 2016-2026, me nr. teknik 0801-06-12/16 të përpiluar nga Ivanov Inzhenering – Manastir është me sipërfaqe prej 214,03 ha m2.

- Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë 16.04.2018 në ora 10.00.
- Anketa publike do të zgjasë deri më 20.04.2018, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).
- Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.
- Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopište  
Stefçe Trpkovski

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar) nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe Pëlqimit nr. 18-3960/2 të datës 04.04.2018, nga Ministria e financa ve dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2, e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Rada Poceva" – Kavadar, U.D Drejtori i Institutit publikon

**SHPALLJE PUBLIKE  
PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR TË PUNËS**

1. Një (1) person për vendin e punës mirëmbajtës i higjienës - person ndihmës-teknik për mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve të nivelit të parë A – për kohë të pacaktuar të punës.

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim në institucion për fëmijë të parapara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Tekst i konsoliduar dhjetor 2017),

- Kushtet e përgjithshme që vëjnë për të gjithë kandidatët:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik,
  - Të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
  - Të mos i jetë shqiptuar dënim me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor që dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim me person të mitur dhe abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese

**Kandidatët për vendin e punës mirëmbajtës të higjienës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:**

- arsim fillor ose të mesëm të mbaruar katërvjeçar,
  - me dhe pa përvojë pune,
- Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të caktuar për periudhë deri më 31.12.2018.
- Orari ditor i punës është prej ora 06:00-14:00.
- Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 12.000,00 denarë

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Dokumentet që arrijnë të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

Kandidatët e interesuar për marrje të më shumë informatave mund të drejtohen në numrin e telefonit 043/412-097, ndërsa aplikacionet e tyre mund të parashirojnë në arkivin e IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar, rr. "Braça Xhunovi" nr. 11a (çerdhja qendrore).

IPKÇF "Rada Poceva"  
U. D Drejtor,  
Cana Dobrinova

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 114/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 10/15, 192/15, 27/16, 163/17), Drejtori i IPKÇF "PROLET" – Karposh – Shkup, publikon

**SHPALLJE  
Për punësim për kohë të pacaktuar të**

1. **1 (një)-përkëdhelës**, me arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me ose pa përvojë pune
2. **1 (një) – magazinier**, me arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar, me ose pa përvojë pune

Së bashku me fletëparaqitjen ku duhet të theksohet numri rendor dhe titulli i vendit të punës për të cilin konkurrohet kandidati duhet të parashirojë:

- Diplomë (certifikatë) ose dëftesë për shkallën e mbaruar të arimit që kërkohet (original ose kopje të vërtetuar në noter),
  - Certifikatë të mjekut,
  - Certifikatë të shtetësisë (kopje)
  - Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
  - Dëshmi të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm me të cilën është gjykuar me veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë apo keqpërdorim i personit të mitur, për veprë penale të akteve kundër lirisë së gjinisë, pa marr parasysh sanksionit të shqiptuar në të cilën në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke përfshirë nga dita e publikimit të shpalljes.
- Orari i punës së përkëdhelësit është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i shkallëzuar prej ora 06:00 -18:00.
- Orari i punës së magazinierit është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është prej ora 08-16.
- Neto pagesa fillestare për vendin e punës:
- |                      |               |
|----------------------|---------------|
| - përkëdhelës është  | 14.780,00 den |
| - magazinierit është | 13.187,00 den |

Dokumentacioni i dorëzuar pas fatit, jo i kompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh. Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashirohet deri në:

IPKÇF "PROLET" – Karposh – Shkup  
rr. Mile Pop Jordanov nr. 74  
tel 02/3082-737 ose 070/305-501

**Drejtor  
Vita Jakovlevska**

**Institucioni publik komunal çerdhja për fëmijë "Prolet" – Karposh – Shkup**

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe 3, nenit 23 paragrafi 1, 4, 5 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) nenit 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/2016, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit nga MASH nr. 12-2239/2 të datës 26.03.2018, drejtori i SHFK "Draga Stojanovska" f. Rakotincë – Sopishte, publikon

**SHPALLJE  
Për punësim të kuadrit mësimor për vitin shkollor  
2017/2018 për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018**

7. Një mësimdhënës për arsim teknik për 9 orë mësimore për paralelet në gjuhën maqedonase për SHQ në f. Rakotincë dhe SHP në f. Sopishte, Sonje e Poshtme dhe Dobri Doll me neto pagesë bazë prej 9.290,00 den;

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligjin për marrëdhënie pune kandidatët për mësimdhënës duhet të përmbushin edhe kushtet nga neni 80 dhe 81 i Ligjit për arsim fillor: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, të kenë të mbaruar arsim përkatës, të njohin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik (për paralelet në gjuhën shqipe dhe turke edhe gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi) dhe të kenë të dhënë provim profesional për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional, gjegjësisht edukator.

Në shpalljen publike mund të paraqitet edhe personi pa provim të dhënë profesional dhe të lidhë marrëdhënie pune për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

Orari i punës së mësimdhënësit në kuadër të javës pesëditore të punës realizohet në ndërrimin e parë me fillim në ora 08:00. Orari i orëve mësimore është në pajtim me Orarin e orëve për vitin shkollor 2017/2018 në kuadër të Programit vjetor për punë të shkollës.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune dhe afati fillon të rrjedhë nga dita e publikimit të tekstit të shpalljeve në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 30 ditëve pas përfundimit të shpalljes. Fletëparaqitja me CV dhe dëshmitë e nevojshme të dorëzohen deri në SHFK "Draga Stojanovska", f. Rakotincë – Sopishte në adresën rr. "1" nr. 2, f. Rakotincë – Sopishte.

SHFK "Draga Stojanovska"  
f. Rakotincë – Sopishte

SHFK "Metodi Mitevski – Brico" Llozovë, në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 dhe nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2014), dhe Vendimit të drejtorit nr. 0204-188/1, publikon:

**SHPALLJE**

Për praninë të punëtorit për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018 për vendin e punës në vijim:

- 1 mësimdhënës të gjeografisë 12 orë mësimore;

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet nga neni 80 i Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08) dhe nenit 9 të Rregullores për organizim dhe sistematizim të punëve dhe detyrave të punës së punëtorëve në SHFK "M. M. – Brico" dhe të parashirojnë dokumentet në vijim:

1. Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (original ose kopje të vërtetuar në noter);
2. Certifikatë të shtetësisë;
3. Certifikatë se nuk është i dënuar;
4. Certifikatë të mjekut, pas pranimit të kandidatit;

Shpallja zgjatë pesë ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

SHFK "M. M. Brico" Llozovë

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/09, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/15, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016), nenit 34 paragrafi 1 e Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/13), dhe vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, dekani i Fakultetit të edukatës fizike, sportit dhe shëndetit në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

**KONKURS  
Për zgjedhje të**

- Një mësimdhënës në thirrjen titulare në sferën mësimore-shkencore: kieziologjia fundamentale, në lidhje me lëndën biokimia.  
(zgjedhja është për kohë prej pesë vite)

- Një mësimdhënës në thirrjen titulare në sferën mësimore-shkencore: kieziologjia aplikative, kieziologjia aplikative për lëndët: gjimnastika sportive, teoria dhe metodika e gjimnastikës sportive, teknika dhe taktika e gjimnastikës sportive, përgatitja fizike në gjimnastikën fizike, praktika pedagogjike me përpilim të punës së diplomës në gjimnastikën sportive.  
(zgjedhja është për kohë prej pesë vite)

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës është 40 orë në javë, me dy ndërrime: dy javë paradite prej ora 7:30 deri në ora 15:30, dy javë pasdite prej ora 13:30 deri në ora 21:30 në pajtim me orarin e orëve në semestër. Bruto pagesa fillestare është 46.534 denarë.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën: Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçev nr. 3, 1000 Shkup, Fahu P. 681

**Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup**

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 74 të Statutit të SHFK "Krstev P. Misirkov" Radovish ndërsa në pajtim me nenin 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor si dhe Vendimit për publikim të shpalljes, U. D Drejtori i shkollës publikon

**SHPALLJE**

**Për plotësimin e vendeve të punës në vijim:**

1. Dy mirëmbajtës të higjienës, me orar të plotë të punës për kohë të pacaktuar të punës. Neto pagesa në shumë prej 12.000,00 denarë;

Shkolla punon me dy ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë prej ora 6,00 deri në ora 14,00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13,00 deri në ora 20,00.

**Kushtet:** Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të kenë të mbaruar arsimin fillor. Përveç fletëparaqitjes kandidatët duhet të parashirojnë: dëftesë për arsim fillor të mbaruar dhe certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit dhe të pakompletuara sipas shpalljes, nuk do të jenë lëndë shqyrtimi. Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dokumentet e nevojshme parashirohen në arkivin e shkollës. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

**SHFK "Krstev P. Misirkov" – Radovish,  
U. D Drejtor,  
Stojanova Ollgica**

I nr. 1958/2016

**SHPALLJE PUBLIKE**

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Hallk Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, bazuar në dokumentin për përbarim Akti notarial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Notarit Përbarrim Roxhepi, Gostivar, kundër bonhilit Ardijan Ramadani nga Gostivari me seli në f. Belovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me seli në f. Belovishtë, për realizim të përbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përbaruese të regjistruar nën I nr. 1958/2016 të datës 05.04.2016:

**FTON**

1. Bonhilit Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Belovishtë, për shkak të dorëzimit të:
    - Proceverbalit për shpallje të patundshmërisë me ankim publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
    - Konkuzionit për shpallje të patundshmërisë me ankim publik me gojë në batë të nenit 175 paragrafi 4 të LP I nr. 1958/2016 të datës 14.03.2018,
    - Konkuzionit për shpallje e realizuar të patundshmërisë në bazë të nenit 175 paragrafi 7 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
    - Konkuzionit për dorëzim të patundshmërisë në pronësi në bazë të nenit 178 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 15.03.2018
    - Konkuzionit për përcaktim të kohës për ndarje në bazë të nenit 192 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.03.2018
    - Proceverbalit për ndarje të shumës të amilur me shpallje të patundshmërisë në bazë të nenit 192 të LP I nr. 1958/2016 të datës 26.03.2018
  - PARALAJMËROHEN bonhili Ardijan Ramadani, debitorin i pengut Qemal Ramadani se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala. Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.
- Kjo shpallje paraqet SHPALLIEN E DYTE**

Përbarues  
Aleksandar Kuzmanovski

“Sigurisht që duhet të besojmë, sepse mund të arrijmë në finale. Pse nuk duhet të besojmë, pas kësaj përmbyseje? Kemi ardhur deri këtu me meritë, edhe pse askush nuk e priste. Prandaj, ne duhet të shtyjmë dhe të synojmë në diçka më shumë. Unë nuk dua që tashmë skuadra të ‘flejë mbi dafina’, por të synojë më shumë dhe të kuptojë se gjithnjë mund të bëjmë më mirë”, pohon Di Françesko

## DI FRANÇESKO FLET PAS ELIMINIMIT TË BARCELONËS



# PAS KËSAJ PËRMBSYSJE PSE MOS TË BESOJMË SE MUND TË ARRIJMË NË FINALE

Eusebio Di Françesko beson se ai i meriton lavdet për eliminimin e Barcelonës nga Çampioni, edhe pse zakonisht fajësohet i pari kur skuadra e tij humbet. Verdhekuqtë u përballën me një detyrë të vështirë në çerekfinalen e kthimit, sepse vinin nga humbja 4-1 në “Camp Nou”. Duke tejkaluar të gjitha parashikimet, skuadra e Seria A përparoi në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve me një fitore 3-0, pas golave të Edin Xhekos, Daniele De Rossit dhe Kostas Manolas. Trajneri Di Françesko zgjodhi një ndryshim të lojës së tij, vendosjen me modulin 3-4-2-1 dhe beson se ky ishte çelësi për të marrë një rezultat kaq pozitiv, me Nainggolan dhe debutuesin e Ligës së Kampionëve, Patrik Shik, që e mbështetën me përkushtim Edin Xhekon. “Kam marrë fajin për humbjet dhe disa fjalë të papëlqyeshme në mediat sociale, kështu që mund t’i marr edhe meritat për një fitore si kjo”, – tha trajneri i Romës për “Mediaset Premium”. – E vërteta është se e bëra këtë zgjedhje për të krijuar më shumë gjerësi, për të lejuar më shumë kundërsulme dhe për të sjellë shpejtësi. Por, ajo që me të vërtetë ndryshoi, ishte filozofia e krahëve dhe ne duhet të vazhdojmë kështu. Edhe pse kemi pasur shfaqje shumë të mira në Seria A, ne po korrnim tani vetëm shpërblimet e punës së bërë. Janë shpërblime të drejta për punën e madhe që kemi bërë”, u shpreh trajneri i Romës. Di Françesko iu bëri jehonë mendimeve të kapitenit të tij, De Rossi, duke i bërë thirrje Romës për ta mbajtur lart besim dhe për të synuar finalen

e këtij kompeticioni. “Sigurisht që duhet të besojmë, sepse mund të arrijmë në finale. Pse nuk duhet të besojmë, pas kësaj përmbyseje? – shoi Di Françesko. “Kemi ardhur deri këtu me meritë, edhe pse askush nuk e priste. Prandaj, ne duhet të shtyjmë dhe të synojmë në diçka më shumë. Unë nuk dua që tashmë skuadra të ‘flejë mbi dafina’, por të synojë më shumë dhe të kuptojë se gjithnjë mund të bëjmë më mirë”, përfundoi Di Françesko. Në anën tjetër, Ernesto Valverde pranoi se Barcelona nuk ishte mjaft mirë për të mundur Romën, pasi të gjithë mbetën të habitur nga humbja 3-0 e çerekfinalës së kthimit në “Olimpico”, e cila e rrëzoi skuadrën katalanase nga Liga e Kampionëve. “Kur humbet kështu është gjithmonë e vështirë, – tha ai. – Por, është e thjeshtë të thuhet se kundërshtari ynë ishte shumë i fortë nga minuta e parë në të fundit. Roma ushtroi një presion të lartë në të gjithë fushën, çka e bëri të vështirë për të luajtur ndeshjen tonë. Kundërshtari fitoi topat e dytë, ndërsa koha e golave të tij ishte e rëndësishme. Kjo ishte një ditë e keqe për ne. E vërteta është se Roma ishte shumë mirë, ndërsa ne nuk ishim. Kjo është një humbje e dhimbshme, nuk ka dyshim. Të gjithë ne kemi pasur dëshirën për të fituar këtë kompeticion, por Roma na eliminoi në çerekfinale. Ne kemi mbetur prapa në këtë rrugë, por nuk ka ilaç tjetër, përveçse të vazhdojmë me fitimin e dy trofeve të tjerë sezonalë, që do të jenë ngushëllim për këtë ditë të vështirë”, deklaroi Valverde, trajneri i Barcelonës. Ashtu siç pritej, edhe ndeshje

## “ROMANTADA”, SHTYPI EVROPIAN EVIDENTON “TALLJEN” E BARCELONËS NË ÇAMPIONS

Dështimi i Barcelonës në Ligën e Kampionëve 2017-2018 ka bërë xhiron e botës si lajm sensacional. Jo vetëm shtypi italian, por edhe ai spanjoll i kanë bërë jehonë Barcelonës qesharake të Ernesto Valverde në Çampioni. Për këtë ka shkruar tërë shtypi botëror, në fakt, duke evidentuar me tituj të mëdhenj përmbysejen e pabesueshme dhe befafuesë të Romës, e cila tashmë është në gjysmëfinale të Çampionit. “LA GAZZETTA DELLO SPORT” Gazeta “Gazzetta dello Sport”, një nga të famshmet sportive italiane, thekson në kopertinën e saj, me germa të mëdha, titullin “Imperial”. Gjithashtu, nënvizon se “një Romë e madhe mundi Barcelonën”. Gazeta italiane këmbëngul në faqet e saj të brendshme se “Roma pati sukses, kur disa mendonin se ajo ishte e eliminuar që në çerekfinalen parë. Me një Xheko stratosferik, një Manolas homerik, trajneri Di Françesko e ktheu ëndrrën në realitet. Roma është tashmë mes katër skuadrave më të mira në Europë”.

### “MARCA”

Në Madrid, shtypi sportiv nxjerr në pah Barcelonën qesharake në Ligën e Kampionëve. “Marca”, në kopertinën e saj, spikat titullin “Dështim total në Evropë”, duke iu referuar edhe Mançester Sinit të Pep Guardiols. “Dëshpërimi në Romë i skuadrës së Valverde, – këmbëngul kjo gazetë sportive, – nxori në pak përmbysejen historike të verdhekuqve, me golat e Xheko, De Rossi dhe Manolas”. “Marca” shkruan, gjithashtu, se “askush nuk do të harrojë kurrë këtë natë, kur Barcelona e Messit është eliminuar nga

e kthimit mes Mançester Sinit dhe Liverpulit ishte një spektakël dhe një reklamë për futbollin evropian. Ish-te një sfidë që i kishte të gjitha, por në fund ishin të Kuqtë e Jurgen Klopp ata që dalin me buzëqeshje nga fusha pas fitores 2-1 në “Etihad”. Jesus e kaloi në epërsi Sinit, por në vazhdim të përzgjedhurit e Klopp me golat e Salah dhe Firmino, përmbysejen rezultatin dhe u plasuan me plot meritë në gjysmëfinale. Klopp vlerësoi karakterin e Liverpuli, pasi

të tijtë kaluan në gjysmëfinale të Çampionit, duke eliminuar Mançester Sinit. “Sonte ishte mjaft e vështirë, sidomos në fillim të lojës, me atë gol të mrekullueshëm, që ia kemi shërbyer vetë në pjetë kundërshtarit. Por, për të qenë 100 për qind i ndershëm, prisja që diçka e tillë të ndodhte. Ju duhet të reagoni në mënyrën e duhur. Më pëlqeu mënyra se si reaguam menjëherë pas pësimit të golit. Pastaj luajtëm futboll të mjaftueshëm, në mënyrën e

duhur. Ne ishim nën presion. Mançester Siti i mori përsipër të gjitha rreziqet, që mund të merre. Na duhej pak fat dhe disi mbrojtje e disiplinuar, sa i përket formimit tonë. Unë nuk isha tepër i lumtur në gjysmëorën e parë të ndeshjes, për të qenë i sinqertë, sepse nuk ishim mjaft kompaktë dhe shumë topa të dytë dorëzoheshin te Siti. E dija që do të ishte e vështirë, por ne bëmë të pamundurën, e cila është fantastike”, deklaroi Klop.



Liga e Kampionëve në Romë, duke çuar dëm avantazhin e konsiderueshëm 4-1 nga ndeshja e parë çerekfinale. 3-0 në “Olimpico” është tashmë pjesë e historisë së zezë të Barçës në Ligën e Kampionëve”.

### “LEQUIPE”

Së fundi, gazeta franceze “L’Equipe”, e cila në sezonin e kaluar theksoi përmbysejen e Barcelonës kundër PSG, nuk mund ta harrojë përmbysejen e Romës në kopertinën e vet. “Romantada” është fjala që përdoret si titull i madh nga sportivja franceze në faqen e parë. Brenda saj, “L’Equipe” vë në dukje se “pas një viti të përjetimit të gëzimit ekstrem të arritjes së asaj, që askush tjetër nuk e kishte arritur, me kujtimin e paharrueshëm ndaj PSG (0-4, 6-1), Barça jetoi pikërisht të kundërtën: Roma arriti të pamendueshmen, duke rrezuar skuadrën katalanase, e cili ishte e panjohshme”.

Publicitet

### URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë “Momin Potok” – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

### SH PALLJE

Shitet tokë në Shkup, e cila është e regjistruar në:  
- PK 3553, pjesa 5, vendi i quajtur BORINAREC, kultura T, sipërfaqe 429 m 2, e regjistruar në Fletë pronësi nr. 101083 për KK Radishan, dhe  
- PK 3553, pjesa 6, vendi i quajtur BORINAREC, kultura T, sipërfaqe 568/1118 m 2, e regjistruar në Fletë pronësi nr. 100167 për KK Radishan në pronësi të Enver Bunjakut. Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Diskutimet dhe argumentet mund të komprometojnë mirëkuptimin në çift dhe t'ju mbajnë larg gjetjes së një pike takimi. Kryeneçësia juaj nuk ju lejon të lëshoni "pe"! Beqarët do të kenë kokën e tyre diku tjetër dhe kjo e mërkurë nuk do të jetë e suksesshme në dashuri. Kush do të udhëhiqet nga ambicie të forta në punë do të përballet me mundësi të mira.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Dita do të fillojë me optimizëm dhe çdo gjë do të duket e zgjidhshme. Edhe ato kontraste me të dashurit tuaj që ju bëjnë të zemëroheni do të duken sikur janë të vogla. Yjet garantojnë për beqarët kushte të duhura për një takim interesant. Periudhë e shkëlqyer për të nisur investime të reja ose për të ndryshuar bashkëpunëtorët. Shpërblime të reja vijnë së shpejti.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Venusi do të sjellë ekuilibrin dhe harmoninë dhe kjo ditë do të jetë vendimtare për marrëdhëniet në çift, pavarësisht nga ato që mund të jenë. Shumë do të fillojnë një bashkëjetesë. Beqarët do të duhet të reagojnë ndaj situatave të ankthit me një buzëqeshje, pa u përfshirë në panik. Me mbështetjen e Uranit, gjithçka është e arritshme. Yjet njoftojnë njohje të shkëlqyera në frontin e punës.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Mos lejoni që mosfunksionimi juaj të mbizotërojë mbi lidhjen tuaj të dashurisë, rrezikoni marrëdhënien në çift. Jini të ëmbël dhe në dispozicion me ata që ju duan. Kohë e mirë për beqarët të cilët do realizojnë takime interesante. Yjet janë në anën tuaj dhe ata që duan të marrin shtigje të reja mund ta bëjnë këtë me qetësi.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Nëse jeni gati për të dëgjuar nevojat e partnerit/ës, duhet të përballemi gjithashtu disponimin e keq dhe mosmarrëveshjet e vogla. Megjithatë, në mbremje disponimi do të jetë i mirë. Kush është vetëm ose është kthyer nga një marrëdhënie shumë e stuhishme, do të nisë një histori pasionante. Kreativiteti ju shtyn të kërkon horizontet të reja dhe shumë prej jush do të kenë sukses.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Mos u ndalni në paraqitjet tuaja dhe përpikuni të thelloni njohjet me dikë që ju intereson. Zemrat e vetmuara do të jenë momente të lumturisë së pastër pa menduar për të nesërmen. Periudhë e rëndësishme nga këndvështrimi profesional, kthimet e papritura hyrëse dhe idetë e shkëlqyera do të japin fitime të shkëlqyera.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Mos u dramazoni me grindje të pakuptimta dhe të parëndësishme, nuk keni nevojë të mbani inatin tuaj gjatë. Përkundrazi, qëndrojeni afër partnerit/ës dhe sheshoni zënkën e kota! Nëse jeni vetëm, mos i anashkaloni ftesat për takime dhe mundohuni të hapni zemrën për miqësi të reja. Ju do të jeni në gjendje të zgjidhni situata të vështira falë diplomacisë suaj.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Sot, Venusi do t'ju ndihmojë të premtoni ekuilibrin dhe qetësinë me të dashurin/ën tuaj. Por duhet të jeni më pak posediv dhe të lini mënjatë xhelozinë. Zemrat e vetmuara do të shkojnë në kërkim të aventurave dhe do të jenë plotësisht të kënaqur. Nga sot gjendja financiare do të përmirësohet dhe do të filloni të shikojë frytet e punës suaj. Jini të sigurt.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Një ditë intensive për ata që janë në çift, sot erosi janë yjet dhe kjo do të përforcojë bashkëpunimin në marrëdhënie. Venusi mbron të dashruarit! Ka kthime nga e kaluara për beqarët, ndoshta dikush me të cilin nuk e keni ndërprerë ende komunikimin. Kushte të shkëlqyera për investimet e ardhshme, Jupiteri ju ofron bashkëpunime dhe mundësi për tu kapur që në ajër.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Planetët mbështesin zgjedhjet tuaja dhe do t'ju bëjnë të jetoni momente që kurrë më parë nuk u përjetuan me personin e zemrës. Ju do t'i lini përshtypje partnerin/ës me mënyrën tuaj të sjelljes! Yjet ofrojnë takime interesante për zemrat e vetmuara: priten dashuri interesante. Ju keni gjithçka që ju nevojitet për të arritur qëllimet e dëshiruara në aspektin profesional.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Konfuzioni dhe dyshimet ende nuk zhduken, mospranimi juaj nuk do të jetë i mirë në marrëdhënien në çift. Megjithatë, yjet premtojnë ndjesi të forta dhe pajtime. Takime të nxehta për beqarët, sot nuk do të hiqni dorë nga mundësitë për takime apo koha e lirë. Peshoni mirë zgjedhjet, vetëm në këtë mënyrë ju mund të identifikoni ato të drejta që do t'ju japin kënaqësi në të ardhmen.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Natyra juaj nuk mohohet, ëndërruesit dhe romantikët si ju do të kapin çdo moment gëzimi për ta kaluar pranë të dashurit/ës tuaj. Për beqarët do të jetë një ditë sqarimi dhe zgjidhjeje, mbyllni çështjet në pritje. Priten ndryshime në aspektin profesional. Kjo e mërkurë premtot të jetë e frytshme dhe interesante.

Mensur Mamuti	GRUP PREJ 9 KENGETARËSH FILOZOFI INDASE E TEKNIKAVE TRUPORE	N	KOHA E LËMIT, E DRITHRAVE	GRUP NJERËZISH TE NJE GJAKU, FIS	AMPERI	LËNDA PËRBËRËSE E DUHANT (SH.) FENER	N	BINARI I TRENIT	SHPËRBLIMI QË IA DHA KOSOVA POLITIKANIT NË FOTO: "MEDALJA E ARTE..."	RIMNI
ISH POLITIKANI GJERMAN, NË FOTO										
SH BASKETBOLLISTI AMERIKAN, HEKILL					HERO I LUFTËS SË TROJ BIZMUTI					
VENDLINDJA E POLITIKANIT NË FOTO ATDHEU										PARTIA E ISH POLITIKANIT NË FOTO
V						FUTBOLLISTI SHQIPTAR, IGLI				



NE KETE DATE

12 PRILL 1948

KOHA	VAZO METALI	JESËTAR I ARABËVE	ZË	KOSH PËR MATJEN E DRITHRAVE	QË KATË BËJË ME ANUSIN AZOT				LUFTËTARI I SPANJËS, VOKSHI
RËNIA NË GJENDJE TË KEQE									
PËRGËZUJ					I DIKURSHËM KENIA			OPERATNG SISTEM ASTATI	
LLOJ EMBËLSIRE ITALIANE									NJË ROMAK
SHKRONJAT E PARA				RISTARTIM I KOMPJUTERUT					

ZGJIDHJET: N, N, JOSHKKA FISHER, O NIL, AKILL, GERABRONI, VATANI, TARE, I, IGI, NUSE, AKËL, TR, B, AKË, DIOR, ANET, ANAL, KATANDISJA, UROJ, ISH, OS, PANAKOTA, I, AB, RESEPTIM.

## Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

8			4			7		3		4		7		1		9	
	5	3	6			9			7		5			3		1	
			7		8							8		9			
			2		7		3	6	5	9		3			8		4
3	7	6		2		4			8		6			9		5	
				5		7						5		4			
			7			3	6	1	1		2				5		8
2			8			4			7		8		1		7		3

Shumë i lehtë: 861459723, 753612948, 429738156, 942871365, 185346279, 376925481, 614597832, 597283614, 238164597. Mesatar: 348751296, 795642381, 261839457, 913275864, 457968123, 826413975, 639584712, 172396548, 5841227639.

## Japonezi 112 vjeç, burri më i vjetër në botë



Një japonez 112 vjeç, i lindur pak muaj para se Albert Einstein të publikonte teorinë e tij speciale të relativitetit, u njoh të martën si burri më i vjetër në botë. Masazo Nonaka, i lindur më 25 korrik, 1905, mori këtë titull pasi Francisco Nunez Oliveira nga Spanja vdiq këtë vit në moshën 113 vjeçe, ka thënë Libri i rekordeve Guinness, raporton Reuters. Nonaka, i cili në moshë të re ishte fermer dhe sharrëxhi, më vonë ndërtoi një banjë shëruese në qytetin e tij të lindjes, Ashoro, në ishullin Hokkaido, 900 km në veri të Tokios, dhe rriti dy djem e tri vajza. Nonaka vazhdon të kalojë kohën në banjën shëruese dhe i pëlqen ëmbëlsirat, veçanërisht tortat me dredhëza. Në ceremoninë e njohjes së këtij titulli ai ishte i shoqëruar nga të familjarë dhe zyrtarë të Guinnessit. Titulli i Guinnessit për burrin më të moshuar që ka jetuar ndonjëherë mbahet nga një japonez tjetër, Jiroemon Kimura, që vdiq më 2013 në moshën 116 vjeçe e 54 ditë. Moshë e vërtetuar më e vjetër për një qenie njerëzore është ajo e francezes Jeanne Louise Calment of France, e cila vdiq më 1997 në moshën 122 vjeçare e 164 ditësh.

## Arrat kundër kancerit të zorrëve

Pacientët me kancer të zorrëve mund të shtojnë gjasat për mbijetesë duke konsumuar arra, thotë një studim i ri. Konsumimi i arrave çdo javë shton gjasat për t'iu shmangur sëmundjes për 57 për qind, në krahasim me ata që nuk i konsumojnë. Ekspertët pranë Qendrës Yale Cancer thonë se po ashtu konsumimi i bajameve e lajthive luajnë rol pozitiv në këtë aspekt. Temidayo Fadelu sugjeron se konsumimi i arrave ndihmon në mposhtjen e kancerit duke i bërë pacientët më pak rezistent ndaj insulinës – gjë që çon në më pak sheqer në gjak.



## Hëngri specin më djegës në botë, burri përfundon në emergjencë



Një nga pjesëmarrësit e Festivalit të specave më djegës të botës, të zhvilluar në New York, përfundoi në spital pasi përje-

## Amerikanët humbasin besimin te Facebook-u

Amerikanët po e humbasin me shpejtësi besimin te Facebook-u pas problemeve të shumta rreth asaj se si kompania e trajton informacionin personal dhe për faktin që lejon potencialisht përhapjen e të ashtuquajturave lajme të rreme. Ndërkohë që themeluesi i kompanisë, Mark Zuckerberg, vjen të martën në Uashington për të dëshmuar përpara ligjvënësve, një sondazh i Aleancës për Qytetarët Digjitalë, që merret me sigurinë në internet, zbulon se pothuajse një në çdo katër amerikanë thonë se "Facebook-u nuk është një kompani e përgjegjshme, sepse në shumicën e rasteve vë fitimin mbi të gjitha, para se të përpiqet të bëjë atë që duhet". Më pak se një e treta e të anketuarve mendon se Facebook-u, me 2 miliardë përdorues në mbarë botën, është një "kompani e përgjegjshme, sepse përpiqet të bëjë gjënë e duhur në shumicën e rasteve, edhe nëse kjo i dëmton fitimin". Gjithashtu, një në çdo shtatë ame-



rikanë thonë se "Facebook-u ka pasur një ndikim negativ mbi debatin politik". Gjashtëdhjetë e një për qind besojnë se "Facebook-u ka dëmtuar politikën amerikane dhe e ka bërë atë më negative, duke mundësuar manipulime dhe gënjeshtër që polarizojnë njerëzit". Sondazhi i realizuar me 925 amerikanë, zbulon se 53 për qind e të aketuarve, kundrejt 26 për qind, thonë se është detyrë e Facebook-it për të hequr ose paralajmëruar përdoruesit për lajme që mund të jenë të rreme. Rreth 60 për qind thonë se kompania nuk po bën sa duhet për të parandaluar përhapjen e informacionit të rremë.

1204 - Kryqëzata e IV okupojnë dhe plaçkitin Konstantinopojnë.

1545 - Mbreti i Francës Fransoa I jep urdhër të ekzekutohen protestantët Vados.

1857 - Botohet vepra "Zonja Bovari" e Gustav Floberit.

1883 - Trupat franceze me nën-kolonelin Borgnis-Desbordes okupojnë Bamako, Senegal.

1894 - Britanikët dhe belgët në mënyrë të fshehtë merren vesh për të ndarë Afrikën Qendrore.

1905 - Vëllezërit francez Dufaux testojnë helikopterin.

1928 - Tentim vrasje ndaj Mbretit Victor Emmanuel II të Italisë.

1931 - Votuesit spanjoll refuzojnë monarkinë.

1940 - Italia përvetëson Shqipërinë.

1946 - Siria shpall pavarësinë nga Franca.

1951 - Kneseti izraelit zyrtarisht ka përcaktuar 13 prillin si Dita e Holokaustit.

Alexandra Andresen është miliarderja më e re në botë, vetëm 21 vjeç. Ajo trashëgoi 42 për qind të kompanisë investuese familjare Ferd së bashku me motrën e saj Katharina. Ferdi është një investitor aktiv në bursën nordike.



Laureati më i vjetër i çmimit Nobel ishte John B Fenn, i cili ishte 85 vjeç kur ai dhe Koichi Tanaka u nderuan me çmimin Nobel në vitin 2002, për zhvillimin e metodeve për të identifikuar dhe analizuar makromolekulat biologjike.



### KOPRRACI

Pasi hanë petulla për mëngjes, mysafiri i fshinë duart.  
- Merr, merr, i thotë i zoti i shtëpisë.  
- Jo, faleminderit, u ngopa, i mora tri copë, thotë mysafiri.  
Koprraci përgjigjet: Jo ti i more pesë petulla, po merr se paska ende.



Dikush nganjëherë thotë: "Ai vrau veten se i ishte mërziur jeta". Në fakt duhet të thotë: "Ai vrau veten se ishte mërziur nga mungesa e jetës".

(Victor Hugo)